

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

DITA E SHËNGJERGJIT
NË TREVAT SHQIPTARE

(Konferencë shkencore – 07.05.2018, Tetovë)

21



Shkup, 2018

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 21 – 2018
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Prof. dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Prof. dr. Sefer Tahiri

Këshilli redaktues:
Prof. dr. Skender Asani
Prof. dr. Izaim Murtezani
Prof. dr. Sevdail Demiri

Sekretar i redaksisë:
Mr. sc. Murtezan Idrizi

Redaktor teknik:
Naser Fera

ISBN: 978–608–4653–79–0

Copyright©ITSHKSH, 2018
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

www.itsh.edu.mk

*Ky botim financohet nga Ministria e Kulturës
e Republikës së Maqedonisë*



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

DITA E SHËNGJERGJIT
NË TREVAT SHQIPTARE

(Konferencë shkencore – 07.05.2018, Tetovë)

21

SCUPI



Pamje nga punimet e konferencës

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE	7
Vebi Bexheti: SHËN GJERGJI, FESTË PAGANE E QYTETËRIMIT TË LASHTË	9
Bukurie Mustafa: RITI DHE FUSHA KUPTIMORE E FJALËS SHËNGJERGJ.....	17
Ermal Mehmeti & Jeta Starova – Mehmeti: FESTA E SHËN GJERGJIT TE SHQIPTARËT SI SIMBOL TOLERANCE	23
Izaim Murtezani: KAH HERMENEUTIKA E DASMËS SË IMPROVIZUAR TË SHËNGJERGJIT NË FSHATIN REÇAN TË GOSTIVARIT	29
Nebi Dervishi: RITET E MOTMOTIT DJE DHE SOT NË TREVAT LINDORE SHQIPTARE	49
Hamit Xhaferi: FESTA E SHËNGJERGJIT NË TREVËN E KËRÇOVËS	61
Mustafa Ibrahim: DISA VENDE KULTI GJATË MANIFESTIMIT TË SHËNGJERGJIT NË VENDBANIME SHQIPTARE	75
Hamdi Mediu–Dushi: FESTAT E SHËN GJERGJIT NË POLLOG ...	85
Rini Useini: SHËN GJERGJI – IDENTITET BREZASH (RASTI I FSHATIT KOROSHSHTË TË STRUGËS)	93
Kosovare Krasniqi: RITUALET DHE CEREMONITË GJATË FESTËS SË SHËNGJERGJIT NË RAJONIN E ANAMORAVËS	99
Emine Shabani: SIMBOLIKA E HEROIT, KUÇEDRËS DHE ZANËS TE FIGURA E SHËN GJERGJIT	111

HYRJE

Manifestimet e njeriut që kanë të bëjnë me kultin e natyrës janë shumë të lashta, sepse ato kanë qenë të lidhura me jetën sedentare të tij, i cili për qëllime të veta të mbijetesës ka mësuar se si merr frymë natyra, kur ajo është e gatshme t'i japë prodhime atij e kur ajo është në heshtje apo nuk është pjellore. Prandaj gjatë ciklit vjetor ka disa lloje ritesh të caktuara, të cilat si qëllim të drejtpërdrejt kanë përfitimin e njeriut nga të mirat e natyrës, ndërsa në mënyrë jo të drejtpërdrejt manifestohet jeta dhe nevojat e njeriut.

Të kesh ende të pranishme këto tradita jo vetëm që tregon për autenticitetin në trojet ku jeton, por dëshmon shumë edhe për trashëgiminë kulturore të bartur brez pas brezi. Pra, ne ende jemi popull transmetues dhe jemi popull që ka rrënjë të thella në këtë natyrë. Një ndër këto manifestime e mbushur plot me ritual është edhe dita e Shëngjergjit, e cila është dhe kryesimboli i jetës dhe si manifestimi kryesor i gjithë vitit.

Në këtë ditë njerëzit përsëri i rreken natyrës, e shfrytëzojnë resursin e saj të bollshëm dhe i kultivojnë të mirat e saj. Por për të respektuar natyrën dhe për ta bërë atë më frytdhënëse popujt kanë praktikuar një mori ritualesh të cilët në mënyrë lidhen me ciklin e jetës. Në këtë mori ritualesh janë përdorur kryesisht elemente të ngjashme të natyrës apo elemente që tregojnë rrjedhojë dhe ringjallje, si kulte të vegjetacionit, kulte të diellit dhe të ngjashme.

Në këtë kontekst lidhen edhe të gjitha punimet në këtë botim shkencor të cilët e tregojnë mënyrën e ndërveprimit të njeriut me natyrën. Në rajone të ndryshme mund të ketë disa lloje variantesh të riteve, por që si qëllim në vetvete mbesin të njëjta. Ritet janë ato që i japin më shumë gjallëri kësaj feste. Diku këto rite bëhen me lule e diku me ujë, e diku tjetër është i pranishëm edhe ndonjë shtazë apo shpend, që e lidh natyrën me jetën e njeriut.

Bota psikologjike e njeriut është e përsosur, shumë kreative, këtë mund ta hasim edhe në llojet e ndryshme të veprimeve ritualeske

dhe veprimeve magjike, të cilët i hasim në festën e Shëngjergjit. Tashmë në shumicën e vendeve manifestuese, përkundër shumë kundërshtimeve kjo festë praktikohet jo në mënyrë masive, por si një simbol mbijetese e kalendarit të dikurshëm jetësor e lidhur me diellin dhe jetën e njeriut.

Në frymën e ndriçimit të festave të kalendarit popullor, në këtë rast të festës së Shën Gjergjit, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, në bashkëpunim me Komunën e Tetovës, më 7 maj të vitit 2018, në Shkollën e Mesme "7 marsi" në Tetovë, organizuan konferencën shkencore me temë "Festat e kalendarit popullor – dita e Shën Gjergjit". Në këtë konferencë, kontributet e tyre shkencore i prezantuan profesorë universitarë dhe studiues të kësaj fushe nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Folklorit në Shkup.

Ky botim i revistës periodike "SCUPI" nr. 21, përmban pikërisht punimet e kësaj konference shkencore, si një përpjekje për të hulumtuar dhe dokumentuar këtë pjesë të lashtë të kaluarës tonë popullore. Me këtë rast, e shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit me kontributet e tyre shkencore, mikpritjen e Komunës së Tetovës, përkatësisht SHMK "7 marsi" në Tetovë, si dhe Ministrinë e Kulturës, për mbështetjen financiare të botimit.

Redaksia

VEBI BEXHETI

Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë

SHËN GJERGJI, FESTË PAGANE E QYTETËRIMIT TË LASHTË

Ndër shumë festa të motmotit që deri vonë festoheshin e që në mënyrë më të zbehur festohen edhe sot, festa e Shën Gjergjit ishte festa më e dashur për shqiptarët në tërë shtrirjen gjeografike të kombit tonë. Ashtu si çdo festë tjetër pagane, që me vështirësi i përballuan ndikimet e ndryshme fetare, edhe kjo festë arriti deri në ditët e sotme, për të dëshmuar një civilizim të hershëm të historisë sonë. Ritet e kësaj feste me histori parakrishtere që kishin të bëjnë me ringjalljen e natyrës, me botën bimore e shtazore, origjinën e kishin nga hyjnitë vendase të lashtësisë. Këto rite pagane e kanë kryer me sukses misionin e vet, duke qenë gjithmonë në shërbim të njeriut dhe dëshirës së tij për mirëqenie e jetë të lumtur, rite këto që kishin të bëjnë edhe me kultin e zjarrit, që sipas mitologjisë së hershme i jepte forcë diellit. Edhe më vonë, me paraqitjen e krishterizmit, këto vazhduan ta bëjnë jetën e vet, pa iu nënshtruar presioneve fetare, që këtë festë pagane ta shndërrojnë në festë fetare.

Jeta e vështirë dhe jo e sigurt e shqiptarit ndër shekuj, e detyruan atë t'i ruajë deri vonë disa besime që bazoheshin në mite dhe rite magjike. Albanologu gjerman, Hahn, me kohë e kishte konstatuar se klerikët e krishterë i kishin luftuar me forcë këto rite pagane, si pjesë e festës Shën Gjergjit. Se kjo festë ka të bëjë me kultin e pjellorisë e të bujqësisë, e dëshmon edhe vet emri **Gjergj**, që rrjedh nga greqishtja e vjetër e që do të thotë bujk. Si nga origjina, ashtu edhe nga mënyra e manifestimit, shihet qartë se Shën Gjergji nuk ka karakter fetar, edhe pse më vonë emri **Gjergj**, ndër popuj të ndryshëm të mitologjisë krishtere shfaqet si simbol shenjtori. Tëndenca që kjo festë të llogaritet si e krishterë nuk mban edhe nga

fakti se vet ritet e kësaj feste kanë të bëjnë me blegtorinë, bimësinë dhe mirëqenien e njeriut që vjen nga to.

Festa e Shën Gjergjit festohet në të gjitha vendet dhe krahinat shqiptare, nga Shqipëria veriore, e mesme, ajo jugore e Çamëria, Arbëreshët e Italisë, Kosova, Ulqini, Presheva e Maqedonia. Vet historiku i kësaj feste, karakteri pagan i saj, shtrirja gjeografike dhe mbi të gjitha mënyra e festimit nga shqiptarët e cilës do anë qofshin ata, sot nuk i jep të drejtë askujt ta nënçmoj këtë festë, ta konsiderojë si të huajën, madje edhe si antiislame. Ka pasur raste kur kjo feste është festuar në të njëjtën ditë me atë të Bajramit dhe, jo që e kanë dëmtuar njëra tjetrën, por përkundrazi, solemniteti, gëzimi e hareja në ato raste e arrinin kulminacionin. Dita e Luleve dhe ajo e Shën Gjergjit ndonjëherë festoheshin edhe në Muajin e Ramazanit dhe besimtarëve myslimanë as që u pengonte ta festojnë këtë festë pagane me rrënjë të thella edhe për qytetërimin shqiptar. Nëse disa kombe, këtë festë e shohin nëpërmjet prizmit fetar të krishterë, gjë që dëshmohet edhe me përdorimin e kryqit që i zëvendësoi elementet pagane, apo si festë që sjell verën, që i jep fund acarit dhe vuajtjes së anëtarëve të familjes gjatë kohës së dimrit, për shqiptarët me më shumë besime fetare, e ruajti karakterin pagan duke gjetur edhe shtrirje tjera me vlera të mëdha etnokulturore, për të treguar kështu lashtësinë e vet në këto troje dhe ruajtjen e vlerave shpirtërore e materiale si pjesë e rëndësishme e etnokulturës shqiptare.

Kjo festë aq e dashur për shqiptarët dhe me rrënjë në lashtësinë e vet kombit, tanimë është e pranishme në këngën popullore, në mitologjinë tonë dhe në kujtesën e më të vjetërve për kohën e rinisë së tyre, sepse Shën Gjergji tek shqiptarët, përveç karakterit ritual, përtëritjes së natyrës, atij praktik të prodhimtarisë dhe atij kalendarik, fitoi edhe karakterin e festës së të rinjve, u bë pjesë e jetës së tyre. Dita e Luleve që bie një ditë para Shën Gjergjit, më 5 Maj, me kohë tek shqiptarët e shumë regjioneve ishte shndërruar në ditë gëzimi e hareje të natyrës, aty ku lindte dhe shijohej dashuria. Vargjet e këngës popullore, të cilat konsiderohen si regjistruesi më besnik i këtyre vlerave, që nuk e patën lehtë të mbijetojnë, janë

dëshmitari më objektiv, që trgojnë karakterin jofetar të këtyre festave, përfshirë edhe këtë të Shën Gjergjit dhe sidomos Ditës së Luleve, që i paraprinë atij. Këngët popullore, të shënuara në fshatin Veshallë, në mënyrë të nrekullueshme e përshkruajnë karakterin e zhveshur të kësaj feste nga ciladoqoftë fe. Vargjet lirike të këtyre këngëve, temë kryesore e kanë dashurinë dhe momentet e ndjeshme që vajzës së fejuar ia përkujtojnë kohën kur ajo nuk do ketë mundësi të jetë në mesin e shoqeve gjatë këtyre dy ditëve të kësaj feste. Brenda këtyre këngëve do hasim dhe një sërë ritesh që kanë të bëjë me jetën, dashurinë, ditët e vajzërisë me veshjet e saj që një ditë do zëvendësohen me ato të nuses dhe lamtumirën jetës beqare. Çelja e gjethit, si paralajmërues se ka ardhur pranvera, që Ditën e Luleve e zbukuron më tepër, për poetin popullor lidhet edhe me dashurinë mes djalit dhe vajzës, që në këtë rast na vjen me emrin e thëllëzës : *O lum e lum, na ka çel xhethi, / do dahet i majri e i keçi / i keçi le shkoje te nona, / i majri le shkoje te folloza.*

Meqë Dita e Luleve ishte vetëm për vajzat beqare e jo edhe për gratë e martuara, kjo ditë për to ishte shumë e rëndësishme sepse me këtë festë që vinte një herë në vit, ato matnin edhe vitet e beqarisë, që shkonin shumë shpejt dhe kështu vit për viti zvogëlohej numri i shoqeve që së bashku duhej ta pritnin këtë ditë të bekuar edhe nga zoti: *O lumët ne për të lumin Zot, / do shkojua për lule ene mot, / o ene mot ene qetër mot, / o hala inni shoçe plot, / do na vaje motja o sikur sot.* Se sa ishte e lidhur emocionalisht kjo ditë me të dashurin e vajzës, tregojnë edhe vargjet: *Ditën e Shënxhexhit, / gjith ditën kom ka, / kmejsa e dilberit, / më ka metë pa la.* Veshja popullore e vajzave zuri vend edhe në këto vargje sepse ajo ishte e lidhur me statusin martesor të tyre: *O çelni molla e çelni dardha, / se jon vesh caucat me skutaçe t'bardha, / molla e dardha le t'çelin, / shiqir xhi e prejtëm Shënxhexhin, / Kaj moj motër, njen sa t'çele xhethi, / ilvida te ne nat Shënxhexhi. / Oj Alije honom kuj d'ja losh xhaketin, / d'ja lo shoçes teme, / ta boje Shënxhexhin, / xhi punon lulije honom hije napër hije, / Shënxhexhin qetër me sontije, / xhi punon Alije honom ferra napër ferra, / për*

Shënxhexhin qetër me tela. Ndarjen e një shoqeje nga grupi i vajzave që bëhen gati për këtë festë, meqë ajo ishte martuar, e përjetuan shumë keq shoqet e saj, kjo ditë për to nuk e kishte bukurinë e viteve të kaluara: *O ki Sënxhexhi i siveçëm, / pa shoçen teme shaum i beçëmm, / për shoçen teme mi vajn shaum keç, / se nouk e nrrrejni kët Shënxhexh.* Vargjet e këtyre këngëve bëjnë fjalë edhe për fejesën e vajzave, status ky që ndoshta në raste më të rralla mund ta kufizojë lirinë, e në klëtë kontekst, edhe të drejtën e shkuarjes për lule: *Oj Florije honom, oj fodulle, / pajtën Agim aga, a do vajsh për lule, / une do vej me kit shoçet, / se mas ni jave do m'vajn bofçet. / Ka çel xhethi i Vardishës, / ne do shkojm për lule, / a do vejsh ene tej, Florije fodulle, / un do vej ta shoh Agim agën, / m'prejtni ta pajtoj une babën, / mos e pajt as nonën as babën, / di javë mas Shënxhexhi do t'apën.*

Kurbeti, bagëtia dhe ringjallja e botës bimore, në këto shpërthime lirike, ku gjithmonë është e pranishme edhe dashuria, janë temat e vazhdueshme përmes të cilave, këngëtari anonim popullor, e paraqet të vërtetën e madhe se kjo festë nuk ka të bëjë me çështje religjioze. Toponimet e ndryshme të hapësirës ku krijohen këto vargje, janë edhe një dëshmi se kjo festë me rrënjë në lashtësi, me kohë ka fituar edhe tipare autoktone të rajoneve ku jetojnë shqiptarët: *Do shkojna për lule ka Vardisha, / di mushim udhët ka kasha, / do shkojna për lule napër ara, / kit gjenit e ri, do hecin përpara. Do shkojm për lule, se na ka dal vera, / do vajn dhent ka kulla me shqerra. Do shkojm për lule, / se na ka çel xhethi, / do vejn gjenit e ri pi gurbeti.* Edhe poeti ynë i madh, Lasgush Poradeci këtë ditë festive me karakter gëzimi, dashurie e hareje e futi në vargjet poetike të një poezie. Personazhja e poezisë të tij, kushtuar Ditës së Luleve, kur takohet diku në mal me dashnorin, vendos të mos kthehet më me shoqet, prandaj edhe i porositi ato që t'u tregojnë prindërve se ate në një përrua e “zuri gjarpushja”. Kjo ditë që i paraprin Shën Gjergjit, këtë festë e pasuron me elemente të reja që u bënë tradicionale në botën shqiptare. Për këtë pjesë të festës së Shën Gjergjit, Ditën e luleve, tregojnë pleqtë dhe plakët, se të rinjtë

që ndodheshin në kurbet edhe në vende më të largëta, vinin për pak kohë që të jenë pjesë e manifestimit me këtë rast, për ta shijuar këtë festë të bukur, që për shqiptarët mbeti krejtësisht e zhveshur nga elementi fetar.

Ashtu si në shumë vendbanime tjera shqiptare, edhe në ato të Malësisë së Tetovës, të rinjtë, me kohë e kishin marrë hisen e vet nga kjo festë e natyrës. Në fshatin Veshallë dhe Bozovcë të Malësisë së Sharrit, vajzat bashkë me djemtë dalin në natyrë të mbledhin lule. Karakteristikë e këtij manifestimi që si duket është edhe unike në tërë botën shqiptare, është se në këtë takim pas një udhëtimit të gjatë nga fshati, përveç djemve të rinj e burrave, marrin pjesë vetëm vajzat, e assesi gratë e martuara. Është me rëndësi për këtë rast të përmendet se ky takim bëhej vetëm në një vend të caktuar, që me kohë e kishte fituar toponimin “Guri i cucave” (Gjuri caucave), i cili gjendet në kufirin që e ndan rajonin e këtyre fshatrave. Ky vend, me shekuj i pret këto të rinj të cilët që nga mëngjesi deri vonë pas dite, e kalojnë kohën duke mbledhë lule, duke kënduar e duke hedhur valle. Një karakteristikë tjetër për këtë moment është edhe radhitja e luleve në ndonjë lëndë dege apo bime që në formë kurore, bashkë me lulet e radhitura, vajzat i venin në kokë dhe i mbanin ashtu deri në shtëpi. Kjo kurorë është vet elementi i lashtë i qytetërimit të hershëm, nga koha ilire që karakterizohet me mbretërinë dhe me mbretëreshën Teutë. Festimi i Ditës së Luleve vazhdon me natën e Shën Gjergjit, me ceremoni të shumta. Nga mëngjesi i ditës së Shën Gjergjit të rinjtë vazhdojnë me valle, këngë e luhatje në tërkuzë të varur në ndonjë pemë. Përveç elementit festiv dhe ceremonial, ku bartës ishin të rinjtë dhe të rejtat, kulti i bimësisë për pjellori e mbarësi, zinte një vend shumë të rëndësishëm. Me këtë rast barinjtë i kripshin bagëtisë me kripën e përzierë me bimë të ndryshme e veçmas me një bimë që quhej “Qepë arushë” (bimë gjethgjerë me aromë qepe e hudhre).

Një shtrirje shumë e gjerë në hapësirat shqiptare për këtë festë, karakteristike është edhe Krandja e Shën Gjergjit (kësaj dege me gjethe i thonë kështu në Lumë dhe në disa vende të tjera të Koso-

vës), ose Potkat, siç quhet ndryshe kjo degë që nuk është më e shkurtër se një metër . Është traditë që herët në mëngjes, ende pa zbardhur mirë, burrat e shtëpisë të dalin nëpër ara e livadhe t'i ngulin këto degë për të lajmëruar se ato vende shpallen zona të ndaluara për kullotje. Arat që nuk e kishin këtë simbol, llogariteshin si të pa zot. Nga ky qëllim i vënies së Potkave, ky rit mori edhe kuptime tjera, duke u shtrirë në vende dhe objekte të ndryshme. Degë të ndryshme por edhe lule gjendeshin kudo: në oborr, nëpër enë shtëpiake, dyer, dritare, që kishin kuptimin e shëndetit, mirësisë, dhe ringjalljes. Riti i zjarrit që është i pranishëm në shumë rajone ku festohet Shën Gjergji, është gjithashtu i lashtë. Edhe sot në rajonin e fshatit Reçan të Gostivarit, dhe në shumë hapësira tjera shqiptare, gjatë tërë natës së Shën Gjergjit, ndizen zjarre të mëdha ku bëhën edhe ceremoni tjera që zgjasin deri në mëngjes. Këto zjarre kanë të bëjnë me kultin e diellit dhe me forcën e tij që jep jetë e fuqi.

Përveç këtyre vlerave etnokulturore dhe etnologjike në përgjithësi, që ishin pjesë e riteve të shumta të festës së Shën Gjergjit, kjo festë luajti edhe rolin praktik të matjes kalendarike të kohës, për të planifikuar një sërë aktivitetesh që lidhen me kohë të caktuar. Dita e Shën Gjergjit që gjithmonë sipas kalendarit të sotëm bie më 6 Maj, konsiderohet edhe si kryemotmot, prandaj edhe numërimet e ditëve, para ose pas kësaj feste, e kanë për bazë pikërisht atë. Periudha kohore Shën Mitër (shmitër, shmejtër) e Shën Gjergj (Shën xhexh) ishte koha sa mund të zgjaste kontrata e kurbetit për “hizmeqarin” që do të shërbejë në familjet më të pasura, i cili zakonisht kujdeset për bagëtinë. Shën Gjergji ishte koha e caktuar, deri kur mund të paguhej një borxh, nëse është blerë bagëti ose ndonjë pronë e patundshme. Në këtë kohë ndalohej kullotja e bagëtisë nëpër zonat që nuk planifikohen për kullotje. Shumë pak, pas Shën Gjergjit vijnë barinjtë me bagëtitë e tyre nga vendet ku kishin qëndruar gjatë dimrit, në Shën Gjergj ndahen qengjat nga dhentë e pak më vonë dilet edhe në stan. Shën Gjergji është koha e tubimeve të ndryshme të fshatarëve për të zgjedhur njërës përgjegjës për punët

me interes më të gjerë: zgjidhet rojtari i arave, ai që do t'i ruajë lopët e fshatit dhe bagëtitë tjera dhe bëhen një sërë aktivitete me interes për banorët e këtyre rajoneve rurale.

Aspekti pagan, si element me rëndësi për autoktoninë dhe lashtësinë e kombit tonë, ai mitologjik si vlerë shpirtërore që na rradhit mes kombeve me qytetërim shumë të hershëm dhe shumë elemente më të reja që u bënë pjesë e kësaj feste, mbeten vlera universale të paluhatshme që gjatë historisë përveç rolit të përbashkët me popuj tjerë të vjetër dhe qytetërimet e tyre të bazuara në besime e shumë qenie mitike, luajtën rol të rëndësishëm edhe në afirmimin e veçorive dalluese të shqiptarëve. Këtë festë aq të rëndësishme dhe me vlera të pakrahasueshme duhet ta respektojmë, ta kultivojmë, ta ruajmë edhe në të ardhmen, ashtu siç reflektoi ajo me kontributin historik për t'i ruajtur vlerat shpirtërore të bazuara në mitologjinë popullore shqiptare, të rëndësishme për etnokulturën e kombit tonë.

Me këtë rast vetëm, sa i përmendëm disa nga shumë vlera të tërësisë së kësaj pasurie kulturore të shqiptarëve. Kjo festë që i përballoi sfidat e kohës dhe arriti deri në ditët e sotme, pa u bërë pjesë e interesit të krishterë, do t'i përballojë edhe këto që kohëve të fundit, vijnë nga individë dhe teologë të pandërgjegjshëm të disa qarqeve ekstreme islame, që fenë e keqpërdorin edhe për këso qëllimesh. Kjo festë, që me gjithë vështirësitë e përballoi historinë, herë–herë të ashpër kundër qytetërimeve pagane, si duket, tani e ka më vështirë të mbijetojë. Globalizimi, integrimi dhe modernizimi i jetës së njeriut, e në këtë rast edhe i shqiptarëve, sidomos migrimi i popullatës sonë, tanimë janë armiku më i madh i këtyre vlerave tradicionale e kulturore. Këto vlera etnologjike që po zbehen dita e ditës dhe po mbeten vetëm në kujtesën e gjeneratave, duhet të jenë brengosje serioze e të gjithë atyre që me punë e dije, këto festa të motmotit dhe vlera tjera, t'i studiojnë dhe t'i bëjnë pjesë të shkençës sonë që për gjeneratat e ardhshme të njihen së paku si trashëgimi etnologjike e kulturore të vërtetuara edhe shkencërisht.

BUKURIE MUSTAFA

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

RITI DHE FUSHA KUPTIMORE E FJALËS SHËNGJERGJ

Abstrakti

Ritet e festave kalendarike janë të njëjta gjithandej, me dallime të vogla nëpër vende të ndryshme, që dëshmon përhapjen dhe lashtësinë e jetës shpirtërore dhe të organizuar të një shoqërie të tërë njerëzore. Ato thellë janë lidhur me punën dhe proceset e shumta të jetës, që e shohim edhe nga llojet e ndryshme të kalendarit, (*kalendar bujqësor, kalendar i mbjelljeve, i korrijeve* etj.). Ky kalendar popullor, ka qenë edhe udhëzuesi më i mirë i jetës në përgjithësi, duke i shënuar në data të caktuara dhe që kanë orientuar çështje të caktuara të cikleve jetësore, të përcaktimit të ditëlindjeve, martesave a vdekjeve dhe zakonisht janë mbështetur në festën e Shëngjergjit, si kryevit, ashtu si dikur është menduar.

Fjalët kyçe: *kalendar popullor, festa kalendarike, Shëngjergji, rite.*

Jeta e një shoqërie njerëzore, gjithmonë është udhëhequr dhe është organizuar nga kalendar popullor, i përcaktuar përmes festave, që populli fort mirë i ka njohur dhe i ka respektuar.

Një organizim i këtillë i jetës dhe i punës, ka imponuar një respekt të lartë të riteve kalendarike, me qëllim të mbarësisë dhe shëndetit të çdo anëtarë të familjes, por edhe të bagëtisë dhe të veglave bujqësore, me të cilat kanë siguruar ekzistencën e tyre. Shumë nga punët e ndara mes burrit e gruas, bëjnë që të dallohen edhe në aspekt të riteve kalendarike. Zakonisht, kanë qenë të përcaktuara se cilat janë ritet e një feste dhe si janë zhvilluar këto brenda familjes.

Në këtë drejtim, gruaja ka qenë ajo që është kujdes për pjesën më të madhe të riteve, si ndaj fëmijëve, bagëtisë dhe shtëpisë. Këto janë ato që më gjatë e më fort e ruajnë dhe e praktikojnë shënimin e festave përmes riteve edhe pse sot ndikimi i praktikave fetare, shpesh e marrin si të ndaluar. Informacionet rreth këtyre riteve, dalin nga gratë plaka, të cilat edhe në mos plotësisht, pjesërisht e praktikojnë, sidomos ndaj fëmijëve. Ato flasin për fëmijërinë e tyre, kur si fare të vogla, nuk e kanë kuptuar rëndësinë e riteve, por deri në një moshë janë praktikuar nga nënat apo gjyshet e tyre. Mirëpo, në këto rite, shprehet besimi dhe dëshira e nënave dhe gjysheve për fëmijë të shëndoshë dhe për mbarësi në shtëpi, duke mbrojtur edhe bagëtinë nga fuqitë magjike keqbërëse dhe që t'u shtohet bereqeti në familje.

Krahas dallimeve jo të mëdha të regjioneve, kalendari popullor përafërsisht është i njëjtë sa i përket datave dhe riteve. Festa e Shëngjergjit është një nga ato festat që ka datë fikse edhe pse në lidhje me këtë ka përsëri mospajtime. Zakonisht, si datë nga popullata jepet 6 maji. Çështja qëndron në kalendarin që e jep edhe Rrok Zojzi dhe që e përkrahin edhe të tjerët,¹ që dikur Shëngjergjin e konsideronin si ditë të kryemotit.² Gratë, zakonisht momentet e veçanta të jetës së tyre i kanë llogaritur përmes festave si pikë orientimi, para apo pas Shëngjergjit. Në këtë mënyrë mbajnë në mend edhe ditëlindjet, martesën a vdekjen dhe momente tjera të rëndësishme të jetës së tyre.

Studiuesi Ukë Xhemaj, çështjen e kalendarit dhe moshës e gjen në ligjërimin e përgjithshëm popullor, si p.sh. “*i musha 70 shnjergja, boll ke ma*”, ose “*sa shnergja i bane ti*” dhe për të cilën thotë “si shprehje që shtrihej në shumë krahina etnografike”.³

¹ Festa kryesore në kalendarin e lashtë ishte Kryet e Motmotit apo Kryeviti, që në krishterim mori emrin Shëngjergji dhe ka zgjatur tri ditë, 6,7 dhe 8 maj. (Genc Kastrati, Kalendarët e shqiptarëve. <http://orashqiptare.blogspot.mk/2015/08/kalendarët-e-shqiptarëve.html> (22.2.2018))

² Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 231.

³ Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 235.

Shënimi i Shëngjergjit është zbehur si ritual, por është i rëndësishëm përdorimi në gjuhën popullore, sidomos në shprehje që kanë një shtrirje më të gjerë të arealit të shqipes. Kështu, shprehja popullore, siç është “*larg është Shëngjergji*”, në kuptim të “mungesës së ushqimit të kafshëve, të njerëzve apo mungesën e druve të dimrit për ngrohje,⁴ ka një kuptim sinonimik me shprehjen tjetër, që ka një shtrirje më të gjerë të përdorimit: *Cungun (kërcaun) ma t’madh, ruje për Shëngjergj!*, me idenë se mund të kthehet i ftohti dhe duhet të ruajnë drutë.

Ndërlidhja e riteve dhe e gjuhës është e fuqishme dhe reflektohet në shprehjet e shumta që i gjejmë në fushën etnokulturore. Gjuhëtar i Qemal Murati, ka shënuar këto shprehje popullore: *Dë boet për Shëngjergj të kuq* – kurrë, asnjëherë; *I ha shinxherxhet e veta* – është në fund të jetës, në mbarim; *I ka hongër shënxherxhet e veta* – e ka jetuar jetën e vet; *Ka le ditën e Shënxherxhit* – ka lindur me shumë fat.⁵

Kjo frymë e ritit dhe e festës jep diçka të re brenda së vjetrës në aspektin gjuhësor, siç është rasti me emrin e përbërë si “*Shënxherl-lëk*”; që ka kuptimin e dhuratave që i dërgohen vajzës së fejuar ditën e Shëngjergjit, (Pir.– Pirok– Tetovë), emërtim i një përdorimi të kufizuar lokal.⁶

Një shprehje në aspekt të përdorimit të leksemës *Shëngjergji*, e gjejmë edhe në mallkime: “*mos pritsh shëngjergj*”, “*mos të leftë dielli shnjergjit*”, “*mos më hanesh ma shnjergj*” etj.⁷ *Mos te zont Shengjergji, mos te zone Shenmejtri!*⁸

Si dhe në urimet: “*Për hajr Shnjergji!*”, “*Me fat shnjergji!*”⁹

⁴ Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 232.

⁵ Qemal Murati, Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni, Shkup, 2015, 340.

⁶ Qemal Murati, Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni, Shkup, 2015, 226.

⁷ Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 234.

⁸ Qiflie Useini 59 vjeçare, f. Koroshishtë- Strugë, 25.1.2018.

⁹ Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 235.

Shëngjergji në pjesë më të madhe festohet dy ditë, më 5 dhe 6 maj, duke pasur parasysh se dita e parë njihet si Ditë e luleve, por diku quajnë edhe *verzhilla* apo edhe *arife* (*verzhilla* e gjejmë në Patishkë, ndërkaq *arife* në fshatra të Strugës. Emërtimi *arife* mund të jetë një bartje në kuptim, duke e përdorur si një ditë para ditës së Bajramit). Kështu, Shëngjergji duke qenë se festohet dy ditë kanë bërë një ndarje, ashtu që gratë shkojnë një ditë para Shëngjergjit, në *Verzhillë*, te vendi që e quajnë *llofka*— vend me ujë për të mbledhë lule dhe për të kryer ritet e Shëngjergjit. Ndërsa, *burrat shkonin te llofka n'diten e Shyngjergjit, lujnë çelika gjith ditën e hanin buk te llofka*.¹⁰ Festa shoqërohet me këngë, vallëzim e lojëra të ndryshme, si dhe ushqim të përgatitur enkas për këtë festë. (Kurbani si një nga ritet, nuk përmendet nga banorët dhe nuk kemi se si ta verifikojmë në terren edhe pse besohet që duhet të ishte bërë).¹¹

Ritet, zakonisht janë praktikuar më shumë nga gratë, e më rrallë nga burrat. Në pjesë më të madhe festat nisen me përgatitje që në mbrëmje, duke vazhduar me ritet që herët në mëngjes. Ritet kryesore të Shëngjergjit, zhvillohen pranë ndonjë burim uji a lumi, me besimin e përgjithshëm të pastrimit dhe shëndetit. Nga këto arsye peri kuq e zi, që në Patishkë e quajnë *peçat*, e që vihet në Ditën e Verës, hiqet dhe varet në degë të një druri në ditë të Shëngjergjit. Është fjala për kulprën, përmes së cilës përshkohet fëmija tri herë, duke thënë: *Lei t'ligat ktur*; kjo bëhet me idenë për të qenë shëndoshë fëmijët për gjatë tërë vitit.

Festat kryesisht lidhen me ndalesën e punës së dorës, por shtëpia patjetër duhet të jetë pastruar dhe të merr një pamje të gjelbërimit, duke vendosur gjethe dyerve, po kështu u vendoset edhe veglave të punës, siç është mëtini dhe bagëtisë, kuptohet për bereqet dhe shëndet.

¹⁰ I intervistuari: Avdyl Halili, i lindur më 1955-2015 në Patishkë. Intervista u zhvillua më 28.01.2012 nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa.

¹¹ “Dikur, për këtë ditë therej “kurbani” (dash, dele apo qengi). Kjo traditë tash ruhet vetëm nga popullsia rome”. Ukë Xhemaj, Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003, 233.

Po në shumë vende, gjethe vihen edhe në flokë, zakonisht në gërs-heta të vajzave të vogla,¹² e diku edhe bëhej edhe për kësmet: “*E fëcoume* (e fëjuar) *ua prete flokët beqarkave e i fëjte komët në uj ene thotë: “rrëjtmi flokët sa bishti kalit, sa udha pazarit”*.”¹³

Intervistë e zhvilluar në f. Patishkë në Karshiakë për festën e Shëngjergjit:

K. Sh. ... edhe te Shyngjergj bile nuk shkojn, si kan shku çera her, rrall insan shkon Q. Z.... te lulat rall dikush shkan, i kan lonen ... tjera her i ka mbledh vjera nuset e reja u kan kndue, kan lujtun, ... e Dit Shyngjergji dalin djali i ri luejn asi çelika, Dit Verzhille dalin grat, Verzhilla para Shyngjergjit, e nuseve e grave.

K. Sh. ...kur finia lypin vez e te shpia domaçinka thuje e tundin mtinin sabah heret Q. Z. ... edhe mtinit i ven peçat ... edhe ja marrin peçatin per Shyngjergj dhe ja çojn te lulat açe edhe i marrin gjethet e lulet dhe ja ven mtinit, isto, athere ashtu, tashi nuk shkojn per Shyngjergj.

K. Sh. N'Verzhill Shyngjergji ngriheshin sabajle heret n'gjasht sa-hati, e shkonjin te livadhet aty, te proi, te llofka na i thom ... Q. Z. kindojn, luejn ... H. Y. ... hajdni ditën e Verzhilles e da u çoj, e da lami, ... da pershkojn, Te mullini, Te Ara mullinit, aty afer o, nuk o larg, e da çesim zdravec e kurpinja, da kpusim zheth u venim dyrve ... per Shyngjergj nuk ka vdor,

Për Shëngjergj kan dal te vendi Mbas Shpelle- Filipoviçi, Q. Z. ... te llofka i thon, ... K. Sh.... te reka, ka kroja, Q. Z. ...ka krue, e kapercen kroit, ka edhe uj lahesh ... te lulat shkojn, luajn, kcejn, kindojn Q. Z. ... ujit i thoret Gryka e proit ama edhe llofk i thoret, te llofka Te Gryka proit ashtu thirret ... K. Sh. Nuk kan kris, po kan luejt kta djemt çelika, rinia ... Q. Z. edhe peçatin e lon te llofka ditën e Shyngjergjit ... K. Sh. e kan bo Diten e Veres e kan lon ditën e Shyngjergjit te llofka ... H. Y. Te përshkohesh aty e lidhen, te kurpinja ... tri her da përshkohesh kit peçatin da mbrape për-

¹² Sadete Limani, 1951, Shkup, 24.1.2018.

¹³ Qiflie Useini, 59 vjeçare, f. Koroshishtë- Strugë, 25.1.2018.

shkohet ai fnija da lidhim, da lidhim n'vënd e kepusim nji pe ... un pirher kam shkuet, kjo nuk vjen te llofka, un nuk i lo traditat, un shkaj ... K. Sh. vashat e miat me kit shkanjin ... mblihdshin gjith kunatat shkoni, n kta kunatat e mia s'vinjin, kush da vine ... sivjet da shkajm bashk, ... da qekim fli, ... da pershkomi ... da shkaj,...

Intervista u zhvillua më 14 mars 2015– Dita e Verës

Intervistën e realizuan: Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa

Subjektet e intervistuar:

Rushit Shaqiri– arsimtar në shkollën e fshatit, 1964

Kadime Shaqiri amvise 1969, e shoqja e Rushit Sh.

Hanife Ymeri amvise 1972, motra e Kadimes. (Të gjithë banorë të Patishkës).

Qerime Zeqiri amvise 1958, (banon në Shkup)

Intervista dhe incizimet u realizuan në shtëpi të Rushit Shaqirit.

Avdyll Halili, i lindur më 1955– 2015 në Patishkë. Intervista u zhvillua më 28.01.2012 nga Ibe Mustafa dhe Bukurie Mustafa.

Qiflie Useini 59 vjeçare, f. Koroshishtë– Strugë, 25.1.2018.

Sadete Limani, 1951, Shkup, 24.1.2018.

Bibliografia:

Murati, Qemal. Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni,

Shkup, 2015.

Xemaj, Ukë. Etnokultura shqiptare në Podgur, Prishtinë, 2003.

Kastrati, Genc. Kalendarët e shqiptarëve.

<http://orashqiptare.blogspot.mk./2015/08/kalendarët-e-shqiptarëve.html> (22.2.2018)

ERMAL MEHMETI & JETA STAROVA – MEHMETI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore
të Shqiptarëve në Shkup, & Fakulteti Pedagogjik në Shkup*

FESTA E SHËN GJERGJIT TE SHQIPTARËT SI SIMBOL TOLERANCE

Figura dhe jeta e Shën Gjergjit ka qenë shumë komplekse dhe ai ka zënë vend të rëndësishëm në memorien e njerëzimit. Me 23 prill festohet me kalendarin Julian (të vjetër), ndërsa vendet ortodokse e festojnë me 6 maj sipas Kalendarit Gregorian (të ri). Kremtohej në tërë viset e trojeve shqiptare, si nga të krishterët, ashtu edhe nga myslimanët, pa dallim, me të njëjtat rite. Është një kremtim i njohur në tërë Ballkanin, tërë Evropën me rite të veçanta.

Devocioni ndaj Shën Gjergjit u rrit e u përhap gjithnjë më tepër nëpër shekuj.

Dita e Shën Gjergjit, shënon ardhjen e verës, gjallërimin a natyrës, dhe ka në themel besime dhe rite pagane. Në natën e kremtimit, në kodra fëmijët ndezin zjarre të mëdha e mbarësi. Natën mbledhnin në pyll barëra e lule e i sillnin në shtëpi. Pa dalë drita, gratë mbushnin në burim ujë me të cilin me një degë të gjelbër spërkatnin njerëzit dhe vendet e shtëpisë, kasollet dhe vathën e bagëtive. Në këtë ujë ku kishin futur dhe lule, lule dhe gonxhe, lanin fëmijët për shëndet.

Shën Gjergji është quajtur dhe „Kryeviti” (Viti i Ri), pra sipas një tradite të lashtë popullore ishte fillim viti, mbijetojë falë një sistemi të vjetër kalendarik.¹⁴ Ne shqiptarët kemi më shumë motive ta kujtojmë dhe festojmë këtë ditë, në radhë të parë ditë e shenjtë të paraardhësve tanë iliro-dardan, duke marr parasysh faktin se gjithë ritet që kryhen për Festën e Shën Gjergjit janë më shumë rite pa-

¹⁴ Sipasë Mark Trita, „Shë Gjergji”, Fjalor enciklopedik shqiptar, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Turan., 2009, 3/ faqe.2442.

gane të lashta ilire të ruajtura në imagjinatën dhe memorien ndër më shumë breza, dhe si të tilla nuk kanë asnjë lidhje me krishterimin dhe besimet e tjera monoteiste, si rite me gjenezë të paraardhësve tanë iliro-dardan.

Edhe shqiptarët në traditën kulturore kujdes të veçantë i kanë kushtuar riteve të Shën Gjergjit¹⁵ që është konsideruar që prej kohërave më të lashta jo vetëm një festë që flet për besimet e popullit, lidhjen e tyre me natyrën, me fenomenet dhe dukuritë e saja ndër kohëra të ndryshme, por edhe dëshmon edhe për një tolerancë me rrënjë të thella dhe me vazhdim në historinë e shqiptarëve të cilën gjatë epokave të ndryshme do ta karakterizojnë përçarje dhe ndarje ndërfitare, ideologjike, politike, luftëra për liri dhe pavarësi.

Shën Gjergji u lind në Nikomedi (Nikomedia), rajon në Turqinë e sotme dhe ka jetuar në shekullin III pas Krishtit, me prindër të krishterë, babai nga Kapadokia, kurse nëna nga Palestina. Gjergji pasi u bë një ushtar romak, jetoi në Palestinë. Protestoi kundër persekutimit të krishterëve nga ana e Romës pagane, duke pësuar shumë tortura me sakrifikim të jetës sidomos në luftë kundër perandorit romak Dioklecian (284–305). Për këtë shkak gjatë shekullit III dhe IV shpallet i shenjtë dhe martir i Krishterimit.¹⁶

Së shpeti ai do shndërrohet në simbol dhe mbrojtës i ushtrisë bizantine dhe shumë vendeve evropiane. U burgos dhe u torturua duke qëndruar besnik ndaj besimit të tij krishterë. Me 23 prill të vitit 303 atij ju pre koka në qytetin Lyda të Palestinës, ku edhe dihet vari tij.¹⁷ Enciklopedia katolike mbanë qëndrimin se nuk ka

¹⁵ Shën Gjergji është një festë agrare që ka të bëjë me tokën dhe me përdorimin e saj. Vetë fjala „Gjergjë” rrjedh nga grevistja e lashtë, që do të thotë bujk.

¹⁶ Figura e Shën Gjergjit u lidh me gojëdhënën e famshme të fitores mbi dragoin, e cila në përfaqësimin popullor simbolizonte fitoren e krishterimit mbi dhunën dhe të keqen. Prandaj Shën Gjergji në artin ikonografik paraqitet gjithnjë se kalorës kreshnik që mundi dragoin, apo kuçedrën - simboli i së keqes.

¹⁷ Gustav Moreau, BBC-Religion&Etics-Saint George introduction, cituar sipas Dedë Palokaj, „Festa e Shën Gjergjit në kulturën shqiptare”, Bota sot, 5 maj 2017.

fare arsye për të dyshuar në ekzistencën historike të Shën Gjergjit, edhe se pak dihet rreth jetës dhe veprimtarisë së tij.¹⁸

Siç dihet shqiptarët u takojnë tre feve monoteiste (dy feve të krish-terë: katolicizmit, ortodoksisë, si dhe islamit), por gjatë historisë kanë treguar ndaj hebrenjve të persekutuar prej nazizmit hitlerian, një solidaritet dhe tolerancë të rrallë në Evropë gjatë Luftës së Dytë Botërore.¹⁹ Shqiptarët edhe kanë kaluar nëpër rrugën e golgotës të konvertimeve dhe asimilimeve, eksodeve, kanë patur ndjenjë të fortë për t'u mbetur me çdo kusht besnik riteve dhe zakoneve nga lashtësia në kohëra dhe kushte të caktuara, përndryshe do të mbe-teshin popull pa memorie.

Kështu shqiptarët në traditën kulturore dhe shpirtërore kujdes të veçantë i kanë kushtuar riteve të Shën Gjergjit. Ritet kulminojnë në një festë të besimit të njeriut, të lidhjes së tij me natyrën, me fenomenet dhe dukuritë të saja, si festë universale të jetës së të gjithë njerëzve. Në këto raste vijnë ne dukje si spërkatja me ujë, me hithra, që ka të bëjë me kultin e ujit, me kultin e bimësisë. Po ashtu ndër ritet të tjera, është dhe kulti i zjarrit me rëndësi jetësore në jetën e njeriut. Në instancë të fundit dita e Shën Gjergjit është një festë agrare që ka të bëjë me tokën dhe jetën e njeriut.

Shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit i Zi, Preshevës dhe Bujanovcit dhe vendeve të tjera ku jetojnë shqiptarët në botë pos festave kombëtare, shtetërore dhe fetare, kanë dhe kremtojnë dhe festa të tjera tradicionale siç janë: Shën Gjergji, Shën Marku, Shën Mitri, Dita e Pranverës, Dita e Verës etj. Dita e Shën Gjergjit është e shënuar prej më shumë ngjarjeve dhe riteve që bëhen vetëm në atë ditë si vrapimi u kuajve, mundja e demave, sporti mundjes dhe gara të tjera me karakter sportiv.

¹⁸ The Catholic Encyclopedia of Canada on St George, www.newadvent.org.

¹⁹ Më gjerë të vepra e Shaban Sinanit, *Shqiptarët dhe Hebrenjtë*, „Naimi” Tiranë, 2014. Sipas studiuesit Shaban Sinani, një rol vendimtar në sjelljen historike të shqiptarëve ndaj hebrenjve ka luajtur enotopi i tyre, i shpjeguar ky jo vetëm me tolerancën e mirënjohur ndërfetare të shqiptarëve, por edhe me sjelljen e tyre mbrojtëse ndaj të huajve, sidomos në kohë rreziku.

Duhet theksuar se këto rite nuk kanë kuptim fetar dhe as kuptim të besimit pagan. Dita e Shën Gjergjit, si feste tradicionale me traditë të lashtë i lidhë shqiptarët me shekuj nëpër gjitha viset etnike e cila është përcjellë brez pas brezi. Duhet theksuar se në një kontekst më të gjere historik edhe të identitetit të përbashkët shqiptarë kanë trashëguar shumë zakone të lashta iliro-dardane duke i ruajtur edhe ritet që ndodhin në ditën e Shën Gjergjit.²⁰

Në këtë rast vlen të përmendet edhe roli Kishës Shën Gjergji në Boston (SHBA) që e formojë dhe i dha shpirt rilindësi i madh dhe i famshëm shqiptar, Fan Noli, ku ai për herë të parë në histori futi gjuhën shqipe në meshën ortodokse. Ky hap jo vetëm me vlera nga aspekti muzikor është përshëndetur ngrohtësisht edhe nga Faik Konica, po atë ditë me 22 mars 1908, në „Knights of Honor Hall” në Boston: „Dita kur Fan Noli drejtoi liturgjinë e parë në gjuhën shqipe, është një pikë kthese në vitet e Rilindjes Shqiptare. Ne nuk do ta harrojmë atë, dhe aq më pak do lejojmë të tjerët ta harrojnë.”²¹ Po në këtë ditë është themeluar edhe Kisha e Shën Gjergjit, ku pranë saj Fan Noli ngrii edhe korin që e drejtonte vetë. Shumë vite më vonë, në një fotografi të vitit 1942, shihet „Theofan Stilian Noli me pjesëtarët e Korit të Kryekishës Shën Gjergji nga Bostoni, duke kënduar në Radio programin Zëri i Shqipërisë.”

Devocioni i Festës së Shën Gjergjit²² ka përshkruar shekuj, duke u lidhur me zakone shumë të bukura të ardhjes së pranverës, simbol i

²⁰ Gjurmët e traditës të festës së Shën Gjergjit shkojnë larg në lashtësinë iliro-dardane atëherë kur ata besonin në shumë perëndi. Me ardhjen e Perandorisë Osmane në trevat shqiptare filluan të ndërtohen turbe të ndryshme të cilat konsideroheshin për valitë, hoxhallarët, shehlerët apo dervishët e devotshëm. Shqiptarët për t'i qëndruar besnik traditës ja përshtatnin tani, edhe fesë islame këtë fesë tradicionale. Festa e Shën Gjergjit p.sh. në Kosovë në rrafsh të Dukagjinit (Baba i Bokës në Gjakovë, etj) organizohet pran tyrbeve, në prani të cilëve prehen apo there qengja, duke kërkuar na Zoti mirësi në këmbim të flijimit, sipas, sipas Dedë Palokaj në artikullin “Festa e Shën Gjergjit në kulturën shqiptare”.

²¹ Për më gjërë shiko dhe gazetën „Liria” – Boston, Mass, 15.09.1908.

²² Emri Gjergj është shumë i përhapur ndër shqiptarë në trajtat Gjergj, Gjergjush, Gjush, Gjorgj për burat dhe Gjorgjina e Gjorgjana për gratë. Të kujtojmë se dz

ringjalljes së natyrës, në dyert e jashtme dhe të brendshme të shtëpive. Këto rite simbolike kanë lënë gjurme të theksuara në poezinë, artet, dhe tradita gojore letrare të Shqiptarët. Këtu në radhë të parë është poezia e shkrimtarit të madh shqiptar Ernest Koliqi "Ditë Shëngjergjash", i cili këto rite dhe simbole i afron artistikisht. Shën Gjergji ju kushtuan shumë vepra letrare dhe artistike ndër të cilat mund të kujtohet në radhë të parë: "De situ terrae sanctae", shkruar rreth vitit 530 nga Teodor Perigeta.

Shumë shqiptarë nga "kriptokatolikët" apo "laramanët", në veçanti, në disa zona, siç është, për shembull zona e Karadakut në Maqedoni etj., festojnë Shën Gjergjin, Shën Marinë, një pjesë tjetër Shën Nikollën, Shën Ndoun, Shën Markun, Krishtlindjet etj., kurse të krishterët u bëjnë vizita vëllazërore myslimanëve për festat e tyre të Bajramit, Kurban Bajramit, etj.²³

Populli shqiptar me tre besimet: islam, ortodoks e katolik, s'qenë vetëm simbol i harmonisë fetare përgjatë historisë të popujve të Ballkanit por gjeneza e tolerancës në përgjithësi mund të gjendet edhe në besimin të manifestuar para feve monoteiste. Ashtu në kulturën e lashtë shqiptare, edhe besimet pagane zinin një vend të rëndësishëm në kontinuitetin dhe kontekstin e tolerancës. Kultet pagane jetonin për mijëra vite nëpër krahina të ndryshme ku jetonin shqiptarët. Madje shumë nga ritet e lashta, edhe ato kushtuar Shën Gjergjit jetojnë në forma të ndryshme. Pluralizmi fetar shqiptar ka shënuar si element bashkues midis njerëzve, familjeve në shoqërinë më të gjerë shqiptare. Komponent i këtij pluralizmi ndër shqiptarët ka qenë edhe është festimi i Shën Gjergjit, Shën Mitrit etj., festa që ekzistonin edhe para feve monoteiste. Këto festa janë dëshmi reale për një dialog dhe tolerancë që duhet të përfaqësohen në të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët që të kenë rezultate efektive në eliminimin e disa problemeve sociale, kulturore dhe edukative.

nga burat me të shquar të trojeve shqiptare, mbajnë emirin Shengit: Gjergj Kastrioti e Gjergj Fishta.

²³ Më gjer shiko te Dedë Palokaj, „Një vështrim historik i tolerancës ndër fetare shqiptare”, gazeta Express, 23 qershor 2016.

Në përfundim të këtij punimi kishim dashur të theksojmë se fati, historia, memoria e mbijetesës të shqiptarët, një nder popujt më të lashtë të Evropës, me enigma akoma të zbërthyer, janë aq komplekse dhe te gërshetuara, sa që pas, pluralizmit demokratik që u vendos në Shqipëri pas vitit 1990, e cila kaloje fazën makabre të izolimit të popullit dhe shtetit me ndalimin e feve, kufizimeve të lirisë u hapën horizonte evropiane të reja për ti rivalorizuar vlerat e amshueshme të shqiptarëve me të cilat kanë mbijetuar në histori, siç është rasti i polifonisë katërzëshe shqiptare. Janë këto zëra që tingëllojnë si himn i shpresës dhe tolerancës.

IZAIM MURTEZANI

Instituti i Folklorit – Shkup

KAH HERMENEUTIKA E DASMËS SË IMPROVIZUAR TË SHËNGJERGJIT NË FSHATIN REÇAN TË GOSTIVARIT

Shkurtore: *Në këtë punim studimor mëtohet të shpjegohet origjina mitike e një dasme të improvizuar që zhvillohet në fshatin Reçan të Gostivarit me rastin e shënimit të kremtes pagane të Shëngjergjit. Një dasmë e kësaj natyre është tejet e veçantë dhe ndërlihet me festën pagane në fjalë. Si e tillë, vështirë që kjo dasmë të haset në ndonjë areal tjetër ku jetojnë shqiptarët.*

Në të vërtetë, në këtë dasmë të improvizuar marrin pjesë vetëm bota mashkullore, madje edhe nusja është e gjinisë mashkullore, por duke maskuar përkatësinë e saj gjinore, nënkuptohet nëpërmjet veshmbathjes tipike që posedojnë nuset e reja gjatë zhvillimit të ceremonialit të dasmës. Këtë nuse të tillë e pret vejani në fshatin në fjalë i cili pretendon të martohet me të, por ndodh e papritura. Nusja zbritet nga kali dhe fillon të luajë valle me vejanin. Në ndër-kohë, përderisa luan, ajo zbulon fytyrën e saj të vërtetë dhe rezulton se është e gjinisë mashkullore. Në këtë mënyrë, dasma merr për-masa të karakterit komik.

Edhe pse një dasmë e tillë, sot ka një përmbajtje të kësaj natyre, me siguri se në të kaluarën më të largët, ajo ka qenë më ndryshe. Nga solemnitete të ngjashme të popujve tjerë mund të konstatohet se çifti që duhej të martohej në ditë të tilla në të cilat aderohej në një periudhë të re të ciklit kalendarik, përfaqësonte figurat e hyjnive të natyrës, apo vegjetacionit. Bashkimi i tyre, përkatësisht i çiftit hyjnor nënkuptonte edhe “lindjen” e një bote të re, apo zhvillimin e prodhimeve bujqësore, por edhe vegjetacionit në përgjithësi.

Nënkuptohet se fillimisht hyjnitë e tilla ishin edhe të karakterit hermafrodit duke poseduar në vetvete të dy gjinitë e kundërta. Pra, dasma e Reçanit paraqet një manifestim të përmasave mitike, por që ka evoluar gjatë zhvillimit historik duke marr trajtën e tanishme të karakterit komik, madje me tendencën e ndërlidhjes edhe me ndonjë ndodhi konkrete të karakterit historik.

Fjalë çelësa: *mit, histori, ritual, paganizëm, dasmë, hyjni, nuse, pjellori, magji, verë, dimër, këngë, partenogenezë, hermafroditizëm, transvestizëm, etj.;*

1. Përshkrimi i dasmës së improvizuar në kontekst të Shëngjergjit

Festa e Shëngjergjit paraqet një kremte tejet të rëndësishme të kalendarit pagan të shqiptarëve të Republikës së Maqedonisë, nënkuptohet duke përfshirë edhe trojet tjera etnike, por edhe më gjërë, madje edhe jashtë kornizave kombëtare, pasi ajo haset edhe te popujt tjerë, veçmas në Gadishullin Ballkanik, por edhe gjetiu. Brenda e kësaj feste përfshin një numër të madh të aktiviteteve magjike dhe rituale të cilët janë pothuajse të ngjashme në mbarë trevat shqiptare, nënkuptohet diku – diku edhe me variante e motërzime të ndryshme. Megjithatë, një aktivitet tejet specifik dhe i veçantë që zhvillohet në kuadër të kësaj feste pagane padyshim se është dasma e improvizuar që zhvillohet në fshatin Reçan të Gostivarit.²⁴ Një ritual i kësaj natyre është cytës dhe sfidues për çdo studiues të kulturës popullore për të depërtuar veçmas në zbërthimin e përmbajtjes së tij.

Fillimisht duhet theksuar se festa e Shëngjergjit është një ritual i mirëfilltë i kalimit nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore. Dihet se rituali i çfarëdo natyre qoftë çdoherë shoqëron

²⁴ Më gjerërisht, të dhëna për fshatin në fjalë mund të lexoni në monografinë shkencore me titull: *Reçani i Pollogut të Epërm. Vatër e rezistencës, arsimit dhe kulturës (Monografi)*, të shkruar nga autorët Fejzulla Shabani dhe Nebi Dervishi. Libri është publikuar nga Shtëpia botuese *Iris* në Strugë, në vitin 2015.

kalimin nga një gjendje ontologjike në një gjendje tjetër ontologjike. Nëpërmjet ritualit mëtohet të mposhten fuqitë mistike dhe të hapen rrugët e ndjelljes së mirëqenies familjare, apo njerëzore në përgjithësi. Në të vërtetë, festa e Shëngjergjit shënon pragun, apo kufirin mes periudhës dimërore dhe verore, pasi njeriu me bindje pagane i gjykonte gjërat sipas botëkuptimit të kundërvënieve dyshe, si jetë: vdekje, mirë: keq, poshtë: lartë, dritë: errësirë, gëzim: pikëllim, djathtas: majtas, verë: dimër e kështu me radhë. Pra, si rrjedhojë e kësaj logjike, periudha verore, në mënyrë simbolike, i posedonte atributet e krijimit, apo rikrijimit të botës, kurse periudha dimërore atributet e rrënimit të rendit kozmik. Kufijtë e harkut kohor të periudhës verore ishin Shëngjergji dhe Shën Mitri, kurse kufijtë e periudhës dimërore ishin anasjelltas, përkatësisht Shën Mitër – Shëngjergj

Një logjikë e tillë si bazë të njësimit kohor, ka kalendarin solar, apo diellor që rezulton si më i saktë kundruall kalendarit tjetër, apo atij lunar ose hënor. Autori Branimir Gushiq duke përshkruar në një punim të tij të hershëm kalendarin e barinjve të fisit Krasniqi në Bjeshkët e Nemuna thekson se ai ndahej në dy pjesë, në verë dhe dimër. Në këtë kontekst, vera kishte 180 ditë, aq sa kishte edhe dimri. Ditët tjera që mbetnin jashtë kalendarit të vitit përfsiheshin në festën e Shëngjergjit me atë që kjo festë zgjaste tri ditë dhe në festën e Shën Mitrit që zgjaste dy ditë (sipas Belaj, 2007: 144). Pra, me siguri se një logjikë e tillë është ndjekur edhe në viset tjera shqiptare, pasi përcaktimi i saktë i kalendarit, ishte tejet i rëndësishëm, veçmas për zhvillimin e veprimtarisë blegtorale dhe bujqësore.

Pra, Shëngjergji shënonte fillimin e një viti blegtoral, andaj si i tillë kremtohej në të gjitha viset e banuara me shqiptarë duke përfshirë edhe fshatin Reçan të Gostivarit. Megjithatë, në fshatin në fjalë, siç theksuam më parë, zhvillohej një aktivitet specifik me përmasa rituale. Në të vërtetë, reëanasit – pjesa mashkullore natën e Shëngjergjit e kalonin në natyrë. Ata më 5 Maj i merrnin të gjitha pajisjet e nevojshme dhe dilnin në natyrë në vendin e ashtuquajtur

Krasta ku gjatë tërë natës argëtoheshin duke luajtur lojëra të ndryshme, pastaj duke kënduar e vallëzuar, etj. Nënkuptohej se aktin e tillë e bënin madhështor edhe sullet e lodrat që shoqëronin vallet e të rinjve. Njëkohësisht nuk mungonte as ushqimi i begatshëm, pasi zjarret gjatë tërë natës mbaheshin të ndezura duke pjekur mishin e qengjave të ndryshëm. Pra, argëtimi shoqërohej edhe me ngrënie të mishit, por edhe të gjësendeve tjera ushqimore. Në këtë aktivitet që zhvillohej në natyrë, merrnin pjesë shumë njerëz, nënkuptohet të gjinisë mashkullore. Ky aktivitet ishte aq i rëndësishëm saqë enkas nga kurbeti vinin edhe mërgimtarët e fshatit me qëllim që të bëheshin pjesë e këtij manifestimi. Pra, manifestimi ishte një pikë e fuqishme referuese e ndërlidhjes dhe e ruajtjes së kohezionit shoqëror. Jo vetëm reçanasit, por edhe mysafirët e tyre nga fshatrat fqinj, por edhe më të largët merrnin pjesë në këtë manifestim të karakterit kolektiv. Kjo hare e përgjithshme në natyrë zgjaste deri në orët e hershme të mëngjesit, përkatësisht të 6 Majit kur manifestimi merrte përmasa tjera, apo të përgatitjes së nuses që do të dërgohej në fshatin në fjalë.

Në të vërtetë, në mëngjesin e ditës së Shëngjergjit, “pa zbardhur dita zgjidhet kali i bardhë më i bukur i fshatit. Pastaj caktojnë një nga fshatarët, një djalë të ri deri në moshën njëzet vjeç, e veshin me fustan nusërie e i hedhin edhe duvakun edhe bimishin e kuq. Nusen mashkull e zbukurojnë me lule Shingjergji, që simbolizojnë qumështin, me lule dullaku dhe shumë lule të tjera të stinës” (Seli-mi – Osmani, 1996: 119). Në këtë kontekst, po ashtu duhet të ceket edhe fakti se nuses i vendosen edhe kurora në qafë dhe ballë, por edhe në mesin e saj. Po ashtu edhe kali i saj me ngjyrë të bardhë zbukurohet me vegjetacion të ndryshëm. Duhet theksuar se nusja e re e dasmës së Reçanit që mishëron shpirtin e vegjetacionit me siguri se në një të kaluar të largët ka qenë e identifikuar edhe me ndonjë perëndeshë të arealeve pyjore, apo ka poseduar attribute të kësaj natyre. Në funksion të këtij konstatimi gjithsesi se janë edhe kurorat e vendosura në trupin e nuses së re. Studiuesi Kuper thekson se në Greqi dhe Romë, kurora ishte *shenjë që u dedikoej*

hyjnine. Shtatoret e hyjnine kanë qenë të rrethuara vazhdimisht me kurora të ndryshme. Në të vërtetë, ata, ose ato që bartnin kurora identifikoheshin me hyjnitë, apo merrnin atributet qiellore, por edhe atributet e hyjnisë me të cilën mishëroheshin në mënyrë konkrete. Në mitologjinë e popujve të lashtë, veçmas të pellgut mesdhetar, njihen shumë hyjni dhe hyjnesha të vegetacionit, si Adonisi, Dionisi, Ozirisi, Persefona, Artemida, Venera etj. Këto hyjni dhe hyjnesha kishin partnerët e tyre nga kryqëzimi i të cilëve ndikohej pastaj që bimët të gjelbëronin, apo natyra të shtonte pjellorinë e saj. Nusja, në kontekst të dasmës në fjalë, pasi përgatitet, përkatësisht vishet me rrobat e nusërisë luan një valle me burrat e pranishëm dhe pastaj niset me krushqit e hypur në kalë. Me këtë rast, ajo shoqërohet nga krushqit (fig. 1), si zakonisht nën tingujt e surleve dhe tupanit. Pothuajse gjithë të pranishmit, pra krushqit me ndonjë degë druri në dorë janë tejet të gëzuar që marrin pjesë në këtë dasmë të improvizuar, kurse hareja dhe gëzimi shtohen edhe më shumë kur arrihet në fshat, përkatësisht në rrugën kryesore të tij (fig. 2).



Fig. 1




Fig. 2

“Nën buçitjen e daulles – fëmijët, vajzat, nuset, gratë shpejtojnë pa ardhur nusja në fshat, pra pa zbardhur dita t’i lajnë sytë në lumin e Mellsës që gjarpëron në mes të fshatit. Çdo person merr me vete nga një kulaç me majë Shëngjergji, nga një kokërr vezë dhe bonbone. Të gjithë personat i fusin këmbët në ujë dhe lajnë fytyrën. Me vezën prekin fytyrën, ndërsa me lëvozhgat e vezës i lajnë sytë tri herë, duke e hedhur ujin pas shpine e duke stërpikur njëri–

tjetrin. Duke vepruar kështu shqiptojnë fjalët: *Tëm hece shëndeti, si uji i Melleçës; Uji teposht, shëndeti termo!* Çdo femër shpejton ta hajë ushqimin së bashku me fshatarët, se është keq të ndahet nga grupi. Vendasit thonë se ky rit bëhet që gjatë vitit të mos i mundë qyqja” (Selimi–Osmani, 1996: 120). Pra, siç mund të vërehet kemi një kombinim të riteve që i përkasin edhe dasmës së improvizuar e që ndërlidhet me meshkujt, apo krushqit e dasmës që e sjellin nusen në fshat, por edhe riteve që ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kremten e Shëngjergjit e të cilat ekzekutohen nga bota femërore. Tanimë dihet se veza, uji, ngrënia e përbashkët e ushqimit, kanë simbolikën e tyre që ndërlidhen kryesisht me ndjelljen magjike të shëndetit të anëtarëve të familjes. Veza, si zakonisht, paraqet simbol të parimit jetësor, pastaj regjenerimit, fillimit të jetës e kështu me radhë. Në shumë mitologji të ndryshme në botë, veza paraqet edhe simbolin e krijimit të botës (më gjerësisht, Kuper, 1986: 54). Edhe uji, paraqet burimin e krijimit të të gjitha gjërave në botë, andaj stërpikja me të nënkupton edhe purifikim, apo spastrim, por njëkohësisht edhe një lloj të ringjalljes në kondita të fillimit të një jete të re.

Tani i kthehemi dasmës së improvizuar që është edhe synimi kryesor i këtij punimi. Pra, krushqit me nusen hyjnë në rrugët e fshatit ku numri i njerëzve vjen gjithnjë e më shumë duke u shtuar. Të gjithë i bashkohen varganit të dasmorëve të cilit i prijnë krushqit më të moshuar. Këta prijës të varganit ndonjëherë e ndalin lëvizjen e tyre dhe fillojnë të këndojnë këngë tradicionale të burrave që këndohen, nënkuptohet në këtë anë. Ndërkaq, kur pushojnë ata, fillon vargani të lëvizë me nusen dhe fillojnë të këndojnë të rinjtë këngë të grave, por që ia dedikojnë enkas nuses së re. Në të vërtetë, këndohen këngë tipike të dasmës që e shoqërojnë nusen kur arrin në shtëpinë e dhëndrit. Disa këngë të kësaj natyre janë regjistruar, shënuar dhe publikuar nga Edibe Selimi – Osmani, si p. sh.: *Kaush t’përcoull, nouse, njer ke Vardari? / Aj vëlla derri, veshët si magari. / Koush t’përcoull, nouse, njer ke mullejni? / Aj vëlla derri, veshët si menji* (Osmani–Selimi, 1996: 120). Pra, siç mund të vërehet,

përmbajtja e këngës është e natyrës komike, pasi përqeshen anëtarët e familjes së nuses. Njëkohësisht, nuk mungojnë edhe këngët që i destinohen nuses, si: *Okolla maleve po na bije vдор, / Dë vije fëllonze malit me sahat në dorë, / okolla maleve po na bije shej, / de vije fëllonz e malit me sirme*²⁵ *në sej* (Osmani–Selimi, 1996: 120). Në këtë kontekst duhet shtuar edhe faktin se nusja duhet të jetë vazhdimisht aktive në dëgjimin e vargjeve të këngës, pasi ato kërkohen edhe ushtrimin e ndonjë rituali nga ana e saj. Vargjet e tilla, si: *Bën temena nuse pi për trolli / se te kena taj nause Stambolli*, nusja duhet t'i shoqëroj me ritualin e temenasë, përkatësisht me lëvizjen e dorës së djathtë drejt ballit (fig. 3).



Fig. 3



Fig. 4

Njëkohësisht, edhe dhëndri është në epiqendër të vëmendjes, pasi edhe atij i përkushtohen këngë adekuate nëpërmjet të cilave i bëhet thirrje që të dal dhe ta shoh nusen e bukur e cila është zbukuruar, kyesisht me florinj. P. sh.: *Dil Bajram Aga, dil ke pojata! / vin gji-zele honni krejtë me shamata, / dil Bajram aga, dil ke dera! / vin Vexhi honni krejet me tela, / dil Bajrom aga, dil ke loma! / Vin Vebi honni, çafën me alltona* (Osmani–Selimi, 1996: 1201). Kulminacioni i kësaj dasme të improvizuar arrihet në çastin kur nusja arrin te dhëndri i cili nga një distancë e caktuar hapësinore praktikon ritualin e venerimit të nuses nëpërmjet sitës, por paraprakisht nga ajo hudh edhe ndonjë grusht me leblebi, grurë, kollomoq, apo

²⁵ Sirme – vizatime me ngjyra në sy.

ndonjë sheqerkë (fg. 4). Ky ritual përcillet nga vargjet e këngës si vijon: *Hajde ago baba ku ije, / paret e dahires ku i kije.*²⁶ Në vazhdim pason edhe rituali i fundit i zbritjes së nuses nga kali. Përprakisht, zbritet një fëmijë i vogël i gjinisë mashkullore i cili kish-te qëndruar i ulur në kalë para nuses, apo në prehrin e saj, nënkuptohet për një kohë fare të shkurtër në funksion të ushtrimit të aktivitetit me prapavijë magjike. Në të vërtetë, kjo magji është e karakterit imitativ nga e cila kërkohet që të ndillet lindja e fëmijëve të gjinisë mashkullore nga ana e nuses. Po ashtu edhe hedhja e gjësendeve të mësipërme nga sita paraqet një lloj magjie nga e cila pritët që nusja të sjell bereqet, apo pjellori në shtëpinë e re. Zbritja e nuses nga kali shoqërohet me valle. Kësaj valle i prin dhëndri i cili manifeston gëzimin e tij që po luan së bashku me nusen. Vallja luhet nën tingujt e surleve dhe tupanit. Nusja vazhdon të luajë me dhëndrin – vejan i cili nuk e fsheh gëzimin nga sjellja e një nuse të re. Në ndërkohë, duke luajtur valle, nusja e zbulon fytyrën e saj të vërtetë dhe rezulton se ajo është e gjinisë mashkullore. Tani dasma merr karakter komik dhe fillojnë të qeshurat e të panishmëve.

Nga e gjithë kjo që u theksua më sipër rezulton se dasma e improvizuar ndjek logjikën e një dasme të mirëfilltë me ndryshimin e vetëm që këngët e dasmës këndohen nga të rinjtë dhe nusja rezulton në fund të jetë e gjinisë mashkullore. Pra, kemi një përmbysje të rendit logjik të gjërave, gjë që shkakton pastaj si zakonisht edhe të qeshurat.

Ndërkaq, një tjetër fakt i rëndësishëm është edhe tentimi i ndër-lidhjes së kësaj dasme me ndonjë ngjarje të karakterit historik, por që më tepër i ngjason legjendës sesa ndonjë ngjarje të vërtetë. Në këtë kontekst, një bashkëbisedues i fshatit Reçan, thekson: *Kanë qon do hajduta, a komita, nuk e di çka kan qon ato, e kan pas na-*

²⁶ Vargjet e kësaj kënge, por edhe të materialit tjetër empirik jo të cituar me të cilin shërbehemi në kuadër të punimit shkencor janë siguruar nga dy emisione dokumentare kushtuar dasmës së improvizuar në Reçan të Gostivarit. Emisioni i parë dokumentar me titull *Flakadani i Shën Gjergjit në Reçan – Gostivar* është realizuar nga MRTV2. Autore: Diellza Miftari; Emisioni i dytë me titull *Gjurmët* është realizuar nga Shoqata joqeveritare *Loja* me seli në Tetovë.

merën t'i bien katundit tonë natën e Shinxherxhit. Mirëpo ni go-vadar ç'i i ka rujt lopët e kishte hup ni lop. T'u kërku lopën kur çëllon aqe, n'at vend ku festojm ne, osh ni vend ç'i as zarrmet nuk duken larg, as era nuk e merr, as shiu e merr, ka pa aqe zarrin, ene i sheh komitat. Ene kan zan luft njani me qetrin; ata kan vra, kto tonët kan vra, ene fundi, një mbetet i xhall pi atine, por i plagosët, ata, pra tonët e kan marr e kan ba si nuse si e bajn ne sot, se ka kon me xhak, kto i kan vu si dullak. Bashkëbiseduesi tjetër i po të njëjtit fshat vë në dukje një variant paksa më tjetër, por të ngjashëm: Në këtë vend, në Krastë ka ndodh një luftë, kanë ardhë e i kanë xhetë ktu, ashtu siç jemi vendos ne, ashtu janë vendos edhe ata, kan ndez zjarrmij, ene janë thajtë, rrobet i kanë thajt, atëherë lajinrohet në fshat se këtu ka ni ushtri, vin katundarët ene i sulmojn, vriten, atë kryesorin, apo kapedanin e marrin ene e bajn nuse. E marrin e vendojn n'kal, e shetisin t'u këndu nëpër fshat. Kjo ngjarje ka ndodh me t'pestin maj dhe n'mëngjes, ditën e Shëngjergjit, e kanë prur nusen në fshat²⁷. Pra, siç mund të vërehet nga bashkëbiseduesit që e tregojnë ngjarjen e tillë, është tepër vështirë për të besuar në vërtetësinë e saj, pasi ajo nuk është e dokumentuar, madje bashkëbiseduesit i referohen një kohe shumë të lashtë, edhe pse ndonjëherë duan që ngjarjen ta fiksojnë edhe për ndonjë kohë konkrete, apo të mëvonshme që mund të identifikohet me hajdutët, apo bullgarët, serbët e kështu me radhë. Një pretendim i tillë sikur mëton më tepër të justifikojë kremtimin e kësaj feste duke u nisur nga arsye historike. Me siguri se baza e këtij kremtimi është e karakterit mitik, madje edhe shumë e lashtë, por në ndërkohë, ajo ka pësuar modifikime dhe ndryshime. Në të vërtetë, sipas Meletniskit, fazat themelore në kuadër të procesit të transformimit të mitit në ndonjë rrëfim popullor janë: deritualizimi dhe desakralizimi, dobësimi i besimit në vërtetësinë e “ndodhive” mitike, zhvillimi i mendimit shoqëror, zëvendësimi i heronjve mitikë me njerëz të zakonshëm, zëvendësimi i kohës mitologjike me ndonjë kohë të papërcaktuar në

²⁷ Rrëfimet e bashkëbiseduesve janë transkriptuar nga emisionet dokumentare, të cituara paraprakisht. Edhe fotografitë janë huazuar nga emisionet në fjalë.

kuadër të përmbajtjes së rrëfimit popullor e kështu me radhë (Meletinski, 2002: 321).

Pra, faza e fundit e kësaj dasme të improvizuar që ka mbijetuar sot e që është e karakterit komik me siguri se paraprakisht nuk ka qenë e tillë. Kjo dasmë e improvizuar në kontekstin e sotëm kohor me siguri se në kohërat më të lashta ka qenë një dasmë e shenjtë, apo martesë e shenjtë që në aspektin magjik duhej të ndikonte në rritjen e pjellorisë, qoftë të asaj blegtorale, apo bujqësore. Një dasmë e tillë, në kontekstin e sotëm kohor, ka humbur kuptimësinë mitike, apo është çmitizuar duke pretenduar të marr përmasa të natyrës historike. Pra, struktura e mitit si rrjedhojë e transformimit të vetdijes njerëzore, degjenerohet dhe ia lë vendin legjendës, apo ngjarjes konkrete, kryesisht asaj me përmasa historike. Studiuesi i historisë së religjioneve botërore, Elijade, thotë se çdo ritual imiton ndonjë model hyjnor, apo ndonjë arketip, por në çastin kur ai bëhet i pabesueshëm atëherë kërkohet ndonjë model, apo narracion tjetër (Elijade, 1992: 103–121). Si rrjedhojë, arketipi mitik shndërohet në legjendë me përmasa historike, apo diçka tjetër. Pra, edhe dasma e Reçanit kërkon modelin e ekzistimit të saj në ndonjë periudhë të caktuar historike, por paksa të mjegulluar.

Në bazë të analizës krahasimtare, në tekstin e mëposhtëm, do të vërejmë sesi janë dukur manifestimet e tilla te popujt e ndryshëm të cilët i kanë regjistruar ato në një kohë të mëhershme e që gjithsesi se përmbajnë edhe elemente më parake, apo arkaike. Në bazë të shembujve të mëposhtëm me siguri se do të kemi një pasqyrë më të qartë rreth evoluimit të kuptimësisë edhe të dasmës së improvizuar të Reçanit.

2. Sprovë e interpretimit të prapavijës së ekzekutimit të dasmës së improvizuar

Në kuadër të shpjegimit të kuptimësisë, apo dekodimit të dasmës së improvizuar të Reçanit do të shërbejemi me disa rituale të ngjashme të kësaj natyre, por që janë praktikuar te popujt tjerë. Nënkup-

tohet se këto rituale janë shënuar më herët, diku në shekullin e XIX dhe janë përfshirë në librin monumental me titull “Dega e artë” i shkruar nga antropologu i njohur, Xhejms Frejzer. Ai në këtë libër tejet voluminoz përmend disa rituale të lashta që janë ushtruar në pjesë të ndryshme të botës. Kështu në kremten pagane të 1 Majit që shënohej në pjesë të ndryshme të Evropës, si në Angli, Francë, Gjermani e kështu me radhë, ishte e njohur edhe praktika e sjelljes në fshat të ndonjë druri, apo shtyllës së majit, siç ishte pagëzuar ajo. Kjo sillej në fshat nëpërmjet kortezhit solemn. Vendosej në sheshin e fshatit, ose qytetit. Ky dru ose kjo shtyllë e drurit zbuturohej me vegjetacion dhe të rinjtë luanin dhe vallëzonin rreth saj. Antropologu, Frejzer, jep mes tjerash, edhe ritualin e slovenëve të Korushkës, ku të rinjtë, në prag të Shëngjergjit, e zbukuronin me kurora dhe lule ndonjë dru të prerë në mal i cili pastaj bartej në fshat nëpërmjet kortezhit solemn dhe nën përcjellje të muzikës dhe ahengut. Figura kryesore e kortezhit ishte i ashtuquajtur “Gjergji i gjelbër”, një i ri, i mbështjellë prej kokës e deri te këmbët me degë të gjelbëra mështekne (Frejzer, 1977, 1: 158).

Pa mos shënuar edhe shumë shembuj të tjerë të kësaj natyre të cilët i jep antropologu, Frejzer, bëhet e qartë se në këto procesione, apo kortezhe pranverore, shpirti i vegjetacionit mishërohet në drurin e majit, por dhe në figurën e njeriut të mbuluar me degë dhe lule të ndryshme të gjelbërta. Në shumicën e rasteve, figura njerëzore që përfaqësonte shpirtin e vegjetacionit quhej mbret ose mbretëreshë. Sipas studiuesit, Manhart, kjo bëhet me qëllim që shpirti i vegjetacionit, i mishëruar nëpërmjet figurës së mbretit ose mbretëreshës, të rrisë energjinë krijuese, ose frytnuese. Në disa vende, sipas antropologut Frejzer, ky shpirt i vegjetacionit përfaqësohej vetëm nga mbretëresha, kurse ndonjëherë tjetër përfaqësohej paralelisht edhe nga mbreti, edhe nga mbretëresha, pra nga ndonjë i ri dhe e re. Me këtë rast, simulohej edhe ndonjë dasmë, apo martesë midis tyre që i ngjasonte dasmës së improvizuar të Reçanit. Pra, nusja e re përfaqëson shpirtin e vegjetacionit, ajo identifikohet me verën e cila veçohet me energjinë, apo fuqinë e madhe të pjellorisë.

Duhet theksuar se paraardhësit tanë i kanë personifikuar fuqitë e bimëve si qenie mashkullore dhe femërore dhe kanë tentuar, sipas parimit të magjisë homeopatike ose imitative, të nxitin rritjen e drunjve dhe bimëve, kuptohet nëpërmjet imazhit të martesës së hyjnive pyjore, të mishëruar në figurën e mbretit dhe mbretëreshës, ose dy të rinjve të gjinive të kundërta. Pra, këto imazhe, ose përfytyrime, nuk kanë qenë thjesht drama simbolike ose alegorike, skena baritore të argëtimit, por kanë qenë praktika magjike, qëllimi i të cilave ishte që të ndikonin në gjelbërimin e pyjeve, rritjen e kullosave, rritjen e të mbjellurave e kështu me radhë. Ishte e natyrshme të mendohet se poqese aktrimi i protagonistëve të mbështjellë me vegetacion, imitonte saktësisht martesën e vërtetë të hyjnive pyjore, atëherë edhe praktika magjike do të ishte më e suksesshme.

Sipas opinionit të pjesëmarrësve, martesë e drunjve dhe bimëve, nuk mund të ishte e frytshme pa bashkimin e vërtetë të çifteve bashkëshortore njerëzore.

Pra, këto rite që sot kanë marr karakter argëtues, me siguri se në të kaluarën kanë qenë shumë serioze, pasi kanë pasur karakter të shenjtë, përkatësisht nga ekzekutimi i mirëfilltë i tyre, është varur ekzistenca biologjike. Modeli i këtyre kremtimeve ndoshta duhet kërkuar në mitologjinë e lashtë, qoftë greke ose romake. Këto kurorëzime të hyjnive (femër dhe mashkull) në formë të dramave, janë ekzekutuar si rite serioze fetare në shumë pjesë të botës antike. Pra, nëpërmjet procesioneve, akteve dramatike është përsëritur veprimi i hyjnive të vegetacionit. Kështu, Dijana romake ishte hyjneshe e pyllit. Tempujt e saj ndodheshin nëpër koriye (pyje të vegjël). Dijana nuk ishte vetëm hyjneshe e drunjve, por si edhe simotra e saj greke Artemida, duket se edhe ajo është zhvilluar në personifikim të begatisë jetësore të natyrës, si të asaj bimore, edhe të asaj shtazore. Ajo në disa statuja është paraqitur me shumë gjinj dhe simbole të tjera të pjellorisë. Sipas parimit që mbështetet në logjikën e thjeshtë se hyjnesha e pjellorisë, patjetër edhe vetë të jetë pjellore, edhe Dijana duhej të kishte bashkëpunëtorin e saj mashkullor. Bashkëshorti i saj, nëse mund të mbështetemi në pohimin e Servijit,

ishite Virbriu i cili kishte përfaqësuesin e vet, ose thënë më saktë mishërimin e tij në mbretin e pyllit në Nemi. Qëllimi i lidhjes së tyre seksuale ishte nxitja e pjellorisë së tokës, botës shtazore dhe asaj njerëzore. Nga kjo mund të konkludohet fare natyrshëm se ky synim do të realizohej vetëm nëse ky bashkim i shenjtë hyjnor, do të kremtohej për çdo vit dhe kur rolin e bashkëshortit dhe bashkëshortes hyjnore do ta luanin statujat e tyre, ose qeniet njerëzore në trajtë të femrës dhe mashkullit. Pra, Frejzeri jep një numër të madh të shembujve të martesës së shenjtë e cila është kremtuar nga shumë popuj të lashtë me qëllim që të përforcohet pjelloria e tokës nga e cila, sipas besimit tradicional, varej jeta e kafshëve dhe njerëzve. Në këto rite, në shumicën e rasteve, rolin e çiftit të ri hyjnor e merrnin një subjekt i gjinisë mashkullore dhe një subjekt i gjinisë femërore. Është e natyrshme që në dramat magjike, qëllimi i të cilave ishte dëbimi i dimrit dhe kthimi i verës, vëmendje e veçantë t'u kushtohej bimëve dhe drunjve. Duket se këto aktivitete rituale askund nuk kanë qenë aq shumë të përhapura dhe aq shumë solemne sa te popujt e bregdetit lindor të Detit Mesdhe. Me emrat Oziris, Tamu, Adonis dhe Athis, popujt e Egjiptit dhe Azisë Perëndimore kanë përfaqësuar vdekjen dhe rigjallërimin e jetës, veçmas të asaj bimore për të cilën kanë konsideruar se është mishëruar në hyjninë që vdiste gjatë çdo viti, por njëherit edhe ringjallej. Kështu, adhurimi i Adonisit ka ekzistuar te popujt semit, si në Babiloni dhe Siri, kurse grekët e huazuan nga ta diku kah shekulli i shtatë para Krishtit. Adonisi, në letërsinë fetare të Babilonisë, është paraqitur si një bashkëshort i ri ose dashnor i hyjneshës – nënës së madhe Istar, personifikuese e fuqive pjellore të natyrës. Adonisi ose Tamuzi, sipas përmbajtjes mitike, vdiste gjatë çdo viti dhe shkonte nga toka e gëzuar në botën e errët nëntokësore. Në periudhën e mungesës së tij, dashnorja e tij hyjnore me qëllim që ta gjente, zbriste në botën nëntokësore. Gjatë kohës kur mungonte ajo, epsi i dashurisë nuk vepronte; njerëzit dhe kafshët harronin të shumoheshin; shkatërrimi i kanosej jetës së përgjithshme. Pra, funksionet seksuale të mbarë botës shtazore dhe bimore ishin të ndërlidhura me hyjneshën, andaj

mungesa e saj, i paralizonte ato. Meqenëse, jeta në tokë varej nga ajo, atëherë mbretëresha e nëndheshme, lejonte që hyjnesha Istar, së bashku me dashnorin e saj Adonisin (Tamuzin) të ktheheshin në tokë, përkatësisht në botën e sipërme ku pas kthimit të tyre fillonte menjëherë edhe ringjallja e natyrës (Frejzer, 1977, 1: 399–400).

Pra, nga shembujt që i jep Frejzeri mund të venerohet se dasma e shenjtë nënkuptonte martesën midis gruas – bartëse të parimit femëror dhe burrit – bartës të parimit mashkullor. Kemi të bëjmë me një fazë historike kur njeriu kishte ardhur te e dhëna se pjelloria ose frytnimi ishte rrjedhojë e kontaktit seksual midis parimit femëror dhe mashkullor. Nënkuptohet se kjo fazë është shumë e mëvonshme, pasi njeriu para kësaj faze nuk ishte i vetëdijshëm se frytnimi ishte pasojë e kryqëzimit të parimit mashkullor dhe femëror. Në këtë kontekst, studiuesi Marijan Koshiček në librin e tij me titull *Miti dhe seksi* thekson se në shkallën më të ulët të zhvillimit shpirtëror, njeriu nuk bënte ndonjë ndarje midis tij dhe natyrës. Kjo do të thotë se edhe jeta jashta fuqisë njerëzore krijohet në mënyrë të njëjtë si ajo njerëzore. Në llojin njerëzor vetëm gratë lindin fëmijë. Njerëzit e lashtë, me siguri deri në kohën e re të gurit, nuk kanë ditur asgjë për pjesëmarrjen e mashkullit në krijimin e qenieve të reja njerëzore – fëmijëve. Ata konsideronin se lindja e fëmijëve ishte vetëm aktiviteti i femrave. Kontaktin seksual të gruas dhe mashkullit nuk ishin në gjendje ta perceptojnë si shkaktar kryesor të lindjes së pasardhësve. Ky njeri i lashtë i kësaj periudhe, edhe krijimin e botës në përgjithësi, apo lindjen e çdo gjëje në botë, si lindjen e trupave qiellorë, ujit, kodrinave etj., ia atribuonte një hyjneshe që posedonte fuqi të pazakonshme. Pra, përderisa çdo njeri dhe çdo kafshë kishte vetëm një nënë, atëherë pse edhe çdo gjë tjetër në natyrë, – pyetjet njeriu i lashtë, – të mos kishte një nënë. Nënkuptohet se kjo nënë e përgjithshme patjetër të ishte gjithëpërfshirëse dhe me siguri një qenie shumë e fuqishme – ndonjë Nënë e Madhe. Kjo Nënë e Madhe, sipas kësaj logjike arkaike, nuk mbetej shtatzënë si rrjedhojë e veprimit të bashkëshortit – mashkullit, por ajo lindte vetvetiu. Ky akt është i njohur me shprehjen *partenoge*–

nezë që përbëhet nga fjalët *parthénos* (virgjëreshë) dhe *génesis* (lindje) e që nënkuptonte shumimin seksual pa aktin e mëparshëm të frytnimit. Pra, qenia femërore bëhej nënë, por mbetej virgjëreshë. Kjo ishte fazë e tillë kur mendohej se mashkulli nuk participonte në lindjen e fëmijës dhe në mënyrë analoge me këtë edhe në lindjen e botës. Megjithatë, lindja nuk ndodhte menjëherë pas aktit seksual, njeriut i është dashur ta kuptojë këtë fshehtësi, pas kalimit të një kohe të gjatë. Autori Koshiçek në librin në fjalë jep edhe shumë të dhëna të tjera lidhur me Nënë e Madhe, përkatësisht si ajo ishte perceptuar te disa popuj të lashtë (Koshiçek, 1991: 10–12).

Më vonë gjatë zhvillimit të tij, njeriu i lashtë do të krijojë një botë-kuptim tjetër për hyjninë e parë të krijimit të botës. Pra, ky njeri i lashtë kur do të bëhet i vetëdijshëm se edhe ai participon, apo është i barabartë në aktivitetin seksual të lindjes së pasardhësve, do ta ndryshojë edhe përfytyrimin për hyjninë, apo perëndinë e parë të krijimit të botës e cila paraprakisht kishte qenë vetëm e gjinisë femërore dhe siç vërejtëm më lartë, kishte lindur vetvetiu. Tani edhe mashkulli dëshironte të ishte në fillimin e krijimit të botës e jo të ishte vetëm si qenie që kishte lindur nga femra, por si qenie që kishte marrë pjesë në lindjen e botës, së bashku me femrën. Në fillimin e këtij gjykimi, ai ende ndihej një me femrën. Në aspektin biologjik dhe jetësor, ai ishte fuqimisht i lidhur me atë – femrën. Prej këtij, ndoshta ka buruar ideja e disa paraardhësve tanë të lashtë se botën e ka krijuar dhe jetën e mbajnë të tillë krijesat mbinatyrore që i posedojnë në vete cilësitë e të dy gjinive. Autori Koshiçek, në këtë drejtim përmend shumë shembuj të popujve të lashtë, përkatësisht si ata i perceptonin këto hyjni. Kështu, mes tjerash përmend edhe shembullin e hetitëve (popull me prejardhje indoevropiane i cili rreth vitit 2000 para erës sonë ishte vendosur në Anadolinë e sotme lindore të Turqisë ku kishte themeluar një shtet të fuqishëm dhe mbretërit e tij kishin zgjeruar pushtetin e tyre në Mesopotami dhe Siri. Kah viti 1200 i erës sonë, të ashtuquajturit “njerëz nga deti”, pushtues të popullatës së panjohur kishin rrënuar shtetin hetit. Gjatë shekujve të ardhshëm, hetitët si popull plotësisht ishin

zhdukur nga skena e jetës) të cilët parahyjnë të tyre i kishin përfytyruar si meshkuj me emrin Perëndia e Madhe dhe si femra të cilën e kishin pagëzuar si Perëndesha e Madhe. Të dy perënditë, kishin poseduar atributet e të dy gjinive. Kështu, Perëndinë e Madhe e kishin paraqitur si mashkull, por i kishin atribuuar edhe gjinj. Ndërkaq, Perëndesha e Madhe kishte figurën e gruas, por që barte edhe mjekër. Rrëfimin e njëjtë për njerëzit e parë e jep edhe filozofi helen Platoni në veprën e tij *Gostia*. Në këtë vepër autori i njohur i komedive rrëfen: “Së pari kanë qenë tri gjini njerëzore, jo sikur tani vetëm dy, ajo mashkullore dhe femërore, por ishte edhe një gjini e tretë e cila i takonte edhe njëres edhe tjetres dhe nga e cila sot ka mbetur vetëm emri, kurse ajo vetë është zhdukur: gjinia mashkullore – femërore (androgjine), ka qenë atëherë një edhe sipas formës dhe emrit, e përbërë nga të dy gjinitë”. Këta njerëz të parë, thotë më tutje Aristofani, ishin shumë të fuqishëm dhe perënditë u frikësuan se mund të rrezikoheshin, andaj i përgjysmuan dhe nga çdo gjysmë e tyre krijuan qenie të veçantë. Ndërkaq, njeriu asnjëherë nuk harroi se është vetëm gjysma e qenies parake. Tek ai ka mbetur nevoja të bashkohet me gjysmën tjetër të dikurshme. Nëse e ka prejardhjen nga qenia parake dygjinore, mëton të bashkohet me qenien e gjinisë së kundërt. Nëse, prindërit e tij parak ishin qenie të një gjinie, do ta tërhiqnin qeniet e gjinisë së njëjtë. Kështu, Aristofani, përkatësisht Platoni, tentonte të sqaronte prejardhjen e instinktit seksual, edhe atë jo vetëm të atij heteroseksual, por edhe të atij homoseksual (sipas Koshiçek, 1991: 36–38). Studiuesi Koshiçek përmend edhe shumë shembuj të tjerë ku dalin në sipërfaqe elemente të hermafroditizmit, përkatësisht hyjnisë dygjinore të krijimit të botës.

Pra, edhe në rastin e Shëngjergjit kemi të bëjmë me një kozmogoni (krijim të botës) të llojit të vet. Kjo festë nënkupton lindjen e vegjetacionit, pra lindjen e një jete të re në natyrë. Nënkuptohet se njeriu pagan këtë lindje të re e ka përfytyruar si veprim të parimit mashkullor dhe femëror. Pikërisht, në këtë funksion janë improvizuar edhe dasma të shenjta me qëllim që të ndikohej nëpërmjet

aktit seksual edhe në shtimin e rendimenteve natyrore. Dasma që ekzekutohej në fshatin Reçan të Gostivarit është ndoshta një rit shumë i lashtë dhe i përshtatet logjikës së mitit hermafrodit të krijimit të botës, pasi subjekti që simulon nusen e re është i gjinisë mashkullore. Ai paraprakisht vishet si nuse dhe në momentin kur vejani (pretenduesi i tij) i afrohet t'ia heq duvakun, atëherë zbulohet se nusja është e gjinisë mashkullore dhe pastaj krijohet një situatë komike nga të pranishmit. Pra, këtu kemi të bëjmë me fenomenin e veshjes së rrobave të gjinisë së kundërt i cili quhet *transvestizëm*. Duhet theksuar se elementet e këtilla ku del në shesh transvestizmi, gjegjësisht kur tentohen të merren attribute të gjinisë së kundërt, janë të pranishme atje ku tentohet të bëhet kalimi nga një fazë jetësore në një fazë tjetër jetësore. Në vetë fazën e kalimit, apo në fazën *liminale* siç e kanë pagëzuar studiuesit, kur duhet të ndodh ky ndryshim i gjendjes, apo statusit, simbolizmi më i theksuar, apo qendror reflektohet në paradoksin për të qenë edhe *ky* edhe *ajo*, pra një përzierje e statusit të gjinisë. “Në të gjitha këto raste fshihet shenja dominante e një “totaliteti” ritual, një reintegrim i kundërtënieve, një kthim në primordialitetin e pahetuar. Në shumë rite të kësaj faze nxitet kthimi simbolik në “Kaos” në tërësinë e padiferencuar që i paraprin “Krijimit” dhe bëhet kthim i pahetuar nëpërmjet një regjenerimi suprem, nëpërmjet një rritjeje të mrekullueshme kah fuqia” (Eliade, 1992: 164). Pra, edhe në ritin e dasmës së Reçanit ndodh një kalim, përkatësisht bëhet ndryshimi i vitit, kalohet në një vit të ri blegtoral, andaj është i lejuar ndryshimi i përkohshëm, qoftë edhe simbolik i gjinisë, siç ndodh me nusen – mashkull (më gjerësisht Murtezani, 2001). Pra, në rastin konkret kemi një shkrim të logjikës kalendarike me atë antropologjike. Meqenëse kemi lindje të re në planin kalendarik, apo lindje të një viti të ri, nënkuptohet se kemi një kthim në fazën e Kaosit, në kohën e një tërësie të padiferencuar në planin gjinor, andaj edhe në planin antropologjik, përsëritet një logjikë e kësaj natyre me atë se nusja e re e dasmës së Reçanit, përfaqëson këtë fazë, përkatësisht një integrim në vetvete të dy gjinive. Në të vërtetë çdo lindje e parë

nënkuptonte posedimin e të dy gjinive. Shumimi i parë, sipas logjikës arkaike, niste nga vetvetja.

Pra, në rastin e dasmës së Reçanit ruhet trajta e vjetër e besimit, përkatësisht e hermafroditizmit dhe transvestizmit, pasi burri (veja-ni) që përgatitet ta pres në shtëpi, kinse nusen e re, do të befasohej kur ajo do ta zbuloj gjininë e saj mashkullore. Ky rit edhe pse i ka të gjitha shenjat e një argëtimi, nuk do të thotë se në të kaluarën nuk ka pasur ndonjë status më serioz në aplikimin e tij. Dihet nga etnologia se shumë rite dikur serioze më vonë me humbjen e besimit në to, përkatësisht me transformimin e vetëdijes, shndërrohen në lojëra fëmijërore me karakter argëtimi.

Në fund, në vija të përgjithshme, në trajtë të rrumbullakimit të materies në fjalë, mund të themi se në kuadër të kulturës popullore të natyrës rituale, mund të shpalosen veçori dhe karakteristika që manifestojnë shijen dhe synimin e bashkësisë njerëzore në drejtim të krijimit të formave të veçanta estetike që janë fryt i kohës nëpër të cilën është ecur gjatë periudhave të ndryshme historike. Në bren-dinë e këtij lloji të artit popullor ka zënë vend edhe nevoja objektive e rregullimit të jetës shoqërore përmes normave dhe ritualeve të pranura kolektive në të cilat në mënyrë autentike reflektohen elemente të moralit dhe përvojës, të drejtës zakonore, forma të shprehjes së gëzimit dhe hidhërimit kolektiv, etj. Pra, riti, si një trajtë e rëndësishme e organizimit të kohës së njeriut pagan, por në raste të caktuara, edhe të atij të sotëm, paraqet një element thelbësor në kuadër të sistemit të vlerave kulturore tradicionale të një shoqërie të caktuar. Duke folur për ritin, një ndër antropologët më të shquara të bashkëkohësisë, Meri Dagllas (1993: 89) thekson se ka gjëra të cilat pa praninë e tij (ritit) nuk mund t'i shijojmë. Ajo, trajtës së ritit i atribuon status ontologjik duke shtuar se ai (rituali) nuk është as reflektim dytësor i mitit e as trajtë manifestuese e logosit – dijes, por trajtë autonome e shprehjes së një kuptimësie të shpirtit e cila nuk mund të shprehet në asnjë formë tjetër. Rituali si segment i rëndësishëm i distinkcionit të kohës, paraqet trajtë autonome dhe në sferën shpirtërore, ka *karakter ontologjik*. Ai, si i tillë, edhe duhet

studiuar. Në fund do të theksonim: nga jeta pason vdekja, kurse nga vdekja jeta. Jeta lëviz prej natyrës kah kultura, ose më mirë thënë *ndërmjet* natyrës dhe kulturës. Ritet, si krijimtari kulturore, vërtojnë këtë ndërlidhje, “bartin mesazhe kolektive” (Liç, 1983: 69) dhe duke formësuar identitetin kulturor përtërijnë rendin social dhe kulturor.

Bibliografia:

- Belaj, Vitomir (2007): *Hod kroz godinu. Pokušaj rekonstrukcije prahrvatskoga svjetonazora*. “Golden marketing – Tehnička knjiga”. Zagreb.
- Daglas, Meri (1993): *Čisto i opasno. Analiza pojmova i prljavštine i tabua*. “Plato”. Beograd.
- Elijade, Mirça (1992): *Aspekti na mitot*. “Kultura” – Skopje.
- Frejzer, Džordž Džejms (1977): *Zlatna grana, 1. 2. Proučavanje magije i religije*. BIGZ. Beograd.
- Košićek, Marijan (1991): *Mit i seks*. “Prosvjeta”. Zagreb.
- Kuper, K. Dž. (1986): *Ilustrvana enciklopedija tradicionalnih simbola*. “Prosveta–Nolit”. Beograd.
- Liç, Edmund (1983): *Kultura i komunikacija. Logika i povezivanja simbola. Uvod u primenu strukturalističke analize u socijalnoj antropologiji*. “Prosveta”. Beograd.
- Meletinski, M. E (2002): *Poetika e mitit*. “Tabernakul”. Skopje.
- Murtezani, Izaim (2001): *Në shtjellën e arketipeve*. “Flaka”. Shkup.
- Osmari – Selimi, Edibe (1996): *Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe Gostivarit*. SHB “Asdreni”. Shkup.
- Shabani, Fejzulla, Dervishi, Nebi (2015): *Reçani i Pollogut të Epërm. Vatër e rezistencës, arsimit dhe kulturës (monografi)*. “Iris”. Strugë.

NEBI DER VISHI

Universiteti i Tetovës

RITET E MOTMOTIT DJE DHE SOT NË TREVAT LINDORE SHQIPTARE

Nga lënda e gjerë etnologjike e cila dita–ditës, nën presionin e faktorëve të ndryshëm, po i humbet vlerat e saj autentike, një vend të veçantë zë cikli festave kalendarike popullore si dhe ritet dhe këngët me të cilat shoqërohen ato, të cilat në strukturën e tyre përmbajtjesore mbarsin një varg formash arkaike, përmes të cilave reflektohet mënyra e jetesës, gjegjësisht botëkuptimi apo interpretimi i fenomeneve natyrore nga paraardhësit tanë më të hershëm. Njeriu, gjegjësisht paraardhësit tani duke qenë të varur dhe të lidhur ngushtë me natyrë nga e cila siguronin ekzistencën, kanë ndërlidhur festat kalendarike me ditë të caktuara të vitit dhe me ndihmën e riteve të motmotit dhe këngëve të krijuara enkas për këtë rast kanë tentuar t'i zhdukun forcat misterioze për të cilat është menduar se janë të dëmshme për shëndetin, familjen, bagëtinë, etj. Në këtë kuadër, vlen të theksohet fakti se “studimi i festave ritual të motmotit, qoftë edhe në këtë fazë të vonë, ndriçon një periudhë të caktuar të zhvillimit historiko–shoqëror të vendit, dëshmon për autoktoninë e popullit, për bazën unitare etnike të tij, për ndryshime, afri dhe ndikime të ndërsjellta me popujt fqinj”. (Mr. Izaim Murtezani, “Simbolika e riteve të Ditës së Verës nga treva Dervenik e Shkupit”, Fakti, 21–22.08.1998).

Shqiptarët e trevave lindore (Kosovë e Maqedoni Perëndimore) nga pikëpamja konfesionale i takojnë përgjithësisht besimit islam (sunitë dhe bektashianë), dhe një pjesë e vogël besimit të krishterë. Mirëpo, në kalendarin e festive të tyre fetare, ata kremtojnë, edhe sot e kësaj dite, edhe festa të tyre të ritit pagan e të krishterë, e cila pa dyshim është shprehje tradicionale apo trashëgimisë së lashtë histo–

rike, kohë kur i ushtronin apo kultivonin këto besime. (dr. Qemal Murati, “Kërçova në traditat e saj të vjetra”, f.101).

Ritet e motmotit apo festat e motmotit zënë një vend me rëndësi në lirikën e trevave lindore shqiptare, të cilat janë të shoqëruara me rite dhe këngë popullore. Kryesisht këngët këndohen apo interpretohen nga fëmijët, ndërkaq formulat magjike dhe ritualet zhvillohen nga gratë e moshuara. Kjo ndodh kështu ngase këto krijime dhe këto festa janë shumë të vjetra e araike dhe në ta hasen gjurmë të lashta pagane. Nuk janë të rralla ato raste, thotë prof. Eqerem Çabej (Studime albanologjike I–II), ku pas emrit krishter ose mysliman të një figure fshihet mbeturina e një figure pagane, të cilën vetëm syri i dijetarit arrin të zbulojë në qenësinë e saj të vërtetë (I. Bafjari, “Jeta në Gur”, Strugë, faqe 354, 1999).

Në kuadër të ciklit të riteve të motmotit dhe të këngëve popullore kalendarike që në shumë rajone të trevave lindore këndohen në veçanti dallohen ato të Ditës së Verës, për të cilat janë të gërshtuara një varg elementesh të magjisë apo religjionit të mëhershëm përmes të cilave insistohet që të zbuten forcat misterioze për të cilat besohet se kanë në duar fatin e njeriut dhe natyrës. Pjesa më e madhe e riteve që ekzekutohen në këtë feste, është e ngjashme me ritet e tjera që zhvillohen në përgjithësi edhe në vise të tjera shqiptare, por, edhe më gjerë, por në këtë drejtim hasen edhe disa elemente specifike, veçmas sa i përket formës së manifestimit të riteve. Në këtë mënyrë, uniteti i riteve Brenda popullit tonë, pa mos i mohuar edhe nuancat lokale, paraqet edhe një dëshmi të unitetit etnik të qenies sonë kombëtare (Izain Murtezani, Simbolika e riteve të Ditës së Verës”, Fakti, 21. 08. 1998).

Është fakt i njohur tanimë se në ritet e motmotit dhe në këngët e festave kalendarike popullore, përveç elementeve të religjionit pagan janë inkorporuar edhe elemente të mëvonshme të religjionit monoteist, por kur është në pyetje Dita e Verës, folkloristi i njohur Qemal Haxhasani me të drejtë konstaton se “në asnjë rast të kësaj feste dhe në asnjë rajon të vendit tonë nuk janë gërshtuar ritet e Ditës së Verës me elemente të religjioneve monoteiste. Dita e Verës

ka mbetur një nga festat tradicionale popullore në të cilën reflektohen në mënyrë më autentike lidhjet e thella shpirtërore të Shqiptarit me përtëritjen e natyrës, botën e luleve, të punës, produktivitetit” (po aty..).

Thelbi i Ditës së Verës është i ndërlidhur ngushtë me ndryshimet astronomike që ndodhin për shkak të rrotullimit të Tokës rreth Diellit me ç’rast krijohen kushte të tjera në natyrë të cilat pastaj ndikojnë ndaj degëve ekonomike: bujqësi dhe blegtori. Për shkak të ndërrimit të kushteve meteorologjike shfaqet kënaqësi për mbarrimin e periudhës dimërore dhe fillimin e periudhës verore kur fillon të gjelbërojë natyra, të ngrohet moti dhe kur fillojnë punët që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe blegtorinë.

Ritet e Ditës së Verës nga disa studiues trajtohen edhe si rite të kalimit, andaj sipas tyre, kjo periudhë kalimtare nga pikëpamja mitologjike konceptohet si kohë–kufi, kohë–kalim ndërmjet dihomive vdekje–jetë, natë–ditë, e vjetër– e re, etj.

Për njeriun religjioz koha nuk është e njëtrajtshme apo e pasëgmentizuar. Ekzistojnë periudha të Kohës së shenjtë, gjegjësisht koha e festive (kryesisht periodike) por ekzistojnë edhe periudha të Kohës profane, kohëzgjatja e zakonshme, e përditshme e kohës, e privuar nga rëndësia religjioze. Ndërmjet dy kohërave të sipërpërmendura, nënkuptohet se ekzistojnë ndërprerje, por njeriu religjioz arrin që përmes riteve të ndryshme, “të kalojë” pa kurrfarë rreziku nga kohëzgjatja e zakonshme në Kohë të shenjtë. Koha e shenjtë sipas natyrës së saj është reversibile, gjegjësisht ajo paraqet Kohën fillestare mitike. Andaj çdo festë.

Në këtë kontekst çdo festë kalendarike popullore, në rastin tonë konkret Dita e Verës, paraqet periudhë apo interval të kohës së shenjtë. Andaj përmes riteve të nduardurshme tentohet të fitohet bekimi apo hiri i forcave të liga me qëllim që të mos rrezikohet ekzistenca e homo religious–it.

Në trevat lindore shqiptare dikur por edhe tani kremtohen në mënyrë masovike me të gjitha ritet përcjellëse këto festa të motmotit : DITA E VERËS (14 mars) ose siç quhet në fshatrat e Strugës

“VERËZA”, DITA E SULLTAN NEVRUZIT (22 mars), FESTA E SHËN GJERGJIT (6 maj); DITA E EREMISË (14 maj) dhe DITA E SHËN MITRIT (8 Nëntor). Në të shumtën e rasteve festat e motmotit në trevat lindore shqiptare me njëdonjë përjashtim të vogël, si në rajonet e Dërvenit të Shkupit, shënohen në datë të caktuar, pra data e kremtes nuk ndryshon.

Dita e Verës zë një vend të caktuar në kuadër të ciklit të festave popullore kalendarike. Në qendër të vëmendjes së kësaj feste qëndron botëkuptimi religjioz–magjik. Sepse ndryshimi i pamjes së natyrës është akt i dëshiruar, gjegjësisht fryt i një vullneti kolektiv. Të gjitha ritet që ekzekutohen për këtë festë popullore kanë për qëllim dëbinin e forcave të liga si dhe sigurimin e fryteve në të ardhmen. Veçoritë themelore që përbëjnë semantikën e Ditës së Verës në të gjitha trevat etnike të trevave lindore mund të ndahen në disa grupe dhe atë: Rite me zjarrin, Rite me gjelbërimin, Rite me ujin, Rite me nyjën e perit, Rite me vezë, etj.

DITA E VERËS OSE VERËZA: është festa e parë në stinën e Pranverës, e cila rëndom bie në 14 mars sipas kalendarit të ri, ose më 1 mars sipas kalendarit të vjetër. Festa zgjat dy ditë në të gjitha trevat lindore. Dita e parë quhet “Arife”, kurse dita e dytë (14 marsi) quhet Verëza ose Dita e Verës. Parapërgatitjet fillojnë më 12 mars, në mbrëmje zakonisht një grua e moshuar ose “ e regjur në kësi punësh”, “shtin qiqra”, dhe pasi të vij brumi, gratë do të shkojnë të marrin brumin dhe me këtë brumë do të gatujnë bukë, e cila quhet “qahija” ose “kulaçka” apo “kuleçë”. Qahija dhe kulaçët kanë formën e rrumbullakët me diametër prej 15–20 cent. . Qahija para se të piqet lyhet me vezë. Qahija dhe kulaçët kanë shijen e ëmbël, e cila vjen nga qiqra.

Po atë ditë (13 mars) gratë apo zonjat e shtëpisë ziejnë vezë dhe në ujin e zierjes shtinë lëvore të thata të qepës, me qëllim që vezët të marrin ngjyrën e kuqërremtë. Përveç vezëve zonjat e shtëpisë ziejnë edhe misër dhe gështenja.

Dita e “Arifese” (13 mars) fëmijët zgjohen pa lindur dielli, i marrin vezët e ziera dhe shkojnë për kukurek (taçe) dhe lule të tjera në

kojre ose pyjet e zabelet e afërme ose gështejat. Duke mbledhur kukurek, fëmijët i rrokullejnë vezët lëndinave. Me këtë rast ata do të thonë: “PËR SHËNDETIN E BABËS, PËR SHËNDETIN E NËNËS, SI DHE PËR GJITHË ANËTARËT E FAMILJES...” Sipas dëshnmive të mbledhura në shumë vise të trevave lindore shqiptare në të kaluarën jo të largët janë kënduar shumë këngë, ndërkaq në kohën e fundit ato dëgjohen shumë rrallë.

Përveç kukurekëve, fëmijët marrin edhe degë dushku e thane, më pas të gëzuar dhe plotë hare do të nisen së bashku për në shtëpi. Në qoftëse ndonjë lule u bije nga dora, fëmija nuk e merr më, sepse nuk bën të merret ajo lule e të çohet në shtëpi, sepse ka prekur tokën dhe është shenjë e keqe të vihet në shtëpi. Lulet e mbledhura i vendosin nëpër vrimat e mureve si dhe nëpër reset e dyerve të shtëpisë; Me lule më herët i stolisin edhe mutirin (ftirin). Po ashtu besohet se gjatë stinës së dimrit bleta bije në gjumin dimëror. Kështu ata që merren me kultivimin e bletëve, lulet dhe degët e thanës ose dushkut i lënë mbi kosharet e bletëve me qëllim që bletët të zgjohen nga gjumi sapo të nuhasin erën e ngrohtë të pranverës dhe luleve. Me këtë rast në disa treva lindore do të përsërisin tri vargjet:

“Si e ndërron dushku erën

Ti ta dëgjosh pranverën” (Selvie Nuredini, Zagraçan, 1985);

Në mbrëmje zonja e shtëpisë do të marrë prej kopshti një plis me barë, të cilin e vendos në pragun e derës së shtëpisë dhe mbi të do të ndez squfur ose bajgë të thatë. Besohet se tymi i squfurit do të zhduki “gojëmbyllurit”, (kështu i quajnë atë ditë gjarpërinjtë dhe bollat). Që prej kohërave më të hershme njeriu ka ditur të përdorë squfurin (në sasi të vogla) kuptohet si mjet helmues shfarosës. Ndërkaq tymi i bajgave të thara besohet se do ti shfarosë mushkonjat dhe insektet e ndryshme. Ditët e shënuara, si dita e Verës, Sulltan Nevruzi, Shën Gjergjit, Heremisë e Shën Mitrit, nuk lejohej që të qepet në të Trevat Lindore, sepse sipas besimit në të kundërtën do të dalin “gojëmbyllurit” (gjarpërinjtë e bollat), si dhe s’duhet të zihet sapun me dorë sepse do dalin kërmijtë.

Natën e verës do të kryhet edhe një rit tjetër: një anëtar i familjes do të marrë një degë trëndafili dhe e djeg. Pasi të ndizet dega e trëndafilit, dega lëshon një lëng ngjyrë gështenje. Me këtë lëng laget një pjesë e mashës; më pas merret një vezë, e cila lyhet dhe u vendohet nga një shenjë fëmijëve në ballë, ose një pikë, ose një vijë në formë vertikale prej te flokët deri në mes të dy vetullave.

Në të kaluarën shenjë u vihej edhe pleqve, por edhe gjithë anëtarëve të familjes, për t'u ruajtur nga më e keqja (Islam Baftjari, Jeta në gurë, Strugë, 1998, f.356).

Ky rit përcjellës i Ditës së Verës, nuk ka qenë vetëm festë e fëmijëve, por festë e ç'do moshe gati në të gjithë Trevat Lindore. Sipas bindjes që mbisundonte në mesin e popullatës, kjo shenjë u vendohet në ballë që të mos i nxijë e mos i zë dijelli në stinën e verës. Në qoftë se ndonjë pulë ka rënë "Klloçkë" (Qukë) ditën e Arifesë do tija vendosin vezët duke ia shqiptuar emrat e disa fëmijëve të zhdërvjelltë. Pasi t'i kenë vënë vezët ato do të thonë tri herë këto fjalë: "Kup u vumë, kup të dalin zogjtë. (po aty).

Në shumë treva lindore shqiptare ditën e "arifes" së Ditës së Verës, i dërgohen rroba nuses së fejuar (zënë), ashtu si edhe festat e tjera të motit dhe atyre fetare, para se të bëhet dasma.

Në mbrëmje, gati në të gjithë trevat lindore, nëna përgatitë "martinkën" ose veroren e mbaruar me pe të kuqe dhe të bardhë. Penjtë përdridhen dhe më pas në to vendosen monedha të vjetra të shpuara. Martinkën me monedha fëmijët i varin në qafë, kurse anëtarët e tjerë të familjes, martinkë vendosin në byzylyk të dorës, me qëllim që dora të mos pushoj së punuari, kurse te gishti i madh i këmbës së djathtë, që të mos pengohet dhe të rrëzohet gjatë verës. Fëmijët nga më të moshuarit porositen që martinkat ti heqin porsa ti shohin zogjtë shtektar (dallëndyshen, Lejlekun) dhe të njëjtat ti varin në degë trëndafili, pemë ose kaçuba.

Në Ditën e Verës, dikur gati në tërë trevat lindore gumëzhinin apo vlonin fshatrat e lagjet e qyteteve nga zërat e fëmijëve (tani më pak). Fëmijët zgjoheshin shumë herët diku rreth orës 5 të mëngjesit. Me vete merrnin shportat e në njërën dorë mbanin karthija (shkopi),

duke belbëzuar (ciu—ciu—ciu) shtëpi në shtëpi. Fëmijët bëjnë ciu—ciu deri në momentin që zonja e shtëpisë do ta hapë derën. Në qoftë se fëmija ka harruar të marrë në dorë shkopinjtë, e zonja e shtëpisë i thotë: "Ku i ke zogjtë". Fëmija pas saj kthehet në oborr merr ca karrthija dhe hynë brenda, por kësaj radhe "me zoga". Degët i lënë në oxhak (sot te porta), e më pas i djezin me qëllim që vezët të "qelin" të gjitha si "prushi".

Zonja e shtëpisë fëmijëve u jep dhurata: vezë, molla, bonbone, sheqerka, gështenja, misër të zier, kokrra etj. Fëmijët do të gëzohen më së shumti kur marrin dhuratë vezë. Në këtë ditë ato mbledhin mjaftë vezë. Shkuarja e fëmijëve shtëpi në shtëpi është shenjë e pjellshmërisë. Në ditën e Verës edhe të mëdhenjtë si edhe mysafirët gostiten me vezë të ziera.

Dita e Verës ka për qëllim të sigurojë, në plan të parë: mbrojtje, pjellori, shëndet, përparim, fat e dashuri si për individin ashtu edhe për bashkësinë njerëzore. Riti i Ditës së Verës në trevat lindore shqiptare tradicionalisht ruan parimet magjiko—religjioze të kontrollit të ndryshimeve shoqërore, shpirtërore e kohore. Përmes riteve të këtilla, në një farë mënyre, vendoset uniteti ndërmjet njeriut dhe natyrës.

Kompleksiteti i riteve të motmotit lidhet me Ditën e Verës, bart në vete në tërë trevat lindore pa përjashtim, rëndësi të madhe shoqërore dhe psikologjike. Para se gjithash duke u përmbajtur rregullave që i kërkojnë ritet e këtilla, arrihet bindja se në mënyrë aktive mund të ndikohet ndaj zhvillimit të ngjarjeve, kurse besimi i paluhatshëm në efektin e tyre e kthen rehatin dhe stabilitetin psikik, gjegjësisht vendoset një baraspeshë mentale tek personi i cili i nënshtrohet riteve të këtilla. Megjithatë në kohën e tashme një pjesë e madhe e riteve tradicionale janë harruar në trevat lindore, kurse një pjesë e tyre të mbetura po marrin karakter argëtimi për arsye se kanë humbur kuptimin.

FESTA E SULLTAN NEVRUZIT:— Në trevat lindore shqiptare festohet më 22 mars dhe disa rite dhe zakone janë të ngjajshme me ato të ditës së verës. Ja dy Vargje:

“SULLTAN NEVRUZ, SULLTAN NEVRUZ
BJERI DHERIT ME TOPUZ...”

Nga këto vargje kuptojmë se prej kësaj dite fillon mugullimi i barit. Ditën e Sulltan Nevruzit, fallen lulet, pemët, prandaj nuk duhet të priten ose të krasiten me gërshërë ose me sëpatë sepse është “gjynah”. Nëse këtë ditë lind fëmija djalë do të pagëzohet me emrin Nevruz, e po të lind vajzë Nevruze. Ashtu si në festat e tjera të motmotit edhe në këtë kremte në të gjithë trevat lindore shqiptare përgatisin darkë ose drekë të pasur me ushqim.

Një ditë para festës së Sulltan Nevruzit, zonjat e shtëpisë përgatisin kulaçe ose qahija. Atë natë mendohet se fallen pemët. Pemët lidhen me kashtë thekri, në mëngjesin e Sulltan Nevruzit që pemët të bëjnë më shumë fryte.

FESTA E SHËN GJERGJIT:— Edhe në trevat lindore shqiptare kremtohet më 6 maj. Edhe për këtë festë përgatitjet fillojnë një ditë përpara. Më 5 maj fëmijët do të shkojnë për lule (kukurekë e qu-mështorka) të cilat njihen me emrin “Lule gjarpri”. Me këto lule stoliset furi (mutiri), me qëllim që gjatë vitit të ketë më shumë qu-mësht. Po këtë ditë nis edhe riti i larjes së fëmijëve. Në mbremje (para se të perëndojë dielli) fëmijët shkojnë të marrin ujë me kova e shtamba te “mulliri i fshatit ose në lum”. Në enët e mbushura me ujë fusin lule e gjethe. Në këtë ditë vajzat do të presin një degë të pjergullës, e lëngun që do ta lëshojë hardhia gjatë natës e mbledhin në një enë të vogël. Riti i prerjes së flokëve dhe riti i larjes së fëmijëve do të vazhdojë ditën e Shën Gjergjit. Në mëngjes fëmijët lahen tek rrënja e trëndafilit me ulin që ka fjetur me lule dhe gjethe një natë më parë. Nëna duke larë fëmijën do të përsëris “uji teposht, Riani terma”.

Ditën e festës së Shën Gjergjit, pa lindur dielli vajzat shkojnë te rrënja e ndonjë plepi që tip presin flokët, pasi ti kenë lyer flokët me lëngun e hardhisë. Në të kaluarën flokët I prisnin me sopat, ndër-kaq tani me gërshërë. Flokët e prera i hedhin në lum me qëllim simbolik që rritja e flokëve të ecë si lumë, tu rriten shpesh dhe tu bëhen të gjata si hardhia. Pasi ti kenë prerë flokët, vajzat do të fil-

lojnë “kullotjen” e tyre. Vajzat shkojnë nëpër livadhe dhe rrokulli-sen, me çrast këndojnë edhe këngë. Kënga më e njohur në anët e Strugës gjatë “kullotjes së flokëve” është:

“MAJ, MAJ KOKO MAJ
RRITMI FLOKËT SA T’I MBAJ,
PËR NJË JAVË, SA NJË STAVË
PËR NJË MUAJ, SA NJË DUAJ
PËR NJË VJET, SA NJË PLEP
SA PRAGU I DERËS, SA BISHTI I PELES
SA QIMJA E KALIT, SA PURTEKA E MALIT
SA UDHË E PAZARIT...”

Pas rrokullisjes, vajzat marrin disa kashtë thekre dhe i lidhin për beli, që të rriten të gjata si thekra dhe të bëhen belhollë.

Ditën e Shën Gjergjit, vajzat vishen me tesha të reja ose të pastra dhe shëtisin nëpër grupe si dhe do të luajnë lojëra të ndryshme popullore.

Në disa fshatra të Strugës por edhe më gjerë, në festën e Shën Gjergjit, zonjat e shtëpisë me ujin e luleve e pastrojnë sitën e miellit me besimin se pas kësaj larjeje mizat dhe insektet nuk do të hyjnë në shtëpi tërë vitin.

Gjatë festës së Shën Gjergjit nuk i thurin flokët, nuk shpojnë me gjilpërë me qëllim që mos i lidhin bollat dhe mos i kafshojnë gjar-përinjtë.

Për Shën Gjergj viçat i ndajnë prej lopëve, por i lënë lëshuar sepse këtë ditë bëjnë magjia që t’ia ndjellin qumështin lopëve.

Ditën e Shën Gjergjit në mëngjes herët nëna shkon në dhomën e fëmijëve dhe u shtinë në gojë nga një thelbi hudhre, me besim që mos i mund gomari po t’i gjejë pa ngrënë diçka.

Prej degëve të shelgut e të arrës fëmijët mbarojnë pizga e bilbila. Ditën e “arifesë”, në mbrëmje fëmijët marrin nga një degë plepi dhe do ta prekin njëri-tjetrin me to, si dhe kalimtarët e rastit, e në fund do t’i ngrënë degët lartë duke thënë: “U RRIÇ SA PLEPI”!

Në shumë vise të trevave lindore shqiptare dikur thereshin edhe qengja, dhe ziheshin kokrra misri me hi, që shprehte simbolikisht,

shtimi i jetës si misri. Gratë për këtë festë nuk punojnë tri ditë punë dore me grep e gjilpërë.

Natën e Shën Gjergjit, gratë i kthenin koritat e drurit ku lanin tes-hat, me simbolikën që të kthejnë me të lindjen e fëmijëve meshkuj.

FESTA E EREMISË:— Në trevat lindore kremtohet në 14 maj. Në këtë festë kulmi i gëzimit e haresë arrin kur familje të tëra tubohen brigjeve të liqeve e lumenjve. Si ditën e “Arifesë” (13 maji), ashtu edhe në Festën e Eremisë, do të kryhen disa rite. Më 13 maj fëmijët i shkojnë rreth e rrotull shtëpisë duke bërë zhurmë me legenë dhe teneqe të vjetra ose me këmborë, për ti trembur gjallesat e dëms-hme si gjarpërinjtë dhe bollat. Duke shkuar rrotull shtëpisë ato këndojnë:

“EREMI, DEREMI,

GJITHË TË MIRAT NË SHTËPI,

TË KËQIJAT NË MULLI

PLASI BOLLA ME GJARPËRI....” (I B....fq.360).

Me këto veprime do të përfundojë dita e parë. Ditën e Eremisë në mëngjes herët, gratë që nuk lindin shkojnë në disa burime ose liqe-ne që të lahen. Besohet se po të lahen atje, gratë në Ereminë e vitit që do të vjen do të kenë fëmijë. Atë ditë te burimi ose liqeni rri një grua e me përvojë në këtë punë, e cila duke i larë nusët me nevojë lindjeje, shqipton disa fjalë e formulë magjike. Nevojtalet, për të zënë magjia do t’i dhurojnë gruas nga një dhuratë (këmishë, fustane...) sipas mundësisë. Te një vend i caktuar do të lënë nga një pe, të cilën e heqin nga teshat e veta që i kanë veshur, ndërkaq në ujë do të hedhin monedha me qëllim që aty të mbesin të ligat e tyre. Të gjithë njerëzit e pranishëm do ta lajnë fytyrën. Besohet se po ta lajnë fytyrën nuk do t’i dhemb kokë gjatë tërë vitit.

Ditën e Eremisë gratë (nusët) që nuk kanë fëmijë, në trevën e Strugës shkojnë në fshatin Ladorishtë, te Guri i Grave, i cili ka një vrimë në mes, në formë unaze. Aty nevojtalet (gratë që nuk lindin) hynë e dalin aty tri herë duke thënë: “YFSHA BOSH— DALSHA PLOT”! Besohet se po të kalojnë nëpër unazën e gurit vitin tjetër do të kenë fëmijë.

Ditën e Eremisë zonjat e shtëpisë përgatisin drekë të pasur, ndërkaq tërë dita kalon duke shëtitur dhe duke luajtur lojëra të ndryshme popullore.

FESTA E SHËN MITRIT (SHMITRIT) – Në tërë trevat lindore shqiptare është festa me karakter blegtoral, që zakonisht festohet më 8 nëntor. Në këtë kremte zihen kunguj, që të shtohen njerëzit, kafshët, bagëtitë dhe të mirat material, sikurse farat e kungullit. Për këtë kremte fetare e pagane gratë shkojnë për të gjetur shërim në vende kulti në natyrë: në gurë, në burime, në dru e në vende të tjera të shenjta, ndërsa gratë për të lindur fëmijë mashkull shkojnë e kthejnë nga një plitë me arë ose përmbysin ndonjë koritë etj.

Festa e Shënmitrit është e fundit e motmotit, gjashtë muaj pas Shëngjergjit. Kjo festë është e lidhur me kthimin e kurbetçinjve, të cilët dikur niseshin në kurbet ditën e Shëngjergjit dhe ktheheshin ditën e Shënmitrit.

Edhe për ditën e Shënmitrit zonjat e shtëpisë përgatisin drekë ose darkë më të pasur se zakonisht, si lakra me sarmë, e cila e ka simbolikën “SI LAKRA TË MBLIDHEN NJERËZIT E SHTËPISË”. Për këtë kremte në të gjitha trevat lindore nuk ka këngë, edhe ritet janë më të zbehta.

Në përgjithësi, në kohën e tanishme një pjesë e madhe e riteve tradicionale në festat e motmotit në trevat lindore shqiptare janë harruar për fat të keq, kurse pjesët e tyre të mbetura po marrin karakter argëtimi për të vetmen arsye se kanë humbur kuptimin e përdorimit të tyre. Për këtë arsye regjistrimi i riteve, por edhe i materialit tjetër etnologjik dhe folklorik, paraqet një vlerë të posaçme për të shpëtuar nga pluhuri i harresës këtë thesar e gurrë të çmuar popullor, i cili dita-ditës, nën ndikimin e kushteve të reja të modernizimit, po zhduket nga faqja e dheut, e së bashku me të, në mënyrë të pahetuar, zhduket edhe një pjesë e veçantisë së qenies tonë kombëtare në trevat shqiptare.

HAMIT XHAFERI

Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë, Maqedoni

FESTA E SHËNGJERGJIT NË TREVËN E KËRÇOVËS

Festa e Shëngjergjit në këtë trevë, dikur ka pasur karakter gjithëpopullor. Është festuar me shumë gëzim, hare dhe mbresa të fuqishme shpirtërore, veçanërisht me përfundimin e stinës së ftohtë të vitit dhe mbërritjen e asaj të beharit. Nis me 5 maj, varësisht nga fshatrat që i takojnë zonës së Zajazit dhe fshatrave të zonës së Osllomesë apo siç i thonë vendasit "Rretheve", duke vazhduar disa ditë. Kjo festë është shquar me një sërë lojërash dhe me fluksin e madh të shqiptarëve nëpër sheshet e gjëra, pranë tyrbeve ose ndonjë vendbanimi të lashtë. Gjurmët e kësaj feste popullore na shpiejnë larg gjer në lashtësinë ilire, atëbotë kur këta kanë besuar në shumë perëndi. Megjithatë, ca mjedise mundohen ta mitizojnë këtë çast të gëzuar gjithpopullor. Mirëpo kjo duket të jetë shfaqur ndokund pas arritjes së krishterimit në trevat e Ballkanit e më gjerë. Te gjithë popujt e Ballkanit (veçanërisht atyre të përkatësisë fetare ortodokse), ndërsa në rastin tonë e kanë festuar shqiptarët ortodoks, katolik dhe mysliman. Andaj duhet thënë se kjo festë popullore pothuajse nuk është e lidhur në mënyrë të veçantë vetëm me popullin tonë. Duke u mbështetur në kalendarët kanonik ortodoks, dita e Shën Gjergjit ka qenë 23 prilli. Përderisa është shfaqur në kuadër të epokës së këtillë kohore, kurse pagëzimi "Gjergj" iu dha kryetrimt tonë kombëtar – Gjergj Kastriotit Skënderbeut, i cili u lind më 6 maj 1405. Andaj për këtë arsye festimi i Shën Gjergjit nga popullata gjithshqiptare, ashtu edhe në këtë trevë, festohet me 5 deri 6 maj. Ky kremtim gjithpopullor shquhet më tepër për nga tiparet kombëtare, kulturore, sesa religjioze, sepse popullata shqiptare e kësaj treve, ashtu si në trevat tjera shqiptare, siç duket çastin e këtillë e ndërlihd me Gjergjin e Madh të Kastriotëve, në bazë të legjendave

mbi "mbretin e madh" të shqiptarëve. Duhet thënë se një fshat shqiptar i Kërçovës i quajtur Sërbicë që i takon anës së "rretheve" më herët është quajtur Kastriot. Siç dihet pas Luftës së Dytë Botërore komunistët maqedonas ia rikëthejnë me dhunë emrin këtij fshati në "Sërbicë", ndërsa përmendoren e Skënderbeut e rrënojnë. Duhet thënë se me arritjen e krishterimit sikurse vërehet nuk e çrrënjosi prej themeli pasurinë e këtillë shpirtërore të popullatës shqiptare, sidomos duke i përballuar (mbase gjithashtu prej transmutacionit të besimeve, përshtatja e botëkuptimeve të moçme ndër maskën e besimit të ri) e pagëzuan Shën Gjergj. Gjatë sundimit Osman në viset arbërore nisën të ngritën tyrbe që krijoheshin enkas për fëmijët nga klerikët islamë, siç ishin të parët e teqesë dervishët e përkushtuar. Shqiptarët duke mbetur besëtar të zakonit ia adaptuan tashmë, gjithashtu besimit islam këtë kremtim që zhvillohet sipas zakonit. Kremtini në disa fshatra të trevës së Kërçovës, në kohërat e hershme duket se ka qenë e përgatitur enkas afër tyrbeve hyjnore, në çast të caktuar në të cilin është prerë një shpjerrë, për të iu lutur Perëndisë për mbarësi në këmbim të sakrifikimit. Mirëpo fakti se kjo festë qenka e "romëve" nuk qëndron sepse këta kanë qenë pakicë e pa rëndësishme në këtë trevë ashtu si në të gjitha trevat shqiptare, të cilët janë ngulitur si gjithkund edhe në këtë trevë si atdhacak gjatë mesjetës së zhvilluar, përkatësisht gjatë shek. XIII–XV, me të cilin shkak i janë përshtatur vendit sidomos vendasve shqiptarë. Në qytetin e dikurshëm të Uskanës bie fjala thuhet se Shëngjergji është festuar më 5 maj kryesisht pranë ndonjë tyrbeje. Këtë më së miri e dëshmojnë disa nga lokalitetet në të cilat ndeshim varreza të vjetra, ku njerëzit dikur janë ulur pranë këtyre vendeve duke mos pasur asnjëherë shqetësim, për arsye se kanë mbetur vetëm rrasa të vjetra. Thuhet se këtej kanë hyrë vendasit autokton të kasabasë e veçanërisht të rrethit duke kërkuar shpëtim dhe për të lënë ndonjë metelik paraje ose për të pirë ujin e tyrbes. Është e njohur se një festë e këtillë ishte mbajtur në disa lokalitete të Kërçovës rreth viteve (1980–1985 gjer në vitet e vona. Kjo do të thotë se në Kërçovë më vonë shumë fëmijë nga kjo trevë disa prej këtyre

lokaliteteve i kanë konsideruar si çaste festive të të ashtuquajturve "xhypeve" ose "sheve".

Ja si përshkruhet një çast i Shën Gjergjit: në çastin hënor të Shën Gjergjit fëmijët qofshin vajza apo djem është dashur të zgjohen që herët në mëngjes, të laheshin, duke varur në qafë një pe të larmë apo një nuskë, të cilat i kanë përgatitur si zakonisht gratë ose vajzat e rritura, me një pe të kuq apo siç i thonë vendasit qumështor, pastaj shkohej rreth lumit për të marrë rremb të gjelbëruar shelgu, gjithashtu shkohej tek mulliri ose tek lugu i mullirit duke i larë rrembat e shलगut, pastaj kanë larë fytyrën dhe i kanë sjellë rrembat në shtëpi. Me këtë rast kanë patur kujdes që të mos prekej toka, pastaj rrembat i kanë varur nëpër portat e shtëpive. Aso kohe edhe sot e gjithë ditën kanë mbetur të pa shlyera në kujtesën time portat e çdo shtëpie të cilat ishin të stolisura me rremba shलगu. Pastaj zhvillohej njëkohësisht një ritual tjetër ku fëmijët shkonin në kodrinë e fshatit Zajaz të quajtur "Lama e Haxhës" ku përbri kësaj groponin rreth ndonjë trungu gjersa të zbulonin ndonjë rrënjë, hiqnin truallin duke krijuar në formë të një kanali për t'u përbijur nën rrënjët e trungut të vjetër. Festimi i Shën Gjergjit bëhet me një sërë ritesh: duke filluar nga gjelbërimet, ndezjen e zjarreve të cilët kishin kuptimin e ritualeve, që manifestohen me mbledhje lulesh dhe thurje kurorash nga fëmijët. Me këtë rast lagen fillimisht njerëzit e shtëpisë me "ujë pa fol", shilarthi (i ashtuquajturi salanxhaku) i fëmijëve në pemë (ose në portën e oborrit), që bëhej me rite të ndryshme nëpër livadhe dhe ndër blegtori. E gjithë kjo ka pasur vetëm një qëllim – mbarësinë. Parashtrohet pyetja pse vallë festohet kremtja e Shëngjergjit po ashtu ndër shqiptarët e përkatësisë fetare myslimane? Edhe pse Shën Gjergji kryesisht në popullatë është konsideruar si festa e të krishterëve, por vërehet edhe sot aty-këtu të festohet edhe nga shqiptarët e konfesionit fetar mysliman edhe sot e gjithë ditën, ndonëse kjo festë cenon fenë dhe predikimin islam që mund të konsiderohet si çasti kur përkujtohet fillimi i mëkatit më të madh apo idhujtarisë. E kemi të qartë se tek ne një pjesë e njerëzve më të moshuar nga padituria duke mos e ditur dhe

njohur realitetin e kësaj feste pagane, kanë qenë për tu qajtë hallin kur i vështron akoma të tillët të cilët ndonëse e kanë të njohur se nuk ka qenë festë muslimane e festojnë thjesht pse si e këtillë ka mbetur nga të parët tanë. Celebrimi si i tillë nuk ka lidhje fare me fenë islame, madje si kremtim shënon ngjarje a ndodhi, të cilat lidhen vetëm me personalitete. Për këtë arsye e kemi parë të udhës se në shenjë përkujtimi duhet t'ua sqarojmë vëllezërve apo motrave të fesë islame realitetin e kësaj kremteje. Kremtimi i "Shën Gjergjit" ose veprimet të cilat zhvillohen kanë karakter dhe përmbajtje id-hujtarie. Shën Gjergji është vështruar si një kalorës, i cili u vra si martir në vitin 303 të erës sonë (pas lindjes së Isaut) në mbrojtje të përhapjes së besimit të krishterë. Tek ne njeriu megjithëse duhet të jetë i përkushtuar, përgjërues, mirëbërës, i përpiktë, Shën Gjergji meriton respekt, lëvdatë, nder, por një gjë e tillë kurrsesi nuk mund të jetë shenjtërim. Në popull mbretëron paragjykimi se pasi i pritët koka ndërsa trupi i dërmohet, Shën Gjergji, sërish, ringjallet duke u ngritur tri herë në këmbë ...! Thënë shkurt, në paragjykimet e njerëzve të thjeshtë ekzistojnë shumë mite, legjenda apo përralla të tjera që kanë të bëjnë me Shën Gjergjin. Por kjo është e "drejta" e secilit për të krijuar të vërtetën e tij për të nxjerrë përfundimet vetanake...! Në popull mbretëron mendimi se me krejt këto mite, përralla, Shën Gjergji nderohet si një nga shenjtët më të mëdhenj tek të krishterët, të cilët e nderojnë gjer në përgjërëm, për të kërkuar nga ky mbrojtje dhe shpëtim: Këtë e predikon njëkohësisht edhe kisha katolike dhe ajo ortodokse dhe shumë komunitete tjera...!

Festa e Shën Gjergjit, zanafilla dhe kremtimet

Nata e Shën Gjergjit kremtohet për të përjetuar përfundimin e dimrit dhe arritjen e stinës së verës. Në varësi të trevave tona kjo kremte e ka zanafillën me 5 maj duke vijuar gjer më 15 maj. Kremtimi shquhet me lojëra të shumta, me fluks të madh të njerëzve pranë tyrbeve ose ndonjë vendbanimi të lashtë, siç është "Çuka e Kërçovës". Gjurmët e kremtimeve të kësaj feste të shënuar

të shpijnë larg në vjetërsinë e lashtë ilire, atëbotë kur njerëzit pan-dehnin në shumë perëndi. Gjithashtu, pothuajse mbarë popujt e Ballkanit e kremtojnë këtë ceremoni. Ky celebrim që i ka gjurmët nga lashtësia ilire, është kremtuar gjithashtu edhe nga popujt e Evropës Perëndimore, por në mënyrë më moderne. Meqënëse ka lindur përbrenda kësaj periudhe, pagëzimi Gjergj iu vendos heroit tonë kombëtar. Për këtë shkak, festa e Shën Gjergjit nga popullata myslimane, madje po ashtu nga ortodoksët dhe katolikët shqiptarë festohet tjetërsoj prej kalendarit zyrtar ortodoks. Kjo ceremoni vërehet se ka më shumë karakter kombëtar gjithashtu kulturor sesa religjioz, pasi populli ynë e ndërlihdh çastin e këtillë përmes Gjergjit të Madh të Kastriotëve, “mbretin e madh” sipas legjendave. Arritja e krishterimit siç vërehet nuk e shkuli prej rrënjës këtë traditë ndoshta për këtë e pagëzuan Shën Gjergj. Me arritjen e Perandorisë Osmane në trevat tona nisën të ndërtohen tyrbe, përkatësisht mauzole të ndryshëm, që ndërtoheshin për evliatë, klerikë myslimanë (hoxhallarë), i pari i sektit mysliman (shehlerë) ose dervishët e për-kushtuar. Shqiptarët për t’i mbetur besëtar trashëgimisë ia përshtatën gjithashtu besimit islam këtë kremtim zakonor. Ceremonitë e kremtimit në trevën e Kërçovës organizohen jo vetëm pranë tyrbeve të shenjta, në prani të tyre prehet ose therret qengji, për të kërkuar prej Zotit mirësi në këmbim të sakrifikimit. Ja si përshkruhet një ditë e Shën Gjergjit në këtë trevë: Shën Gjergji ka qenë kremtim me shume rite: gjelbërime, me ndezje të zjarreve rituale në vende publike, mbledhje lulesh dhe thurje kurorash nga fëmijët, lagia e njerëzve të shtëpisë me “ujë pa fol”, shilarthi (salanxhaku) i fëmijëve në pemë (përkatësisht në dyer të oborrit), rite nëpër fusha, në lumenj, në male, kodra dhe ndër bagëti për mbarësi etj. Sipas traditës në ditën e Shën Gjergjit duhet të zgjohesh herët në mëngjes, të laheshe dhe pastaj varej kungulli i egër në qafë, që zakonisht përgatitej prej nënave (bëhej prej një lloj bime që duket si patate, grihet në copa të vogla dhe bëhet qafore me pe të kuq dhe të bardhë, që në trevën e Kërçovës e quajnë Tos). Më pas shkohej rreth lumit për të marrë degë të gjelbërta shelgu, shkohet tek mul-

liri ku tek lugu i mullirit laheshin degët e shelgut dhe fytyra. Degët e shelgut çoheshin në shtëpi, duke pasur kujdes që të mos prekej toka dhe më pas këto degë vareshin në portën e shtëpisë. Shëngjergji në fshatin Baçisht të Kërçovës kremtohet në një mënyrë tepër të vecantë. Ritet që aplikohen nga kremtuesit janë njaftë interesante, në pamjen e parë nga ritet kremtimi i Shëngjergjit në këtë fshat duket si kremte e luleve dhe nisma e verës, nga masivizimi si një kremte e shoqëruar me rite që ka kuptimin e një muze të gjallë që vjen prej lashtësive të paraardhësve tanë. Kjo festë pa dyshim gjithmonë na është dukur shumë e bukur por edhe shumë misterioze me enigma rreth saj. Pyetja e parë që ia shtrojmë vetes është, a thua vallë kremtimi i Shëngjergjit në këtë trevë është një kremte katolike? Nëse po: Si ka qenë e mundur që një katund i cili shquhet si vendbanim i besimit mysliman në zonë kremton me aq energji një kremte katolike? Gjithashtu shtrohet vetvetiu pyetja kureshtare, a thua vallë ritet e kësaj kremteje janë katolike? Këto dhe njaft çështje të tjera na kanë bërë që të zgjerojmë dituritë tona brenda kësaj lëmie duke kremtuar këtë kremte kaq të bukur dhe në mënyrë të ndërgjegjshme me bashkëvendësit tanë. Në vijim të këtij shkrimi do të orvatem që t'u jap përgjigje disa pyetjeve të mia të më sipërme por njëherit edhe disa të tjerave që do shtroj në vijim të këtij studimi.

1. Ç'është Shëngjergji dhe a ka ekzistuar vallë kjo figurë mitike?

Kur u drejtohem disa hulumtuesve të tërësisë së mësimave skolas-tike që i përkasin fesë dhe besëtytnive të shumëllojshme, veçanërisht ca regjistrimeve të enciklopedisë katolike, këshillimeve me priftërinjtë shqiptar të fesë katolike dhe ortodokse, siç është At Marku kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Shqiptare nga Elbasani, ndaj të cilit shpreh mirënjohjen time nga zemra për ndihmesën gjatë bashkëbisedimit me te, ndër të tjera vërejmë se ka fakte se Shën Gjergji ka qenë i pranishëm dhe lidhur me këtë ekzistojnë disa

fakte si në vijim: Enciklopedia Katolike përkrah pikëpamjen se nuk ka kurrfarë hamendjeje, në realitetin historik të Shën Gjergjit, mirëpo prapëseprapë kemi të dhëna modeste mbi ekzistencën dhe veprimtarinë e tij. Sidoqoftë, sa i përket Shën Gjergjit ajo e cila dihet duket se u lind në Nikomedia (Nicomedia), rajon në Turqinë e sotme. Ka jetuar brenda shekullit III (e. r.) ndërmjet viteve 275?–303. Prindërit e tij kanë qenë të krishterë, babai nga Kapadokia (Cappadocia) ndërsa nëna prej Palestine. Edhe vet Gjergji më vonë, pasi u bë një ushtar Romak, ka jetuar në Palestinë. Ai ka protestuar kundër persekutimit të krishterëve nga ana e Romës pagane. U burgos dhe u torturua por qëndroi besnik ndaj besimit të tij të krishterë. Me 23 Prill 303 atij iu pre koka në qytetin Lyda të Palestinës, ku edhe u varros dhe ende besohet se ky është varri i tij . (Gustave Moreau, BBC – Religion & Ethics – Saint George Introduction).

2. Si njerëzit besuan në shenjtërinë e tij dhe e kthyen atë në një festë fetare

Si rezultat i besimit të tij, Gjergji pësaj shumë tortura deri në sakrifikimin e jetës së tij në mbrojtje të besimit krishterë dhe në luftë kundër Perandorit gjakësor romak Dioklecian, për këtë shkak gjatë shek. III dhe IV ai arriti të konsiderohet si "i shenjtë" respektivisht martir i Krishterimit. Pas zyrtarizimit të Krishterimit Sh. Gjergji u bë simbol dhe mbrojtës i ushtrisë bizantine në shumë vende evropiane, për arsye se ai ishte ushtari i parë profesionalist i krishterë në Perandorinë Romake që u sakrifikua për besimin. Gjatë luftës se kryqëzatave Shën Gjergji u shoqërua edhe me simbolin e dragoit, prandaj fitorja ndaj përbindëshit (dragoit) bëri që Shën Gjergji të njëjhej si fitimtar. Ky simbol që simbolizonte fitoren, më vonë do të simbolizonte fitoren e së mirës ('shenjtit') kundër të keqes. Në vitin 1222, Këshilli Kombëtar në Oksford shpalli 23 Prillin, Dita e Shën Gjergjit, si ditë feste anekënd Anglisë. Shën Gjergji festohet nga shumica e trevave me popullatë shqiptare. Shqiptarët pa marrë pa-

rasysh përkatësinë e tyre fetare manifestimin e njohin si (Dita e Shën Gjergjit). Sipas, poetit, publicistit dhe studiuesit profesor Eroll Velija në një shkrim të tij lidhur me këtë festë ka përshkruar disa prej riteve të cilët aplikohen në vende të ndryshme lidhur me Festën e Shën Gjergjit që në një artikull të tij referuar (Dita e Shën Gjergjit). (Robert Elsie, Historical Dictionary of Kosova). Shpjegon: Ka shumë ngjarje të cilat zhvillohen në kuadër të ditës së Shën Gjergjit por ato manifestime zakonisht shoqërohen me personazhin e Shën Gjergjit dhe Dragoit! Në Kishë shqiptarët ortodoks dhe ata katolik ndezin qirinj. Derisa ortodokset në përgjithësi ofrojnë bukë të veçantë lidhur me këtë festë. Kurse gratë në përgjithësi zakonisht përbirohen nëpër 'Perin e Shën Gjergjit' për shëndet, mundësi të shtatzënisë si dhe fat në jetë. Të gjitha këto të dhëna i sqarova në mënyrë përmbledhur për lexuesin shqiptar, veçanërisht për festën e Shëngjergjit në fshatin Zajaz, duke sqaruar edhe disa rite të mënyra të festës që janë bërë dikur në këtë fshat. (Bulgarian National Radio: Religion and History, Saint George's Day, <http://www.bnr.bg>).

Cilat janë ritet që bëhen në fshatin Zajaz

Do të orvatemi që të gjitha ritet t'i përshkruaj në imtësi ashtu si i perceptojnë bashkëvendësit e mi këto rite, nëse ndonjë ritë nuk e kam përshkruar unë jam i hapur para bashkëfshatarëve të mi, të pres mendimet e tyre, unë do të përpiqem të argumentoj se me kë përkojnë ato, a janë rite të feve monoteiste apo pagane. Që me datën 4 e deri më 5 maj para dite, plakat dhe fëmijët shkonin në pyjet për rreth dhe mbledhnin barëra, rrënjë të ndryshme dhe hithra. Kur isha fëmijë mbaj mend se plakat na porosisnin të mbledhnim lule busulegu se mos, ndoshta duke mbledhur lule gjenim ndonjë lëkurë gjarpri ose kocka të ndonjë koke gjarpri!?. Nëse gjenim duhej t'ua jepnim atyre së bashku me lulet. Lëkura dhe kafa e gjarpërit mund të ishin gjetur qysh më herët që është e vlefshme për ritin. Po kështu banorët kujdesen të siguronin edhe kungull të egër i cili nga disa mbillet posaçërisht. Kjo bimë ishte kacavjerrëse me rrënjë mishore shumë të mëdha, vlerësohesh si bimë helmuese edhe pse

përdoresh si bimë mjekësore, në disa vendbanime të zonës, kësaj bime i thonë “stërkungulli” ose në gjuhë shkencore (*bryonia dioica*). Kjo bimë në shtëpitë e kësaj treve nuk mungonte, sidomos në fshatin Baçisht rrënjët e këtilla janë kultivuar. Plakat i shkulin rrënjët e kungullit dhe u jepnin shoqeve të tyre. Në këtë ditë të gjithë duhet ta siguronin hudhrat dhe penin e kuq e të bardhë dhe nga një kokërr vezë për çdo pjesëtar të familjes. Nëse nuk gjenin kungull të egër, e blenin sepse para festës vinin të shisnin rrënjë të tilla nga fshatrat fqinjë. Tani shtrohet pyetja vallë si përdoreshin dhe kur përdoreshin këto: Barërat me rrënjët përdoreshin në darkën e datës 5 maj duke i shtypura me kripë, për blegtorin duke u dhënë nga pak për adet siç e quanin plakat dhe këtë veprim e konsideronin si rit për të shtuar prodhimtarinë blegtoria. Por ky rit s'ka asnjë lidhje me katolicizmin por me paganizmin Ilir dhe ca më tej Pellazg. Lulet e busulegut të cilat ishin të verdha dhe me aromë të mirë, në disa vende kjo lule quhet “Aguliçe” ose emri shkencor i saj (*primula officinalis*) njihet si bimë mjekësore, të cilat i përdornin në mëngjesin e datës 6 së bashku me vezët e ziera, duke i larë me ta fëmijët. Pas larjes vezët ua jepnin për t'i ngrënë fëmijët dhe të gjithë pjesëtarët tjerë të familjes, duke e shoqëruar me një gotë qumështi me hudhër, ndërsa lulet tjera ua venin fëmijëve nëpër xhepa të xhamadanëve, tek fijet e opingave prej lëkure lopësh tek këmbët, të cilat tek meshkujt ishin të bardha, ndërsa te femrat ishin me ngjyrë trëndafili ose të përziera me blu që i zbukuronin ato. Ky ritë bëhej me besimin e vazhdimësisë së jetës në mënyrë të shëndetshme dhe të bukur si lulet. Riti i mrekullueshëm i vjetër sa vetë ilirët, ndoshta edhe më tej, në disa rrethe veriore kryesisht në Shkodër 6 maji njihet si festa e luleve që ka mundësi, para krishterimit të jetë njohur edhe nga paraardhësit tanë, por edhe të zonës tonë që pak a shumë i kanë këto rite. Ndërsa pak rrënjë të kungullit të egër dhe një thelb hudhër e lidhur me pe të kuq e të bardhë që nënkuptonte shëndet bardh e kuq, përgatiteshin si stoli dhe u viheshin të gjithë fëmijëve, duke ua lidhur nëpër vende të dukshme, të rinjve dhe të rejave nëpër thekët e brezit, ndërsa të rriturve u futej në xhep. E

gjitha kjo do tu shërbente sipas ritit për syrin e keq dhe mbrojtjen nga e keqja. Ky rit i lashtë më shumë se Ilir i ruajtur me fanatizëm ndër breza ka qenë pagan dhe nuk ka asnjë lidhje me krishterimin dhe besimet e tjera monoteiste. Ndërsa hithrat gatuheshin në formë lakrori me misër (petë) dhe hahej në drekën e 6 majit pas kthimit të të rinjve, nga riti tjetër i mrekullueshëm i vendosjes së “potkave”. Ky gatim nënkuptonte që njerëzit të merrnin gjak dhe të ishin të shëndetshëm. Ka qenë shumë interesante që hithra shkencërisht njihet si një bimë shumë e pasur me hekur dhe përbërës të tjerë shumë të nevojshëm për shtimin e gjakut dhe të rruazave të kuqe të tij).

Me shume interes na duket gjithashtu riti i përdorimit të lëkurës së gjarprit dhe kockave të kokës së tij, duke u vënë lëkura në copa të vogla, ndërsa kockat e kokës së gjarprit u vilheshin fëmijëve në djep në kokën e lirekut që ishte diçka e rrumbullakët e bëre me copë ose me grep, e zbukuruar me rruaza e monedha të vjetra që shërbente për të ndërthurur uçkurin ose tojën (fije e trashë prej leshi) që shërbente për të lidhur foshnjën e vogël me mbulesën e quajtur “shpërnga” dhe kur ato ishin më shumë se një quheshin “shpërgaj”, që kanë qenë copa prej leshi të bëra në vekë në formën e një batanije të vogël me shirita bardh e zi ose të bardh, posaçërisht vetëm për fëmijë të vegjël. Ky rit konsiderohej si mbrojtje nga syri i keq, nga e keqja dhe ajo më e rëndësishmja si shenjë e vazhdimit të rilindjes dhe e vazhdimit të jetës në mënyrë të shëndetshme (të bëhesh i fortë). Këto shpjegime m'i ka bërë halla Fetije dhe disa plaka të tjera. Më ka habitur fakti, i mënyrës së shpjegimit të studiuesit tonë të madh me prejardhje arvanitase në Greqi, shumë i nderuari Aristidh Kola, i dekoruar me të drejtë me dy medalje, të larta nga dy kryetarët shqiptar Berisha dhe Mejdani për studimet e tij mbi pellazgët. Këtë ritë e provon se ka qenë një ritë përtej ilirëve deri tek paraardhësit e tyre pellazgët të cilët popullonin pothuajse pjesën më të madhe të gadishullit ballkanik. Pak a shumë në këtë mënyrë e shpjegon edhe studiuesi arbëresh Aleksandër Stipçeviq, për prejardhjen e ilirëve, dhe studiuesi i nderuar Moikom Zeqo,

nisur nga një monedhë e gjetur në fshatin Çinamak të Kukësit që datohet në shekullin e tretë para erës së re, i përkiste fisit ilir të labeatëve. Në këtë monedhë ndër të tjera kishte qenë e stampuar një anije që bashi i saj kishte kokën e një gjarpri, ky fakt e bën më besueshëm faktin se ilirët kultin e gjarprit e respektonin pasi besonin në legjendën se Ilirikumi ka lindur i mbështjellë me një gjarpër i cili i ka dhënë forcë fizike dhe trup të bëshëm. Një rit tjetër shumë i bukur është ai që zbatohet me datën 5 maj pasdite, ai marrjes së potkave (degë të gjelbëruara të mështeknës (berioskes) ose emri shkencor (betula folium et gammae) dhe vendosja e tyre. Në pasditen e datës 5 maj e gjithë rinia e fshatit, vajza e djem, nuset e reja dhe dhëndurët e rij me veshjet më të mira karakteristike popullore, të grupuar sipas fiseve, shkojnë duke kënduar në zabelet për rreth fshatit, për të marrë potka që kjo fjalë duhet ta ketë origjinën nga fqinjët që put do të thotë vendos. Të gjitha këngët janë rreth një hyjneshe që quhet “Zogele”. Ky është një spektakël i vërtet që të duket një festë rinore e pashembullte, kësaj hyjneshe nuk i këndohet nga fshatrat e tjera të zonës, në raste të veçanta edhe bëjnë humor me hyjneshën tonë. Këngët që këndohen kësaj hyjneshe janë vetëm për këtë, dhe pak a shumë janë në formën e lutjes për të ardhur, pasi konsiderohet se sjellë mbarsi, që pas çdo rreshti përdoret refreni “hajde mori Zogele hajde, hajde mori lule lala hajde”, ndërsa fjalët e tjera të këngëve janë lutje për të shtuar dashurin, për të martuar beqarët e beqaret, për t’u sjell stoli femrave, për të shtuar bereqetet për të ardhur shëndosh kurbetçarët që vinin nga shtegtimi me blegtorinë e tjerë. Në zhurmën e këtyre këngëve polifonike të krijohet mendimi se je ne mes të dashurive që të sjell hyjnesha e jonë Zogele.

Po kështu në mes lutjeve pozitive ka edhe lutje për të u mbrojtur nga e keqja, që më shumë spikat në këngën në formë lutje e sarkazme për kurbetlit, ku një fragmente thotë “i keqi le të rrije, i miri le vije, ik ore i keq, për ty s’ka shëngjergi”, “hajde mori zogele hajde, hajde mori lule lala hajde”. Këto degë prej mështekne që mblidhen mbahen lartë, që të mos prekin në tokë dhe po me kë-

gët e mësipërme grupi i madh rinor kthehet nga zabelet në shtëpitë e tyre duke i vendosur potkat në ballkone, i varin lartë që të mos prekin tokën, që i ruajnë si diçka të shenjtë që ua ka dhuruar Zogelja me këtë veprim mbaron aktiviteti ritual i kësaj dite. Të nesërmen, me datë 6 maj rinia e cilësuar më sipër sipas të njëjtit organizim ngrihet herët dhe duke kënduar bëjnë shpërndarjen dhe vendosjen e potkave (degëve të mëshateknës) po me ritualin që janë mbledhur pra duke kënduar vendosin ato në muret e shtëpive të tyre, në stallat e bagëtive, përcjellin bagëtinë që lëshohen për kullot duke i prekur në fillim me këto degë, në arat e livadhe e tyre duke shkuar të grupuar të rejat e të rinjtë e çdo fisi, me këngët rituale të hyjneshtës Zogele. Rituali përfundon rreth orës 9 të datës 6 maj për të vazhduar me rituale të tjera të mrekullueshme që do ti trajtoj më poshtë, te këto rite nuk kanë të bëjnë me besimin monoteistë as të krishterë e as myslimanë, por paganë, sepse këto rite në kohë të ndryshme aplikohen edhe në krahina të tjera të Shqipërisë, p.sh. vendosja e degëve aplikohet edhe në krahinat e Elbasanit, por për Ditën e Verës, dhe pa i kënduar hyjneshtës Zogele. Ata i këndojnë hyjneshtës së tyre Zogele, e jo të Shenjtut Gjergj dhe as hazreti Hidrit (hizrit). Në këtë mëngjes të kësaj dite të gjithë duhet të tundin kosin në dybek dhe të bëjnë dhallë, që nënkupton të mos u shkoj vera pa dhallë. Vlen të përmendet fakti që Zogeles i këndojnë disa ditë para Shën Gjergjit dhe përfundon me datën 6 maj.

Lind pyetja çfarë paganizmi janë këto rite unë përgjigjem me plotë bindje është paganizëm i paraardhësve tanë iliro-pellazg, në rastin tonë dardan, për arsyet që do t'i trajtoj më poshtë: Personazhi më interesant i ritit të mësipërm është hyjnesha “Zogele”. Më ka ngacmuar fakti se çfarë është kjo hyjneshtë, pse i këndohet me kaq pasion, a ka ekzistuar dhe çfarë është në të vërtetë? Këto e shumë pyetje të tjera më kanë ngacmuar vazhdimisht. Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve kam intervistuar më shumë se njëqind gra dhe burra të moshuara nga Zajazi, por edhe nga fshatrat e tjerë përreth tij, se si e perceptojnë “Zogelen”? Prej të intervistuarve kemi marrë përgjigje nga më të ndryshme, që do t'i përmendim në vijim.

Brenda natës hënore të Shën Gjergjit zhvillohen njëkohësisht një sërë ritesh të tjera si, vrapimi i kuajve, mundja e tarakëve, mundje, dhe plot gara të tjera sportive, që nuk i ka vetëm Zajazi, por edhe tërë zona, kjo traditë është mjaft e mocme jo vetëm e ilirëve, madje po ashtu e grekëve të vjetër kryesisht e spartanëve e romakëve e tjerë. Por e rëndësishme ka qenë se ndonëse këto rite nuk kanë kuptim fetar, po ashtu kuptim të besëtytnive pagane. Këto zhvillohen për të zbavitur më mirë kremtuesit. Kjo ceremoni kulti për nga përmbajta duhet të jetë gjithashtu religjioze, ndërsa për nga emërtimi sa më i pëlqyeshëm.

Ka mjaft klerikë myslimanë, të cilët janë prononcuar nëpër rrjete sociale në internet duke rekomandojnë që Shëngjergji të mos kremtohet nga se nuk mund të jetë i lejueshëm nga rregullat islame, pasi ky ishte kremtim katolik, por këta e ndalojnë po ashtu kur kjo festë kremtohet me rite pagane kur e kemi parasysh referimin fetar islam. Unë i pyes këto klerikë nëse populli nuk do kishte kultivuar këto zakone, ceremoni dhe rregulla a norma në mënyrë të konservuar qysh prej antikitetit, sigurisht ne kishim me qenë një popull me të kaluar të hershme. Sipas kësaj kemi bindjen se shqiptarët e fesë islame nuk i kremtojnë ceremonitë pagane si bindje, por i kremtojnë si një dëshirë dhe porosi që rrjedhin nga thellësitë e shekujve të paraardhësve të tyre, duke ruajtur identitetin kombëtar dhe duke qenë i rrezikuar nga pushtues të ndryshëm nga gjitonët romak, sllavë apo osman. Vështroar nga kjo pikëpamje kemi bindjen se këta nuk i lëndojnë punët e besimeve fetare apo bindjen e fortë në to. Kemi mendimin se ca besimtarë s'ka nevojë të ngatërojnë predikinin fetar me kulturat. Shqiptari nuk mendon qoftë si arab ose si romak apo si sllav, por si shqiptar mbi këtë themel pamohuar kulturën tonë kombëtare por për ta ruajtur me zell të jash-tëzakonshëm këtë, këta kanë lejuar dhe përkrahur bindjen e fortë religjioze në mënyra të ndryshme, katolik, ortodoks, mysliman e tjerë. Këtu jemi të mendimit se qëndron njëkohësisht kyçi i tolerancës religjioze në Shqipëri.

Në përfundim të këtij studimi dëshiroj të shpreh mirënjohjen time me plot shpirt ndaj bashkëvendësve të mi të Zajazit, të cilët kanë mundur të ruajnë në mënyre njaft të konservuar kaq rite të besimit ilir në shumë hyjni a perëndi, në një çast si ky i Shën Gjergjit, sa që një kohë e këtillë më ngjan si një pemë e praruar dhe stolisur me xhevahire të ndritshëm të kësaj kulture shqiptare. Kam bindjen se kërçovarët e rinj duhet t'a përcjellin më tej, që jo vetëm ta festojnë, por njëkohësisht të kultivojnë me zell të jashtëzakonshëm ritet. Ky realitet na kthen në një muze të gjallë apo me vlerë të kulturës ilire (shqiptare), e cila nuk ka nevojë për vërtetim, sepse ajo i ngjan vulës së njomë të identitetit kombëtar që ndoshta lypset të merren më shumë historianët dhe të rinjtë e arsimuar nga treva e Kërçovës. Është kjo një mënyrë të kuptuari nga bashkëfshatarët e mi që ritet e tyre të lashta i ruajnë si sytë e ballit, dhe megjithëse janë besimtar myslimanë, ata nuk i lëkundën, as fetë e besimeve të ndryshme, as pushtimet osmane, sllave, për të ruajtur gurët e çmuar dhe shumë të fortë të kulturës shqiptare. Sa më shumë që i kuptojmë aq më shumë ndjehemi krenar për këta dhe paraardhësit e mi të fshatit Zajaz, por edhe borblli ndaj tyre për të pasqyruar kulturën tonë sa të lashtë dhe interesante.

Nga gjithë kjo që kemi trajtuar duket vetëm një përqindje e vogël e begatave të botës së brendshme kulturore dhe morale të vjetërsisë tonë në këto vende që disa njerëz pa ndonjë zotësi vështirësi mbase të influencuar prej gjenit të pararendësve të tyre të moçëm dhe të ri, braktisin hershmërinë e kulturës dhe qenies tonë në vendet tona etnike, të një fshati që jeton mes kishave dhe tyrbeve, të një qyteti me kala, të fshatit Zajaz që në territorin e tij ka një qyteze antike – Uskanën e stërlashtë me pikasje në gërmadhat e tij pjesë të shpëputura e të mbetura që nga trashëgimia Ilire, apo qendre të vogël banimi, hapësira e të cilit qarkohet prej tre shtëpive të larta prej guri për vetëmbrojtje që në zemër të tyre ndodhej një burim i mbuluar dhe i ftohtë me ujësjellës me tuba qeramike që përcakton kohën që nga epoka e romakëve.

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti "Nënë Tereza" – Shkup

DISA VENDE KULTI GJATË MANIFESTIMIT TË SHËNGJERGJIT NË VENDBANIME SHQIPTARE

Hyrje

Festa e Shëngjergjit është e veçantë nga festat tjera të motmotit, sepse realizohet nga pelegrinë në vende të caktuara kultike fsha-trash. Pothuaj në të gjitha vendbanimet shqiptare ekzistojnë vende të tilla kulti ku të rinjtë vizitojnë qoftë për tu zbavitur, qoftë edhe për të kryer rite dhe ceremoni që lidhen me këtë festë e natyrës. Për këtë ditë përgatiten ushqime që duhet t'i marrin me vete. Zakonisht shkohet në lëndina që është një vend malor ose mund të zgjedhin ndonjë fushë me gjelbërim. Pra shkojnë në vende me bukuri natyrore ku mbledhen të gjitha vajzat dhe djemtë, familja e tyre etj.

Disa prej këtyre vendeve edhe sot e kësaj dite, janë vende kulti ku zhvillohen shumë ceremoni për qëllime të ndryshme, si psh.: aty shkojnë gratë të cilët nuk kanë fëmijë, nuk u rrojnë fëmijët, nuk i mbajnë shtatzënitë. Aty shkojnë edhe ata që kanë shqetësime në jetë dhe në këto vende kulti luten për plotësimin e dëshirave të tyre, sidomos në ato drejtime ku kanë mungesa, si në rastet kur nuk u ka dalë fati i martesës, vuajnë nga ndonjë sëmundje etj.

Vende kulti në vendbanime shqiptare

Në këtë kumtesë kemi për zgjedhur disa vende të tilla kulti nga disa rrethe, si nga Tetova, Gostivari, Pelagonia, Presheva dhe Anamora-va e Kosovës.

“Guri i Caucave” në kufirin mes fshatrave Veshallë dhe Bozovcë të Tetovës

Në fshatin Veshallë dhe Bozovcë, vajzat bashkë me djemtë dalin në natyrë të mbledhin lule. Karakteristikë e këtij manifestimi që si duket është edhe unikat në tërë botën shqiptare është se në këtë takim pas një udhëtimit të gjatë nga fshati, marrin pjesë vetëm vajzat, e assesi gratë e martuara. Është me rëndësi për këtë rast të përmendet se ky takim bëheshte vetëm në një vend të caktuar që më kohë e kishte fituar toponimin **“Guri i Cucave”** (Gjuri i Caucave) që gjendet në kufirin që e ndanë rajonin e këtyre fshatrave. Ky vend, me shekuj i pret këto të rinj të cilët që nga mëngjesi deri vonë pas dite, e kalojnë kohën duke mbledhë lule, duke kënduar e duke hedhur valle. (Bexheti, Zeri 5–6/2013:5).

“Ke Mullajni dhe Bashineci” në fshatin Cërnilishtë të Prilepit

Në fshatin Cërnilishtë, rrethi i Prilepit, banuesit vendas me shekuj kishin rivendosur ritet dhe i paraqisnin në fshat dhe në tubimet folklorike. “Në këtë ditë secili duhej të zgjohej sa më herët dhe bëhej gara se cili do të shkojë më parë te vendi i quajtur **“Mullajni”** saktësisht te lumi që rrjedh aty. Ata zgjoheshin që në orën 3, nënat për u thoshin fëmijëve: *“Grajni ka saati 3 ene të shkoni ke vija”*. Besonin se kush i lante sytë i pari, ai nuk do ishte përtac gjatë vitit. Prej atje mbushnim ujë dhe e stërpiknim rrugën që t’ua lëmë mërzinë të tjerëve. Prej livadheve mblidhnim lule dhe çfarëdo barna dhe mbushnim ujë. (Ibrahimi, Zeri 5–6/2013:12). Te ky vend kulti, kishte një vend që e quanin **“Bryma e mullajnit”**. Kjo ishte një vrimë nga buronte ujë i ftohtë dhe këtu zhvilloheshin disa ceremoni. Së pari i lanin sytë tri herë, dhe para se të largoheshin hidhnin ujin mbrapa, duke thënë; *“Si ec ujë, ashtu t’na ec shneti”*. Më pas mbushnim një xhymë ujë nga vrima dhe u përgatisnin krunde lopëve që mos të sëmuren, por edhe mos t’i marrin mësysh, kurse në mëngjes lopët i ngrinin me shelg, që të jenë të shëndetshme. (Ibrahimi, Zeri 5–6/2013:13).

“Uji i Tharët” në Fshatin Balindoll të Gostivarit

Ceremonitë e Shëngjergjit në *fshatin Balindoll të Gostivarit* zhvillohen te vendi i quajtur “Uji i Tharët”. Emrin e ka marrë për shkak se burimi ka ujin e tharët. Aty mbledhen shumë banorë, të rinj e pleq nga të gjitha fshatrat e Gostivarit. Vijnë edhe lodra me surle që tanë kohës po i bien, kurse të rinjtë dhe të rejat vallëzojnë, këndojnë. Zakonisht u këndojnë këngë atyre që kanë: nuse të fejuara, marrja e nuseve dhe këngë syneti. Me veti marrin ushqimet e përgatitura enkas për këtë festë. Ulen në formë të rrethit me qëllim që në mesë të këtë hapësirë për ushqimet që duhet të vendosen, dhe më pastaj fillon ahengu i vajzave beqare dhe grave tjera që janë mbledhur, të cilët këndoj, vallëzojnë, luajnë lojëra të ndryshme, tregojnë barsoleta interesante vetëm e vetëm që dita e tyre të shkojë me gëzim dhe hare, nuk duhet të këtë hidhërime dhe mos pajtime, po të gjithë të kënaqen bashkë me aktivitet që duhet të bëjnë. (Ismaili, Zeri 5–6/2013:19–20).


“Guri i Sokol Lecit” në fshatrat Dobri Doll dhe Negotinë të Gostivarit

Pastaj të gjithë gratë dhe vajzat mbledhen dhe shkojnë në ndonjë rrafsh, por më shpesh te një vend që quhet “Guri i Sokol Lecit”, është një gur i madh, i cili gjendet mbi fshatrat Dobri Doll dhe Negotinë të Gostivarit, edhe vajzat dhe gratë e fshatrave përreth vijnë të ky gur Ditën e Shëngjergjit.

Gojëdhënat për të janë të larmishme, por mjaft i përhapur është shpjegimi sipas legjendës së Sokol Lecit, i cili kishte rënë në dashuri me një vajzë, por lidhjen në mes të rinjve e pengon dhuna që i shkaktojnë vajzës, duke ia imponuar asaj egërsisht martesën me një njeri tjetër. Këtë dhimbje Sokol Leci nuk e përballon dhe mbasi nuk gjen rrugëdalje tjetër, tepër i tronditur i le delet në mal, si çoban i tyre, varë jelekun në dushk dhe hidhet e nga kepi dhe mbytet, pikërisht tek ky gur, që tashmë mban emrin e tij, "Guri i Sokol Lecit".



Guri i Sokol Lecit



Shpella e gurti të Sokol Lecit

Te ky gurë, Ditën e Shëngjergjit shkojnë shumë gra dhe të reja nga i gjithë rrethi i Gostivarit dhe i Tetovës, jo vetëm nga fshatrat përreth. Zakonisht aty shkojnë: gratë të cilët nuk kanë fëmijë, nuk u rrojnë fëmijët, nuk i mbajnë shtatzënitë. Ata që kanë shqetësime në jetë e luten për plotësimin e dëshirave të tyre, sidomos në ato drejtime ku kanë mungesa, si në rastet kur nuk kanë fëmijë, nuk u ka dalë fati i martesës, vuajnë nga ndonjë sëmundje etj. Kështu p.sh.: Vajzave të cilave ende nuk u ka dalë fati për martesë, këndojnë: *"Sokol Lec e gurë, të më apësh një burr"*, kurse ata që janë të sëmurë këndojnë *"Sokol Lec e kep, të më apësh shëndet"* etj. Gratë që nuk kanë fëmijë rrotullohet rreth e përqark gurit me një-tin e vetëm të kenë fëmijë dhe këndojnë: *Sokol Lec o të kam mall – të lutem ma fal një djalë"*. (Ismet Jonuzi-Krosi, Yll-Press, 2003).

Ja edhe disa ceremoni në këtë gurë: te Guri i Sokol Lecit qepin këmishë prej shtatë pjesësh të pëlhurës, e këtë ia veshin fëmijës pasi që të lindet. Në këtë vend i ziejnë 9 kokrra vezë të freskëta, të cilat shtatzëna i ha, por ndodh që edhe të tjerët të hanë vezë, ngase besohet se do të lind fëmijën në nëntë muaj. Pastaj marrin tri guralecë dhe i qepin në një leckë prej pëlhure, dhe shtatzënë ia lidhin për brezi, e cila atë e bart deri sa të lind fëmijën.

Vajzat të cilat shkojnë te Guri i Sokol Lecit shtrihen në tokë dhe gratë rreth trupit të tyre gropojnë një vijë që i japin formën e trupit, pasi çohen pjesën ku e ka pasur barkun e gropojnë më shumë dhe

nëse dalin gur të bardhë atëherë do të lindin djem, ndërsa nëse dalin gur të zi prej toke, atëherë do të lindin vajza, sa gur do të dalin aq fëmijë do të kenë, kurse dheun që e kthyen rreth trupit që tu kthehet shëndet. Në mbrëmje kur kthehen në shtëpi gatuajnë “aligjin”, lloj ëmbëlsire ngjajshëm si e bakllavës dhe hanë që tu shkojë viti ëmbël. (Saliu, Zeri 5–6/2013:27).

“Uji i Tharrët, Livagjet, Hamari i Teges, Te Mullinjtë dhe Kalaja e Tetovës” në fshatin Sellcë të Tetovës



Diku rreth orëve të pasdrekes, sipas lagjeve të fshatit dhe të shoqëruara edhe me një numër më të vogël djemsh, grumbulloheshin vajzat dhe gratë, që gjithsesi i merrnin edhe fëmijët, dhe ashtu në grupe niseshin në drejtim të vendeve më të bukura të fshatit. Vendi më i preferuar ishte **Uji i Tharrët** te Gabria mbas ***Kishës Mishivecit, Livagjet, Hamari i Teges, Te Mullinjtë dhe Kalaja e Tetovës.***

Vajzat gjatë tërë kohës këndonin dhe u binin dajreve. Me të arritur në vendet e caktuara, fillonte mbledhja e luleve dhe thurja e kurorave me lule nga më të ndryshmet. Ishte rregull i prerë që kurora me lule kurrësi s’guxonte të lëshohej përtokë. Ajo detyrimisht duhej mbajtur në dorë ose në kokë. Ata që shkonin te vendi i quajtur **Uji i Tharrët**, pasi i mbushnin shtambat (pa i lëshuar fare në tokë) ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre. (Kurtishi 2005).

Kroi i Keq te Lugina e Preshevës (Mëhalla e Derrajve, te Vreshtat e Preshevës, te Furrat e Qyreçit, në veri të qytetit).

Shëngjergji festohet edhe në hapësirat tjera mbarëshqiptare, midis tyre edhe në Luginën e Preshevës. Edhe banorët e kësaj ane shkonin në vende të posaçme kulturi ku kryheshin disa rite dhe ceremoni te vendi i quajtur **Kroi i Keq**. Ky vend sot është çezmë dhe gjendet te Mëhalla e Derrajve, te Vreshtat e Preshevës, te Furrat e Qyreçit, në veri të qytetit.

Kroi i Keq është i njohur shumë dhe i popullarizuar, sepse më 6 maj, Ditën e Shën Gjergjit, për çdo vit, populli, sidomos vajzat e gratë shkojnë për të kërkuar shëndet, duke i lajtë sytë me ujë Kroi dhe duke i mbushur enët e ndryshme për në shtëpi, ku i stërpikin anëtarët e familjes. Po ashtu vajzat e reja, aty shkojnë për të kërkuar njohje dhe dashuri. Kohëve të fundit, Kroi i Keq më shumë vizitohet nga Romët, të cilët atë ditë e kanë festë të tyre.

Gjatë Ditës së Shën Gjergjit më 5 maj pas dite, dhe më 6 maj. Atje mbledhnin degë pemësh, sidomos shelgjeve dhe me këto i stolisin dyert e shtëpive, dritaret e shtëpive si dhe mbushnin ujë të Kroit të Keq që ishte i shëndetshëm, i mirë për pije. Ky ujë më shumë përdorej për Ditën e Shën Gjergjit, në mëngjes kur nënat i lajshin fëmijët me këtë ujë për shëndet, duke i qitur edhe lule e degë të pemëve.



Kroi i Keq tek Mëhalla e Derrajve të Preshevës

Më poshtë po shkruajë një legjendë që ma tregoi Enver Sahiti i Mëhallës së Derrajve në Preshevë: Baba Nikollë–Staka si tregtar i madh udhëtonte në vende të ndryshme të Gadishullit Ballkanik, duke përfshirë edhe Turqinë e sotme dhe vendet e Lindjes së Afërt–Levantit që asokohe ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Staka sa herë që kthehej nga ato vende të largëta, me vete sillte fryte dhe shorte të pemëve si dhe fara të luleve të rralla. Këto i mbillte në vendin që sot njihet me emrin “Kroi i Keq”, por për çudi asnjëra prej tyre nuk zinte. Ai ishte shumë i durueshëm dhe përsëri mbillte. Më në fund biu një bimë e rrallë, e cila pas disa vitesh filloi të lulojë, mirëpo bima me lulet ishin të panjohura për këtë vend.

Historia e ujit të “Kroit të Keq” lidhet me sëmundjen e një vajze të bukur me emrin Nika/sipas të gjitha gjasave shkurtësë e emrit Veronika/ e cila vite me radhë shkonte pas dite me të gjyshen në kopshtin që tash njihet me emrin “Kroi i Keq” për shëtitje dhe freskim. Në moshën e pjekurisë filloi të lëngonte nga një sëmundje e rrallë, e përcjellur me alergji dhe temperatura të larta. Kështu, ajo filloi të shkonte për çdo ditë, në agim, për tu flladitur, për tu shpërla me ujë të kroit, për të medituar, për të marrë ajër të pastër dhe erë luleve të pemës së rrallë. Lulet e pemës kishin ngjyrë të katërt me nuanca të lules vjollcë, ndërsa për cilën pemë me lule bëhet fjalë, legjenda heshtë. Ajo rastësisht filloi ti përdor këto lule, që binin në ujë e lëshonin një lloj ngjyre, për të përgatitur një lloj çaji, e pavetëdijshme për cilësitë e saj kuruese të çajit nga lulja. Uji i kroit që buronte nën rrënjët e kësaj peme, fillimisht përdorej vetëm për pije, e pastaj pasi tek vajza panë disa ndryshime, asaj filloi ti ndryshojë lëkura, duke i përdorur lulet si çaj. Ajo filloi të bëjë çaj dhe të përgatisë më shpesh këtë çaj deri sa u shërua plotësisht. Pas një kohe u përhapën fjalët për vetitë kuruese të ujit dhe çajeve të asaj luleje te Kroi i Keq. (**Xhemaledin SALIHU**)

Kroin e Xhurrumelit, ose "Përroi i Kishës" në Tërnovc

Pas dite grupe njerëzish, familjarësh të rinj e të reja, por edhe më të vjetër vizitonin Kroin e Xhurrumelit, që ishte Përroi i Kishës.” (Tërnovci nëpër shekuj, Prof.Sali Salihu—Prof. Nehat Ramizi, në faqen 122)

Trojet e Tupallës (Medvegjë)

Në Medvegjë popullata shqiptare festonte Ditën e Shën Gjergjit në një vend të caktuar, në Trojet e Tupallës, ku mbledheshin nga të gjitha katundet shqiptare, diku deri në vitet e 70-ta dhe zhvilloheshin gara tradicionale ndërmjet të rinjve: hedhje guri, gjuajtje e tjerë. (Ismail Muharremi në librin e tij: “Mos harro...!(Më shumë fjalë se fjalë),f.25:)

Tyrbet e Anamoravës

Në rajonin e Anamoravës, më konkretisht në fshatin Tuxhevc, rrethi i Kamenicës, për festën e Shëngjergjit janë mbledhur të gjitha gratë e fshatit, dhe të veshura bukur i janë drejtuar tyrbeve. Aty kanë shkruar për të shkruar hajmali për njerëzit e shtëpisë e për bagëtinë që të mos i rrokë mësyshi. Tri tyrbet më të njohura të kësaj pjese të Anamoraves, të cilat vizitoheshin nga gratë e kësaj pjese janë: Tyrbja e Jallaqes, Tyrbja e Rogoqices dhe Tyrbja e Dazhnices.

PËRFUNDIM

Disa prej këtyre vendeve edhe sot e kësaj dite, janë vende kulti ku zhvillohen shumë ceremoni për qëllime të ndryshme, si p.sh.: aty shkojnë gratë të cilët nuk kanë fëmijë, nuk u rrojnë fëmijët, nuk i mbajnë shtatzënitë. Aty shkojnë edhe ata që kanë shqetësime në jetë dhe në këto vende kulti luten për plotësimin e dëshirave të

tyre, sidomos në ato drejtime ku kanë mungesa, si në rastet kur nuk u ka dalë fati i martesës, vuajnë nga ndonjë sëmundje etj. Zakonisht këto vende kulti kanë edhe legjendat e veta për vetitë magjike të kurimit, që duhet gjithsesi të mbliidhen dhe shënohen si pjesë përbërëse të trashëgimisë sonë kulturore.

HAMDI MEDIU–DUSHI

Komuna e Tetovës

FESTAT E SHËN GJERGJIT NË POLLOG

Festat që shënojnë lashtësi gjithnjë kanë qenë pjesë e jetës së bano-rëve të rajonit të Pollogut dhe më gjerë. Kremtimi i tyre ka qenë gjithnjë dimension i rëndësishëm i traditës, ndërkohë që ato ndër shekuj kanë bartur gjithë bukurinë e shfaqjes me të gjitha elementet përcjellëse që shënojnë ripërtëritje, vitalitet dhe shpresë për popullatën në kalendarin e kohës.

Edhe festa e Shën Gjergjit ruhet në kujtesën e banorëve të këtyre anëve dhe kremtohet me po të njëjtat kuptime dhe me të njëjtat besime popullore që barten nga brezi në brez me të gjitha ritet përcjellëse dhe me gjithë ndjeshmërinë si festë që shënon ringjalljen e plotë të natyrës. Kjo festë vjen me tiparet e veta, me konstantat e kremtimit që ruhen dhe transmetohen në grafiknin e kohës, por tashmë me një intensitet shumë më të ulët.

Sidoqoftë kjo festë mbetet e pranishme në trevat e Pollogut, pavarësisht se ka filluar ta humb fuqinë e saj të kremtimit. Por, ky punim, në fakt sjellë domethënien e kësaj feste dhe gjithë veçoritë që e karakterizojnë atë si një festë pagane. Nëpërmjet prurjeve origjinale, punimi vë në spikamë elementet e festës së Shën Gjergjit, ritualet, besimet dhe shfaqjet që e shënojnë këtë festë dikur të kremtuar gati në të gjitha vendbanimet e rajonit të Pollogut dhe më gjerë.

Megjithëse në ditët e sotme rrallë kund festohet dita e Shën Gjergjit si në kohërat e mëparme, në këtë punim do të japë disa rite të rajonit të Pollogut, për festën e Shën Gjergjit, të mbledhura nga disa persona të moshuar nga vendbanime të ndryshëm të fushëgropës së Pollogut.

Më 6 maj është dita e Shën Gjergjit, në këtë ditë kremtohet festa e madhe popullore pranverore, që hyn në kategorinë e festave të motmotit, ka origjinë pagane dhe është relik i ndërrimit të hyjnine dhe demonëve të natyrës në lashtësi. Dita e Shën Gjergjit festohet për të përjetuar përfundimin e dimrit dhe ardhjen e stinës së verës. Dhe kjo festë karakterizohet nga lojëra të shumta, është festë me shume rite, gjelbërim, ndezje të zjarreve rituale në vende publike, mbledhje lulesh e thurje kurorash. Më pas shkohej rreth prockave për të marrë degë të gjelbëruara shelgu, ku i çonin te mulliri dhe tek lugu i mullirit lahashin degët e shelgut, ata dërgoheshin nëpër shtëpitë, dhe më pas këto degë vareshin në derët e shtëpisë.

Edhe pse më 21 mars fillon dita e verës (ashtu perceptohet në popull), me këtë rast zihen kokrra misri me fajë (hi) dhe gatuhet arempite me miell misri, si dhe përgatiteshin gurabija të ëmbla, ky adet ka ngelë nga e kaluara jo shumë e largët. Përgatitjet për festën e Shën Gjergjit janë nisur disa ditë më herët. Në këtë festë ishte e zakonshme të vendosej Tërluçkë (një lloj kollovajtje, në një nga oboret e mahallës, në të cilën luhateshin gjatë gjithë kohës së festës). Një ditë para feste, të rinjtë zakonisht tuboheshin grupe-grupe dhe shkonin shtëpi në shtëpi për të lypur vezë, miell, drithë, tëlyen, sheqer etj. Gjërat e mbledhura i grumbullonin në ndonjërin shtëpi aty ku do festohej nata e Shën Gjergjit, dhe me këto artikuj përgatiteshin gurabije dhe darkë e majme për të rinjtë që do ta festonin natën e Shën Gjergjit. Ashtu që të rinjtë festonin deri në orët e mëngjesit. Vajzat këtë natë mblidheshin nëpër familjet ku kishte nuse të fejuara, dhe tërë natën këndonin këngë për nusen e djalin të fejuar. Gjatë kësaj nate haheshin gurabijet dhe thyheshin arra të cilat i ruajnin apostafat për këtë natë (që të jenë të fortë si arrat). Para se të agojë kjo ditë, vajzat fshehurazi dalin në drejtëm të arave (tokës) të mbjella me grurë e thekër. Kështu që ata në bimët e njomura të drithërave të bukës shkarraviten duke thënë “të rritna si thekra-gruri”. Në këtë ditë vajzat të veshura me rroba të reja dhe në grupe, shëtisin nëpër kopshte duke kënduar këngë të ndryshme.

*“Marhama me taufa, marhama me taufa,
E zgjodhe ndër cauca, Hasan aga.
Marhame me tel, marhama me tel,
E zgjodhe ndër djem, Xhemile hënëm.
Kapërcej bilbili përreth derës,
Bilbili kë më bëne mu të mjerës,
Nauk të bana xhë, nauk të bëna xhë,
Ta dhash Hasan agën dilber në dinjë,
Rrajtu mi Xhemile hënëm, rrajtu ene më”.*

Kurse ato vajza që kishin të fejuarit e vet nëpër kurbete këndonin këngë të thurura apostafat për ato:

*“Fishkëlloj pampuri ka Shkupi,
Ky Hasan dilberi ku më hupi,
Mos e baj at gajle oj e dashura jeme,
Si më ka qu ashtau do më bjere,
Dilber Hasan aga ka do shkoje,
Udha karanfila do ti zbulojë”.*

Në kopshte vendosnin sallanxhaqe dhe luhateshin deri në orët e mbrëmjes. Në këtë ditë, djem e vajza dalin në periferi të vendbanimeve dhe në rudina (livadhe) me qëllim që të kthejnë plisa dheu. Vajza me këtë rast shtrihen në kokërr të shpinës për të shënuar shtatin e saj, kurse e shoqja më e afërt, gërryen dheun, dhe atë dhe e kthen mbrapshtë duke thënë: **“për shëndet më të mirë”**, si dhe: **“këtu të mbesin të ligat e të këqijat”**, dhe së largu hidhet ndonjë nga teshat që ka veshur, që sa ma lart të jenë të këqijat nga trupi i saj ose atij.

Në këtë festë mblidheshin kungull të egër në malet afër fshatit, pasi i pritshin në forma të rrumbullakëta, dhe mandej i radhitshin në penj të kuq e të bardhë dhe gjatë një nate i vendosnin në degët e pemëve të varura (si zakonisht në degët e jargavanit ose të trëndafilit). Ditën e nesërme ua varshin fëmijëve në qafë, pasi i mbajnin tre

ditë rresht të varura në qafë, i merrnin këto vargje dhe i hidhnin në përroska (ujë) që ishte në rrjedhje, në këto raste nënat kishin një thinje: “**si hecën ki uji ashtau i hec të shëndeti femiut**”, pas kësaj ndodhie u pritnin flokët e fëmijëve dhe i hidhnin në përroskë. Gjatë kësaj feste vajzave të fejuara nga ana e familjes së djalit u dërgohej dhurata, (**shëngjergjllëk**) një palë nallane dhe një shami (kovrak), kurse sheqeri dhe gjësendet tjera ushqimore i dërgoheshin për bërjen e gurabijeve që të festoj me shoqet e saja festën. Të gjithë këto dhurata stoliseshin me lule dhe gjethe të llojllojshme.



—I—

ku hecen fëllënza e malit

Shaum me serbesllëk

Do ti çojm të majrës shëngjergjllëk

Për shëngjergjllëk e majra ishte

Ma e majr se shoqet më ishte

Taurën ndër cauca e kishte

-II-

oj fëllenza e malit lulja e telit
Ku do ta ruajsh natën e shëngjergjit
Ene simjet do ta ruj te baba
N'mot e qera vjet të Hasan aga
Ene simjet do ta ruaj ke nenja
N'mot e qera vjet të hankonenja

Ditën e Shëngjergjit zakonisht është parapa që të therën pula për ngrënie, qëllimi i këtij adeti ka qenë që asaj shpije t'i rritet numri i pulave. Fëmijët të moshës më të vogël si zakonisht nënat në këtë ditë feste i lanin me gjethe të trëndafilave dhe jargavanëve, duke mos përjashtuar as llojet e luleve të tjera. Kështu që fëmijëve mandej ua vishnin rrobat e reja dhe ua varnin në qafë vargje me thelpinj kungujsh të egër. Plakat në këtë ditë feste stolisnin dyert e hyrjeve të shtëpive si dhe dhomat me degë të njoma të shelgjesh, arash, etj.



Në këtë natë nuk shuhej zjarri dhe i përkushtonin shumë vëmendje që mos të shuhet zjarri në vatër. Ashtu si kanë gjallëruar lulet të gjallërojnë dhe të ketë mbarësi familja, blegtoria, si dhe prodhimet blegtorale.

Familjet që kishin bagëti e zonja e shtëpisë e nxirrte mutinin (dy-bekun) e stolisur me lule të llojlojshme, tundte kosin dhe e afronte afër pusit duke kënduar këngë të ndryshme, ku qëndronte gjatë tërë ditës, ashtu që lopët të kenë më shumë qumësht, njashtu si pusi që ka ujë.

—I—

*kur do të those hankunenja haj taunde mutajnin
Mos i thauesh hankonenes do ta thi turajnin
A mori taj nause fudulle haj taunde motajnin me lule.*

—II—

*“Taundu taundu more shoç,
Rrajte kokën sa ni kollomoç,
Taundu taundu more bir,
Rajte kokën sa ni kallajë,
Taundu more taundu,
Rrajte kokën sa ni lethaj,
Taundu taundu more vlla,
Rrajte kokën sani arë”.*



Në këto ditë të festës së Shëngjergjit, poashtu ndodheshin edhe disa loja tek djemtë e rinj siç ishin, kërcime me një dhe me tre hapa. Fituesi është shpërblye me një gurabije ose me diçka tjetër.

Loja “Hedhja e gurit”, ku ata që e ndjenin veten të aftë kanë marrë pjesë në hedhjen e gurit, dhe atë në tre mënyra të hedhjes: me një dorë, me dy duar dhe me duart pas shpine, poashtu edhe këtu fituesi shpërblehej.

Në këtë periudhë kohore më atraktive ka qenë vrapimi me kuaj. Pasi fillon stina e re, si zakonisht ata që i kanë ruajt kuajt dhe i kanë ushqyer më mirë i kanë nxjerrë për gara. Garat e vrapimit të kuajve janë mbajtur në këtë kohë, sepse akoma nuk kishin dal punët e fushës, e kuajt ishin të pushuar gjatë stinës së dimrit. Në këto gara të vrapimit të kuajve, fituesi (kalëruesi) merrte shpërblime të majme, shërveta, çorapa, bile–bile edhe mintana, po qe se pronari i kalit ishte nga më të pasurit.

Kështu në këtë mënyrë gati se në çdo fshat të Pollogut janë festuar festat e Shëngjergjit, me rituale të ndryshme, varësisht prej vendit (fshatit) por ka qen një periudhë e vitit që të rinjtë e kanë prit me një kënaqësi të veçantë.²⁸

²⁸ Për mbledhjen e këtyre të dhënave për festat e Shëngjergjit (6 Majit), kamë biseduar me shumë qytetarë të disa fshatrave në Pollog, dhe atë me më të moshuarit:

- Adem Mehmedi, Pirok i lindur më 1933;
- Musli Osmani, Pirok i lindur më 1931;
- Hashim Jashari, Pirok i lindur më 1937;
- Hajrije imeri, Dobridoll, e lindur më 1948.
- Xhevrije Medija, e lindur në fshatin Sllatinë më 1936 (nëna ime);
- Hedije Neziri, Bogovinë e lindur më 1926. (halla e babait);
- Haxhi Lazim Rahimi, Gradec i lindur më 1938;
- Hajrulla Zulbehari, sedllarc e epërme i lindur më 1947;
- Enis Jusufi, Pallçisht i lindur më 1942;
- Sami Junuzi, Poroj, i lindur më 1932;
- Mevaip Ismaili, Xhepçishtë, i lindur më 1933;
- Ferat Berzati, Pirok, lindur më 1937.

Literatura:

- BERISHA, Metush R., *Reflektime të traditës kulturore* (Karadaku i Preshevës), Prishtinë, 2013.
- DERVISHI, Nebi. (2005). *Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit 1*. Tetovë (f.329 –330).
- HASAN, H. (1995). *Negotina me rrethinë*. Tetovë.
- IBRAHIMI, Mustafa. (1993). *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë. Shkup*.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2013). *Cikli i festave të pranverës në fshatin Černilishtë të Prilepit*. Në Zëri i Pelagonisë nr.5-6/2013. Shkup.
- KËQIKU, Hysen, Velia Glaua, *Ëndërr e ripërtërirë*, (Monografi për Velegllavën), Gjilan, 2001.
- KROSI, Ismet J. (2003). “*Yll Press*”, 2003.
- KURTISHI, Qazim (2005). *Sellca ndër shekuj*. Tetovë.
- MUHARREMI, Ismail “*Mos harro...!*(Më shumë fjalë se fjalë), f.25:)
- MUHARREMI, Ismail, *Mos harro...!*(Më shumë fjalë se fjalë), Medvegjë, 2002.
- QERIMI, Sami. (2011). *Koha e ngritjes, krenarisë dhe e dhimbjes*, Prishtinë, 2011.
- SALIHU, Xhemaledin.(2016). *Dita e shën Gjergjit në Preshevë*. <http://bujanoci.net/dita-e-shen-gjergjit-ne-presheve/> : 05/05/2016.
- SALIHU, Sali & RAMIZI NehaT. *Tërnovci nëpër shekuj*, , në faqen 122)
- SALIHU, Sali –Prof. Ramizi, Nehat, *Tërnovci nëpër shekuj*, Monografi, Prishtinë, 2015,
- TIRTA, Mark. (2004). *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë. (253–258).

RINI USEINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

SHËN GJERGJI – IDENTITET BREZASH (RASTI I FSHATIT KOROSHISHTË TË STRUGËS)

Njeriu është qenie religjioze, sepse edhe te parët e tij kanë qenë të tillë. Ato gjithmonë kanë qenë të mahnitur nga ndryshimet e kohës dhe njëkohësisht sipas periudhave të ndryshme, kanë zhvilluar një traditë të ndryshme besimesh. Nëse shihet në thellësi të viteve jo gjithçka ka ardhur e transmetuar ashtu siç e kanë bërë më herët gjeneratat e mëparshme. Kjo ndodhë sepse njeriu po i largohet natyrës duke e harruar atë, duke e harruar se dikur këtë respekt ja ka bërë me qëllim të rikthimit, sa i ka dhënë aq dhe i ka marrë. Mbaj mend si fëmijë se kam qenë subjekt i ritualizuar duke i bërë të gjitha veprimet ashtu siç i kam mësuar nga vëllezërit dhe motrat apo kushërinjtë. Ishte periudhë kur natyra ishte pjesë e jetës sonë dhe në mezi i pritnim këto festime duke mos e ditur kuptimin e tyre në tërësi formale.

Por jeta dinamike e ka bere të veten. Ne radhë të parë mungojnë elementet e nevojshme, nuk ka lule mulliri, nuk ka lloje tjera të luleve sepse përreth këtë hapësirë e ka ndryshuar një pronar. Por përsëri fëmijët janë aty, duke festuar së bashku dhe duke kryer ritet e të parëve. Kur flasim për ritet e të parëve mund ti lidhim dhe me mendimet e tyre që çojnë deri te filozofit e vjetra natyrore. Ndër të parët është natyralizmi i cili brenda vetes sjell atë mendim që shfaqet si besim e që është realisht dukuri natyrore. Dhe pikërisht këtu mund te lidhemi me ciklin e jetës, me ringjalljen e natyrës dhe me-tamorfozën e saj të pastër. Ndoshta kjo mund të jetë një moment kur njeriu në bazë të përvojës shumëvjeçare ka mundur që të bëjë

një ndarje shumë të saktë të ditëve, se cilët janë ato që mund të konsiderohen si fillesa të begatisë së tyre apo ditëve kur duhet të bëhet ndonjë sakrifikim i veçantë, për hir të natyrës dhe përfitimit të të mirave prej saj. Prandaj kemi edhe një ndarje të përpiktë të ciklit të ditëve kalendarike.

Një doktrinë në të cilën mund ta bazojmë kërkimin tonë rreth originës së kulteve që bëhen brenda kalendarit të festave popullore është edhe animizmi apo shpirti i brendshëm të cilën e kanë secila qenie e gjallë apo jo e gjallë. Në aspektin e ciklit vjetor të kalendarit popullor në parim Shëngjergji ka funksionin e njëjtë me festat e tjera të tipit të vetë, parasëgjithash kërkimin deri në sakrifikim për të mirat që ti sjell natyra. Mbi të gjitha më së shumti në këtë mori ritualesh me karakter imitativo—magjik rëndësi të madhe i jepet kultit të vegjetacionit apo bimëve që japin sinjalin e parë për mbërritjen e momenteve kur toka ka nevojë për më shumë kujdes, pas shpërthimit të saj. Në këtë mori ritualesh përfshihet edhe bota e pjellorisë induktive e përfaqësuar me ujin dhe bimësinë të cilat janë të pranishme gjatë gjithë fazës së Shëngjergjit, e cila ka parafazën dhe post fazën e saj.

Në mes të formave të jetës që kanë prejardhje nga toka mëmë më e zhvilluar është simbolika e vegjetacionit, posaçërisht simbolika e drurit, e cila simbolizon jetën. Në origjinë këto relikte paraqesin gjurmë të një besimi të lashtë që të shpie në thellësi deri në shtresë—zimet arkaike paleobalkanike e që ka të bëjë me kultin e pjellorisë së tokës, përkatësisht të bujqësisë, të ndërlidhur me kultin e drurit.²⁹ Tundësja varet në mutin një lule mulliri: varet topthi i kandarit dhe një lëmsh i lehtë e i bardhë, me besimin se mutini gjatë vitit do të tundet shpejt e lehtë, si drugëza, e tundmja e tëlyenit do bëhet e rëndë si topthi i kandarit dhe i bukur si lëmshi i lehtë”.³⁰

²⁹ Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003, 230.

³⁰ Selimi-Osmani, Edibe „*Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit*, Asdreni, Shkup, 1996, 126.

Gjatë ditës së Shëngjergjit aty-këtu vërehet praktikimi i ritualit të ndezjes së zjarreve. Shefqet Pllana ka të drejtë kur thotë se “ndër popullsinë shqiptare të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës etj., festa e Shëngjergjit është festë pranverore më e përhapur dhe në shumë pika përputhet me Ditën e Verës, madje në disa nga këto treva edhe identifikohet duke u shkrirë Dita e Verës në Shëngjergj.”³¹

Një rëndësi të madhe për të shpjeguar animizmin e trupave kanë një numër i madh i objekteve dhe në festën e Shën Gjergjit, sidomos me rastin e festimeve në rrethinat e Strugës e në shembullin tonë në fshatin Koroshishtë dhe Zhepin. Një rëndësi të madhe sa i përket animizmit si objekte të ritualizuara apo të animizuara kanë disa lloje dhe atë vegetacioni i caktuar, gurët dhe uji i shenjtë. Fëmijët shkojnë mbushin ujë në vendin e ritualizuar, është një burim uji, në fshatin Zhepin, vend pak si misterioz e quajtur mulli, ku supozohet të ketë pasur një mull. Në shishen ku fusin ujin poashtu hedhin 3 guralec të vegjël me ngjyrë të kuqe, të zezë dhe të bardhë. Këtë ujë në mënyrë fanatike duhet ta ruajnë deri në shtëpi, në mënyrë që asnjë të mos të ketë kontakt me të. Poashtu në pjesën e sipërme i fusin edhe disa lloj bimësh, si lule mullini. Në këtë shembull lulja simbolizon shpirtin e tokës, dhe e cila nëpërmjet të futjes së saj në ujë e mbanë frymën e gjallë dhe njëkohësisht atë magji të saj e shpërndan brenda ujit. Prandaj në këtë rast uji shndërrohet në një objekt të veçantë ritualistik, ai është i shenjtë dhe si i tillë nuk guxon të preket apo të goditet me gurë ose diçka tjetër. Nëse ndodhte kjo fëmija apo subjekti i ritualuar e hidhte atë ujë dhe shkonte përsëri e fillonte ritualin e njëjtë duke u kujdesur që të mos preket uji deri sa të mbërrij në shtëpi dhe pastaj e vente mbi trendafil apo ndonje pemë të lartë. Me këtë ujë në mënyrë purifikuese lahen të gjithë fëmijët, qoft pjesët më të rëndësishme të jashtme si fytyra, duart dhe goja por ka raste kur lajnë gjithë trupin me qëllim që trupi të jetë sa më i pastër.

³¹ Shefqet Pllana, Këngët e motmotit ndër shqiptarë, Gjurmime Albanologjike 2/ 1965, Prishtinë, 1965, f.228-229.

Shembull më përgjithësues mund të merret edhe me fshatrat e tjerë, nga fshatrat Pohum, Bogovicë dhe Mislodezhde, që janë fshatra malor. Gratë dhe fëmijët nga këto fshatra kanë zbritur deri në fshatin Dobovjan që të lahen me ujë të lëvizshëm me qëllim që e mira të lëviz brenda vetes së tyre, nëpërmjet të ujërave të shenjtë që marrin këtë epitete në këtë festë. Poashtu në ditën e Shën Gjergjit fëmijët dhe të rriturit veroret të cilat i kanë venduar në Diten e Verës i heqin nga biziliku i dorës dhe i vendojnë mbi ndonjë pemë të lartë me qëllim që të kenë shëndet. Verorja në këtë rast shndërrohet në mbrojtëse të fëmijës gjatë vitit dhe me këtë qëllim zakonisht vihet apo lidhet në ndonjë degë të lartë të drurit.

Kjo fiton forcë më të madhe sidomos në disa burime të konsideruara të shenjta, sikundër që ndodh në fshatin Shum, në burimin e së cilës rrinë një plak e cila i dinë fshehtësitë e ujërave dhe me të mund t'i shëroj njerëzit nga ndonjë *e bome* apo mund të ju heq grave magjinë që ju është bërë, të mos bëjnë fëmijë apo të jenë shterpa. Ato që nuk mund të bëjnë fëmijë, e lajnë zakonisht fytyrën dhe e lyejnë me ujë vendin e fëmijës nga pjesa e sipërme e lekurës. Por ndodh që edhe të futen me gjithë rroba në ujë me qëllim që shpirti i ujit të depërtoj brenda tyre. Për qëllime të heqjes së magjisë mund të merret një pjesë nga veshja e subjektit të magjepsur me qëllim që t'i hiqet magjia. Magjistaria apo plaka që i dinë fshehtësitë e ujërave këndon diçka me gjysmë zëri dhe e hedh pjesën e veshjes në ujë të rrjedhshëm duke thënë: siç lëviz uji ashtu edhe e keqja të lëviz nga uji. Pra, siç mund të shohim nga këto shembuj dhe shembuj të tjerë animizmi është një pjesë e rëndësishme si mendim filozofik në mendësinë e popullit i cili është munduar nëpërmjet të forcave të natyrës të jetë sa më i qetë, duke u shërbyer shpirtit të tyre.

Pra animizmi jo vetëm që sjellë në shprehje një botë ndryshe, që ka bazamentet e saj në fillesat e njerëzimit por nëpërmjet shumë besimeve e besëtytnive, ka arritur që të jetë e pranishme edhe në shumë rite të cilët në bazë kanë karakterin e tyre ritualesk apo të kalendarit të punës. Por vetë ky kalendar i bazuar në shumë kulte të natyrës,

të cilët i japin forcë natyrës ka në vetvete edhe shumë elemente që kanë nevojë të madhe për një shprehje të të mbinatyrshmes dhe e cila në mënyrë metaforike apo në botëkuptimin e të parëve tanë ka pasur një shpirt ashtu siç e ka shpirtin natyra e cila kalon gjithmonë në një rreth vicioz. Ajo kalon nëpër fazat e njëjta ashtu sikur edhe shpirti, ajo lind nga diçka, vazhdon e rritet e derisa shuhet në kohën e shuarjes së gjithçkaje apo në kohën e Shën Mitrit për t'u rikthyer e njëjtë edhe në vitet e ardhshme. Por gjithmonë brenda vetes, me një forcë e cila duhet të jetë e trajtuar ashtu siç duhet ta trajtoj njeriu, një forcë duke i dhuruar të mirat e cila në mënyrë të ngjashme do t'i kthej këto të mira në tokë dhe në jetët e tyre. Pra, njeriu si një qenie e lartë ka përvetësuar më së miri mënyrat e ndryshme për ta bërë më të mirën për atë që i'a siguron mbijetesën. Ashtu edhe sikur thonë edhe studiuesit e parë të këtyre religjioneve si Spencer, Gillen, Stros apo Sterlow, njeriu paraqitet si një subjekt që i shërben natyrës e cila ia rikthen këtë shërbim edhe vetë atij.

Bibliografia:

- Tirta, Mark. *Kulte të bujqësisë dhe blegtorisë në popullin tonë, Etnografia shqiptare*”, IX/1980, Tiranë, 1980.
- Murati, Qemal. *Shënime etnografike nga rrethina e Kërcovës (Festa dhe rite fetare, doke e zakone familjare)*, Jehona, Nr.9–10, Shkup, 1995.
- Murtezani, Izaim. *Festa e Shëngjergjit te Shqiptarët e Maqedonisë*, Sak Stil, Shkup, 2010.
- Xhemaj, Ukë. *Etnokultura shqiptare ne Podgur*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2003.
- Selimi–Osmani, Edibe „*Rite e besime popullore në viset e Tetovës dhe të Gostivarit*, Asdreni, Shkup, 1996, 126.
- Pllana, Shefqet. *Këngët e motmotit ndër shqiptarë*, Gjurmime Albanologjike 2/ 1965, Prishtinë, 1965.
- Durkheim, Emile. *Elementary forms of religious life*, Oxford University Press, London, 2001.

KOSOVARE KRASNIQI

Instituti Albanologjik i Prishtinës

RITUALET DHE CEREMONITË GJATË FESTËS SË SHËNGJERGJIT NË RAJONIN E ANAMORAVËS

Hyrja

Shëngjergji është njëra nga festat tradicionale shqiptare, tek e cila besohet se me zbatimin e ritualeve dhe ceremonive të saj do të përcaktohet edhe mënyra e jetesës përgjatë tërë atij viti. Është e njohur se Festa e Shëngjergjit fillon me 6 maj dhe sipas kalendarit popullor feston edhe ardhjen e verës, dhe sikur me këtë datë, “*I ipet iza çdo gjallese të gjallë mbi tokë*” siç shprehet, dr. Hamdije Zuka, në pyetjen rreth festimit të Shëngjergjit në vendlindjen e saj. Pra, Shëngjergji shënon kufirin kohorë në mes mbarimit të stinës së dimrit dhe fillimit të stinës së verës, 6 maj kur llogaritet ardhja e verës e deri me 8 tetor kur llogaritet ardhja e dimrit (Shën Mitri), apo siç dëgjohet shpesh nga ne kur thuhet: “*Nga Shëngjergji e deri në shëmitër*”.

Tradita e festës së Shëngjergjit, si e kremte e lashtë pagane, tek populli shqiptar ndër shekuj dukshëm është respektuar. Ndoc Papleka thotë se: “*Besimet dhe praktikat e kohës së paganizmit, të cilat kanë qenë të përbashkëta për të gjithë popujt indoevropianë, nuk kanë pasur të njëjtën jetëgjatësi dhe nuk janë ruajtur njëllor në etnokulturat e veçanta të këtyre popujve*”. (Papleka, 1999:11) Njeriu i lashtë pagan besonte se kishte forca të mbinatyrshme të cilat duhej të largoheshin përmes riteve dhe magjive të ndryshme të bëra gjatë atyre ditëve. Gjithashtu ai kishte nevoja të ndryshme dhe përplotësimin e tyre, ai besonte se këto nevoja do t’i plotësoheshin përmes riteve dhe ceremonive të cilat i zbatonte gjatë festave të ndryshme të motmotit, por ajo e cila kishte rëndësinë më të veçantë, ishte festa e

Shëngjergjit. Kishte shumë rite dhe ceremoni të cilat lidheshin me ruajtjen e shëndetit, me mbrojtjen e kafshëve, me mbrojtjen të dritërave, dhe të pemëve, të cilat zbatoheshin me përpikëri. Populli shqiptar, i cili hy tek popujt indoevropianë, këtë festë e konsideronte si të shenjtë, me besimin se nga ajo ditë do filloj një mirëqenie më e mirë për njerëzit e shtëpisë, për bagëtinë por edhe për bereqetin që kultivohej në ara.

“Kultura popullore është bazë nga e cila buron, zhvillohet dhe ushqehet kultura e gjithë popullit” – thotë akademik Mark Krasniqi gjatë një studimi të tij për kulturën e popullit shqiptarë në vitin 1979. (Krasniqi 1983: 6) Dhe meqë kultura është si një dokument material i zhvillimi të një populli, edhe populli shqiptarë si popull indoevropian me një kulturë të lashtë, festave pagane e duke veçuar këtu festën e Shëngjergjit së cilës i dha një rëndësi të veçantë, por gjithnjë duke mos i anashkaluar edhe festat tjera. Edhe pse gjatë shekujve pushtues të ndryshëm u munduan të bëjnë ndryshime të dukshme në kulturën tonë, prapë se prapë *“kultura popullore ka qenë një armë e fuqishme madje mund të themi se ka qenë armë kryesore, me të cilën ai luftoi shekuj me radhë me sukses kundër pushtuesit të huaj”* (Krasniqi 1983: 6) pra, i mbijetoi çdo lloj pushtuesi. Pra, me të drejt mund të shtohet mendimi i akademikut Krasniqi se *“njohja studimi dhe ruajtja e trashëgimisë së kulturës popullore ka po atë rëndësi që e ka njohja dhe studimi i historisë së shoqërisë njerëzore, madje edhe më të madhe sepse trashëgimia kulturore e një populli është bazë dhe dokument material i zhvillimit të tij historik”*. (Krasniqi 1983: 6)

Në ceremonitë të cilat zhvilloheshin për festimin e Shëngjergjit, përfshiheshin shumë zakone e tradita të cilat bëheshin gjatë këtyre ditëve, me besimin se ai ose ajo që do e bëjë një ritual të tillë do të ketë një fat të mirë gjatë tërë atij viti, prandaj “Ndër shqiptarë besoj se kjo festë del si jetëdhënëse në sigurimin e ekzistencës njerëzore, dhe është festë e cila kishte karakter jo vetëm ritual por edhe praktik e prodhimtarë. (Ibrahimi, Zëri i Pelagonisë: nr.5-6/2013:11)

Vlen të theksohet se ky besim pagan, Shën Gjergji manifestohet në forma të ndryshme në trojet shqiptare, ndërsa objekti i hulumtimit në këtë studim do të jetë: “Rituale dhe ceremoni gjatë festës së Shëngjergjit në rajonin e Anamoravës”.

Ritualet që lidhen me punën në Natën e Shëngjergjit

Mbrëmja e natës së Shëngjergjit ose edhe mëngjesi i ditës së Shëngjergjit pothuajse çdo familje të çdo fshati të rajonit të Anamoravës i gjente të mbledhur tek lumenjtë të cilët i kishin më afër përdua ose çfarë do të jetë por të ketë ujë të rrjedhshëm. Afër këtyre lumenjve bëheshin ritet pagane për të cilat besonin se ato rite do të kenë forcën e tyre dhe dëshira atyre do u plotësohet, dhe se njerëzit e shtëpisë do të ruheshin nga të këqijat eventuale. Përveç lumenjve ose “rekave” e rëndësishme ishte se nga një pjese e Anamoravës të vizitoheshin edhe tyrbet.

Ekzistojnë disa rite dhe ceremoni të cilat duhet të zbatohen përgjatë atyre ditëve që festohet Shëngjergji. E gjitha kjo do fillojë me pas-trimin e shtëpive disa ditë më parë. Gjithçka duhet të pastrohet në shtëpi, shkamt (karrige të vogla trekëmbështa), tervesa apo ndryshe quhet sofa e bukës, magjia ku është gatuar buka, edhe qilarët ku mbahej bylmeti, duke përfshirë edhe oborrin deri në detajet më të vogla. Madje edhe djepat e fëmijëve në këtë ditë është dashur të vihen në pemë, me qëllim që fëmija të jetë i shëndetshëm. Ritualet dhe zakonet popullore shqiptare kushtuar kësaj feste ishin nga më të ndryshmet duke filluar që nga pesë maji, apo siç quhej ndryshe Nata e Shëngjergjit.

Puna e cila ka qenë njëra ndër më të rëndësishmet, që duhet të kryhet në natën e Shëngjergjit është ajo se është dashur të pastrohej i gjithë oborri i shtëpisë sepse mendohej se, aty ku prek fshesa nuk prekin gjallesat e këqija si p.sh. gjarpri apo gjësendet tjera dëmtoese për shtëpinë, bagëtinë dhe bujqësinë.

Ishte zakoni që në natën e Shëngjergjit më 5 maj, fëmijët të shkojnë te lumi i fshatit apo “reka” siç thuhet atje tek ne, dhe të marrin ujë të lumit. Lumi, uji i të cilit paraqet një relik të simbolizon jetën,

ripërtëritjen (Xhemaj 2005:125), duhet të ishte me ujë të rrjedhshëm, me qëllim që uji i tij të jetë i pastër dhe të rrjedhin të mirat në shtëpi, ashtu sikurse rrjedh ai. Gjithashtu po atë ditë duhet të mbledhnin lule të Shëngjergjit edhe lule të pemëve si: lule ftoni, lule molle, lule dardhe, por edhe lule dhe gjethe të pemëve të tjera të cilat mugullonin në pranverë. Të tubuara ashtu duhet t'i vënë në një pemë që në ditën e Shëngjergjit të lahen pastaj me to. Këto lulet e mbledhura nuk duhet të lëshoheshin në tokë. Nëse ndonjëra nga to të bije padashur në tokë, ajo do humbë efektin magjik tek i cili besohet se do ta sjellë ajo. Disa nga lulet dhe gjethe pemësh viheshin nëpër shtëpi, nëpër dyert e çdo dhome dhe në vendet ku është mbajtur bulmeti me qëllim që ai të shtohet më shumë, pastaj në dyert e ahurit ku është mbajtur bagëtia. Ajo që duhet të ceket dhe që ishte e rëndësishme për këtë ditë ishte se lulet e mbledhura, gjatë natës së Shëngjergjit, nuk duhet të rrinë në shtëpi, por në degët e ndonjë peme në oborr, pavarësisht çfarë ishte, mollë, dardhë, ftua apo edhe ndonjë pemë tjetër. Kjo buqetë lulësh e cila përbëhej nga hithra, shelgie, lule të Shëngjergjit, edhe lule e gjethe të pemëve tjera, është dashur të merret vetëm në mbrëmje vonë, e disa janë vënë edhe nën jastëk ku flinin fëmijët dhe njerëzit e shtëpisë. E rëndësishme ishte edhe ajo që besohet se çdo gjë duhet të pastrohet para Shëngjergji, madje edhe djepat e fëmijëve po të mbeteshin të papastruar i kanë vënë në pemë, që të ishte fëmija më i shëndetshëm. Mendohej dhe besohet njëkohësisht se po të zinte dita e Shëngjergjit e papërgatitur pa pastruar, duhet që patjetër që ato punët e mbetura të kryheshin deri në ditën e tretë, e cila quhet Dita e Shmarkut.

Mirëpo jo në të gjithë rajonin e Anamoravës festohej kështu, me ceremonitë e njëjta. Në rajonin e Kamenicës më konkretisht në fshatin Tuxhevc, zonja Bukurie Xhemaili, 47-vjeçare, për festën e Shëngjergjit është shprehur kështu: Natën e Shëngjergjit janë mbledhur të gjitha gratë e fshatit, dhe të veshura bukur i janë drejtuar tyrbeve. Aty kanë shkruar për të shkruar hajmali për njerëzit e shtëpisë e për bagëtinë që të mos i rrokë msyshi. Tri tyrbet më të

njohura të kësaj pjese të Anamoraves, të cilat vizitoheshin nga gratë e kësaj pjese janë: Tyrbja e Jallaqes, Tyrbja e Rogoqices dhe Tyrbja e Dazhnices.

Ritualet që janë zhvilluar në ditën e Shëngjergjit

Dita e Shëngjergjit ka filluar me zgjimin e hershëm të të gjithë njerëzve të shtëpisë. Me ujin e përgatitur në natën e Shëngjergjit, me lule Shëngjergji, shelgie, gjethe dhe lule të pemëve të ndryshme si, ftoit, molla, dardhës e hithra, për të cilat besohej se ato do kishin efekte mrekullibërëse, amvisja e shtëpisë zgjohej e para edhe spërkat mbarë shtëpinë, njerëzit e shtëpisë, burrat, gratë, fëmijët, por nuk harroheshin edhe stallat e bagëtive. Përndryshe fëmijët që do t'i zinte dielli në gjumë, gjatë atij viti do ta ndjenin vetën të rëndë dhe do të bëheshin gjumashë, thoshte populli. (Xhemaj, 2005: 124).

Tek ne ishte traditë që vajzat të zgjoreshin herët, të laheshin dhe të hipnin në një pemë, ku duhet t'i kriheshin flokët. Dhe kënga e cila këndohej nga vajzat në pemë tek e cila besohej si tek një formulë magjike, me besimin që flokët e tyre pas këtij rituali do të ishin më të shëndetshme dhe më të gjata, ishte kjo:

*Gat si konopi,
trash si perajka
për inati të Afërditës,
(këtu thuhet emri i një vajze të bukur e cila do të të pëlqejë dhe
sikur ia ke zili për ato flokë, ose për bukurin që ka)
u rritshin ma t'gata .*

Ndër aktivitetet tjera të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj dite nga vajzat ishte edhe ndërtimi i luhatësëve, kur vajzat duke u luhatur edhe këndonin. Pothuajse çdo ceremonie dhe rituali të Shëngjergjit iu bashkonin edhe këngët në të cilat shfaqeshin ndjenjat lirike edhe përmes këngëve kërkonin nga Shëngjergji që përveç jetës së shëndetshme, bulmetit e bereqetit edhe gjera tjera të mira tu sjell në shtëpi. Në ç'përmasa ishte vlera e këtyre këngëve, studiuesi Shefqet

Pllana e vlerëson kështu: Vargjet e këtyre këngëve dëshmojnë fuqi – në dhe rolin e fjalës së njeriut gjatë përleshjes së tij dramatike me vështirësitë dhe me pengesat që i paraqiteshin në jetë, të cilat synonte të shtrojë me çdo kusht. (Pllana 1979: 81) Andaj edhe tek anamoraveset ekzistonte besimi se për vëllezërit do të ishte keq nëse motrat nuk do hipnin në luhatëse dhe nuk do të këndonin. Kënga e cila është kënduar në ditën e Shëngjergjit nga vajzat e hipura në luhatëse është e thurën kështu:

*Jena qika, jena vajza
Na mbarojnë xhemper me krrabza
Xhemper me krabza ingjisim pulla
Vjen shengjergji dhe mbjellim lula
Mbjellim lulakakureka
Në shtrat të nanës na zë dreka,
vjen kunata me na thirrë,
qu kunata hana sill,
vete nanën çka ka qit
tamël dhenve e buke të ngryte.*

Ndërsa sa i përket gjinisë mashkullore, djemtë e rinj janë zgjuar herët “pa le dielli” siç thuhej, dhe i kanë lëshuar bagëtinë që ti kulloshin më herët edhe ti sjellin në shtëpi përsëri më herët. Gjithashtu gjatë kësaj dite janë organizuar edhe lojëra të ndryshme popullore, si: kulla e prishtë, ishte një lojë meshkujsh, gjuajtje me gurë. Humbësi i kësaj loje kishte për detyrë me mbajte në shpinë fituesin nga një vend tek një vend i caktuar. Loja tjetër e cila bëhej ishte marhama apo vrapimi në mes të rinjsh.

Vajzave iu kanë lidhë flokët gërsheta edhe iu kanë vënë kunguj të egër në flokë në formë zemre, po ashtu edhe djemve iu kanë bërë në forma të ndryshme si rrumbullake, por edhe në forma tjera dhe ia kanë varur në qafë. Metie Hajrullahu, amvise 71 vjeçare, ndër të tjera shtonë se: Ndërsa disa gra e venin një degë hithi në vesh sepse

besohej që do të ishin të shëndetshme sikur hithi. Me ujë të lumit është mbush edhe tpini³². Me besimin që rituali do të jete sa më efikas dhe sa më i garantuar që gjatë atij viti do u ecë bulmeti më mirë, tpinin e lënë jashtë në oborr jo vetëm që mbushej me ujë të lumit por atij i vareshin edhe lule shëngjergji, i janë lidhur kungull të egër me penj të kuq edhe degë hithi.

Për këtë të kremte, sipas traditës, bujku nuk i mbrehte qetë në zgjedhë, nuk punonte punë të tokës, e as gruaja nuk shponte me gjilpërë. (Xhemaj, 2005: 124).

Gjatë pasdites së Shëngjergjit, nuset e reja visheshin me rrobat e tyre më të bukura e disa visheshin me dimi të cilat duhet të kombino-heshin me jelek prej ari, si veshje e cila konsiderohej si tradicionale. Dhe deri në mbrëmje vajzat shëtishin shtëpi me shtëpi ku kishte nuse, dhe nuset ishin të detyruara nga respekti të dilnin në oborr, dhe i përshëndesnin vajzat e që atje thuhet “tu marrësh dorën”.

Meqenëse jo çdo fshat i këtij rajoni ka traditat e njëjta të Shëngjergjit. Ajo që ishte më karakteristike në fshatin Tërpezë dhe në disa fshatra përreth në komunën e Vitisë, ishte se ritualet e festës së Shëngjergjit bëheshin në një mënyrë tjetër. Ditën e Shëngjergjit i gjithë fshati shkon tek një burim i ujit, vendi quhet “Te uji i njelmët” me pi ujë edhe rituali tjetër është se të gjithë lidhnin nga një pe të kuq për degët e një murrizi, dhe lenin pare, (euro) me besimin se do ju sjell shëndet e fat. Dita e Shëngjergjit kishte një rendësi të veçante edhe për të fejuarit ose të dashuruarit sepse meqenëse më parë nuk kishin takime ose telefona sikur tash, e shfrytëzonin edhe si vendtakim në mes tyre.

Ndërsa nga informatat e marra nga zonja Bukurije Xhemaili, mësojmë se në qytetin e Dardanes (Kamenicës)ku jeton tash ajo, ishte traditë që të zgjoheshin herët në mëngjes edhe është vazhduar i njëjti ritual si më lartë të spërkatjes me ujë e hithi. Që të ishin fëmijët e shëndetshëm, gjatë kësaj dite nënat i pastrojnë me pak ujë të marrë nga lumi, ku vendosnin edhe një vezë me ngjyrë të kuqe dhe me gjethe molle, me qëllim që vajzat të jenë të bukura si molla.

³²³² Mëtimi

Vlen të theksohet se ky besim pagan, Shën Gjergji manifestohet në forma të ndryshme sipas familjeve e trevave të ndryshme shqiptare. Nexhat Rexha, drejtor i shkollës së mesme të Dardanës (në këtë rast informator) për festën e Shëngjergjit thotë: Shën Gjergji ka krijuar lidhje me vetë jetën e njeriut. Kjo festë në trevën tonë manifestohet më shumë përmes botës femërore. Mirëpo, bota mashkullore nuk e kundërshton, ajo shënohet në familje në këto mënyra të veprimit:

- Natën e Shën Gjergjit dikush nga femrat e familjes kanë marrë disa kokrra ve dhe ujë, kanë shkuar në Tyrben më të afërt për të lënë vezët aty dhe për bekuar ujin dhe aty kanë marrë ndonjë grusht dhe për të sjell fat shëndet e pasuri në familje.

- Pastaj kanë mbledhur lule, fleta të pemëve dhe i kanë vendosur para derës së shtëpisë, për të sjell fat e shëndet në familje.

- Po për atë mbrëmje kanë marrë lule dhe fleta të pemëve apo të shelgut për të larë gjithë anëtarët e familjes dhe të nesërmen në mëngjes duhet të zgjohen sa më herët. Me qëllim që vera pas ditës së Shën Gjergjit të shkoj me vullnet e punë të hershme. Kishte raste kur ndonjë plakë e shtëpisë në mbrëmje kur është errësuar, me udhëzimin e saj ndonjë fëmijë e ka bërë nevojën para derës së shtëpisë. Me qëllim që nëse vijnë natën e Shën Gjergjit për të bërë magji, ajo le ta haj urinën (mutin), që magjia të priset. Këto kanë qenë raste të rralla por ndonjë plakë i ka besuar edhe kësaj besëtytnie. Meshkujt ditën e Shëngjergjit nuk kanë punuar, lëvruar apo të punojnë me kafshë, sepse kafshëve do t'i lëndohej qafa dhe mund të kenë pasoja gjatë tërë stinës së verës. Zotëria në fjalë shton se: ka edhe shumë variante tjera të këtyre riteve në trevën tonë. Kjo festë, ritual apo besëtytni është manifestuar gjithmonë në këtë mënyrë.³³

Ndërsa në rrethinën e Gjilanit, fëmijëve pos që u janë ble rroba të reja, sipas Hysen Kqikut, (në Velegllave dhe rrethinë) kujdes të veçantë i kushtohet ushqimit të bagëtisë. Një ditë para festës të rinjtë shkojnë në mal për të mbledhur tamelqak, lertha dhe hidha për ushqim të kafshëve (që do ti mbrojnë edhe nga magjitë) dhe

³³Informator NexhatRexha

lule e degë shelve për ti stolisur dyert”. Ndërsa “Në mëngjesin e ditës së Shëngjergjit (besohej se: lum kush e sheh diellin tu le) familjarët stërpikën me ujë me hithra dhe degë shelve dhe bagëtia lëshohet herët në kullotë” (Ferri, 2012, 191).

Ritet që lidheshin me bagëtinë.— Krahas riteve tjera për festën e Shëngjergjit vend të rëndësishëm kishin edhe ritet për bagëtinë. Në Anamoravë, ishte zakon që bagëtia duhet të lëshohej në mëngjes, pa lind dielli, nga pas duhej ti bihej nga me thupër të njom shelve, sepse besonin që do të sjellin më shumë qumësht. Në brirët e tyre u vendosnin kunguj të egër, burgadela³⁴ të lidhur me penj të kuq, që të mos marrin mësysh.

Ritualet që lidhen me ushqimin. — Gjatë ditëve të Shëngjergjit, ushqimi ishte njeri prej elementeve të cilit i kushtohej rëndësi më e madhe dhe kujdes i veçantë. Duke iu referuar qytetit të Vitisë dhe fshatrave përreth, si ushqim kryesor për ta në ditën e Shëngjergjit ishte Flija. Mish në ditën e Shëngjergjit nuk është përgatitur, sepse besonin se po të hanin mish do të ziheshin në mes vete dhe mish do të bëheshin, dhe do të iu shkonte viti duke u grindur në mes vete. Në natën e Shëngjergjit përgatitej përsesh, tamel (qumësht) me bukë të kollomojt që njerëzit e shtëpisë gjatë tërë atij viti të shkojnë amël në mes vete. Flija përgatitet në forma të ndryshme por tek ne është më e njohur kjo formë e flisë.



Mirëpo, edhe sa i përket ushqimit të festës së Shëngjergjit në qytetin e Kamenicës, kjo pjesë e Karadakut nuk feston njësoj ashtu sikurse në Gjilan dhe Viti, edhe pse janë i njëjti rajon.

Veçori e ushqimit në këtë komunë ishte se, në natën e Shëngjergjit, për njerëzit

³⁴Lloj bime në formën e drurit

e shtëpisë përgatitej lakror me lakra. Ndërsa në ditën e Shëngjergjit, gratë kanë përgatitë dreken e Shëngjergjit ku prehej një pulë dhe përgatiteshin pite me petë. Në të tretën e ditës, apo siç quhej kjo ditë “dita e shmarkut” për ushqim kishin të përgatisnin fli.

Ky është një element më i veçantë për këtë trevë sepse ky ritual nuk është zhvilluar në pjesën tjetër të Anamoraves, si në Viti dhe Gjilan. Mirëpo vlen të theksohet që është në komunën e Dardanës jo të gjitha shtëpitë festonin njësoj festën e Shëngjergjit edhe sa i përket traditës së ushqimit. Rexha, kur është fjala tek ushqimi shton: Darka në natën e Shëngjergjit është përgatitur zakonisht me ndonjë lakror me hithra dhe në lakrorë ka futur ndonjë monedhë për të sjell fat tek anëtarët e familjes dhe sidomos te fëmijët. Ndërsa në ditën e Shën Gjergjit në mënyrë masive kanë përgatitur Fljia si ushqim tradicional për këtë festë.

Dita e tretë e Shëngjergjit – ose Dita e Shën Markut (Shmarkut)

Në qendër të vëmendjes së kësaj feste pagane e rituale ishte edhe Dita e Shën Markut e cila festohet në ditën e tretë të Shëngjergjit. Është kjo një veçori tjetër se kjo dite nuk festohej në gjithë rajonin, për të cilin bëhet fjalë këtu. Në rajonin e Anamoravës në pjesën e qytetit të Dardanës (Kamenicës) në të tretën e ditës, apo siç e quhej kjo ditë “dita e shmarkut” për ushqim kishin të përgatisnin fli, sa zonja Bukurie ndër të tjera shton se “kur takonim gra në rrugë ose diku në lagje, e pyesnim, a e ke hangër flinë e Shëngjergjit?” Mirëpo, edhe sa i përket ushqimit të festës së Shëngjergjit në qytetin e Kamenicës, kjo pjesë e Karadakut nuk feston njësoj ashtu sikurse në Gjilan dhe Viti, edhe pse janë i njëjti rajon. Ndërsa një element tjetër i veçantë për këtë rajon ishte edhe rituali i pastrimit. Mendohej dhe besohej njëkohësisht se po të zinte dita e Shëngjergjit e papërgatitur pa pastruar duhet që patjetër që ato punët e mbetura të kryheshin deri në ditën e tretë, në Ditën e Shën Markut, ta kryesh sepse besohej që tërë viti do të shkojë ashtu pa pastër.

Përfundim

Rrjedhja e kohës dhe ardhja e modernizmit, ndryshoi edhe ritet e ceremonitë e festës së Shëngjergjit. Pyetja e cila vazhdimisht na vjen në mendje është se, sa është duke na përfshirë bota moderne dhe sa është duke iu zvogëluar vlera festës së lashtë pagane të Shëngjergjit, në rajonin e Anamoravës? Kontaminimi me modernitetin sikur i ka dhënë një ngjyrë të zbehur festës së Shëngjergjit. Pjesa e Anamora-vës, sikur gradualisht u largohet festave tradicionale, largohet nga ajo tradicionalja edhe përfshihet nga moderniteti.

Ndryshimet më të mëdha që paraqiten në zbehjen e kësaj feste të lashtë pagane, ndodhën në njëzet vitet e fundit, ose periudhën e pasluftës. Ndryshimet duken të ngadalshme, por të vazhdueshme. Në studimin tim, dukë marrë mendimet dhe informata nga shumë zonja më në moshë të këtij rajoni, kam arritur në përfundim se Shëngjergji ishte me të vërtetë festë e cila pritej me gëzim nga të gjitha njerëzit, e sidomos nga moshat e reja dhe fëmijët.

Edhe pse tash nuk festohet si më parë, prapë kur vjen festa e Shëngjergjit në familjet tona, gjejmë elemente të bartura nga atëherë. Ende kanë mbetur disa zakone të cilave iu përmbahet pothuajse çdo shtëpi. Siç duket, është e pamundur braktisja e traditës që është ngulitur shekuj me radhë. Se sa ishin të lidhur anamoravësit me traditën dhe sidomos me festën e Shëngjergjit, e dëshmon edhe ajo se emrin e këtij shenjtori mban edhe njëra nga kishat e cila gjendet në Stubëll, të Vitisë. (Ferri 2006:67)

Trajtimi dhe qasja që i bëhet kësaj teme ndikon mjaft shumë në ruajtjen e vlerave të kulturës dhe traditës tek populli shqiptarë. Në lidhje me trashëgiminë dhe kulturën e popullit shqiptar flet edhe akademik Mark Krasniqi kur shton se “Thesari i kulturës popullore po varfërohet dita ditës dhe po zhduket gradualisht para syve tanë. Këtë pasuri të madhe të kulturës sonë që kemi ne sot, nesër nuk do ta ketë brezi i ri, nëse ne nuk do përpiqemi për ta ruajtur” (Krasniqi 1983:16)

Pra, se sa thellë ishin këto besëtytni në qenien shqiptare anamora-vese dhe sa e përhapur ishte praktika e këtyre riteve, këtë e dësh-

mon ky studimi im për ritet e Shëngjergjit në pjesën juglindore të Kosovës të quajtur, Anamoravë e cila gjeografikisht përbëhet prej fushës së Vitisë, të Gjilanit dhe të Dardanës (Kamenicës) me një sipërfaqe rreth 650 km katrorë.

Dhe për fund mund të them se në hapësirën shqiptare në mesin e shumë besimeve pagane, Shëngjergji si festë mban gjallë ceremoni dhe ritualet e saj, çfarë na jep të kuptojmë se tradita nuk mund largohet edhe aq lehtë, sepse ajo jeton prapë brenda nesh.

Literatura:

1. XHEMAJ, Uke. (2005). Rite motmoti dhe besime të tjera mitologjiko agrare në Kosovë. IAP, Prishtinë.
2. IBRAHIMI, Mustafa. (2013). Cikli i festave të pranverës në fshatin Cërnilishtë të Prilepit, Zëri i Pelagonisë nr.5-6/2013. Shkup.
3. FERRI Naser (2012). Mythologia Viva – Mitologjia e gjallë, IAP, Prishtinë.
4. PAPLEKA, Ndoc, (1999). Kulte rite magji në traditën orale, Toena, 1999, Tiranë.
5. Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore (Materiale nga sesioni shkencorë, mbajtur në Prishtinë me 7 – 8 shtator 1979) Mark Krasniqi – Trashëgimia kulturore e popullit tonë dhe detyra e jonë ndaj saj – Prishtinë, 1983.
6. Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore (Materiale nga sesioni shkencorë, mbajtur në Prishtinë me 7 – 8 shtator 1979) Shefqet Pllana – krijimtaria poetike në ritet e motmotit ndër shqiptarët. – Prishtinë, 1983.

Informatorë:

Metie Hajrullahu, 71-vjeçare, Smirë.

Hamdije Zuka, doktoreshë, 50-vjeçare, Viti.

Bukurie Xhemaili, amvise, 47-vjeçare, Tugjevc, Dardanë.

Nexhat Rexha, shkrimtar dhe drejtor shkolle në Dardanë, 50-vjeçar.

EMINE SHABANI

Universiteti i Tetovës

SIMBOLIKA E HEROIT, KUÇEDRËS DHE ZANËS TE FIGURA E SHËN GJERGJIT

Në shekullin e I-rë kishte filluar konvertimi i paganëve në krishterizëm, por në shek. III, ky konvertim mori një hov më të madh si kurrë më parë. Pasi perandoria romake kishte nën sundimin e saj pjesën më të madhe të Ballkanit, Azinë e vogël dhe lindjen e Afërt, perandorët e saj u kujdesën për të ruajtur fenë pagane në gjithë vendet e kolonizuara. Është e njohur historia e Jezu Krishtit që përhapri monoteizmin në këto vende dhe dënimin i tij nga Pontij Pilati, prokuratori i pestë i Judesë (në vitet e tridhjeta të shek I). Martirizimi i të krishterëve do të vazhdojë deri në shek, IV nga Trajani, Neroni,³⁵ Hadriani, Diokleciani e deri atëherë kur në fronin e perandorisë romake do të ulet Konstantini i Madh.

Nga të dhënat historike të dokumentuara të autorëve antikë Taciti, Eusebiusi nga Cezarea–Palestinë (313), Marcus Aureliusi, Plini i Riu,³⁶ dhe nga historianët modernë Donald G. Kyle, Edward Gi-

³⁵ Tacitus. 'The Annals: The Reigns of Claudius, Tiberius and Nero's. (trans. J.C. Yardley). Oxford University Press (2008). pp. 356-357.

³⁶ Shih më tepër John W. Roberts, ed. (2007). "Pliny the Younger". The Oxford Dictionary of the Classical World. Oxford: Oxford University Press. ISBN 9780192801463. Retrieved 24 March 2014. The tenth bk. of letters contains all of Pliny's correspondence with Trajan. [...] The provincial letters are the only such dossier surviving entire, and are a major source for understanding Roman provincial government. Gaius Plinius Caecilius Secundus, born Gaius Caecilius or Gaius Caecilius Cilo (61 – c. 113), better known as Pliny the Younger (/pɫɪni/), was a lawyer, author, and magistrate of Ancient Rome. Pliny's uncle, Pliny the Elder, helped raise and educate him. Both Pliny the Elder and the Younger were witnesses to the eruption of Vesuvius in 79 AD, in which the former died.

Pliny the Younger wrote hundreds of letters, of which 247 survive and are of great historical value. Some are addressed to reigning emperors or to notables such as the historian Tacitus. Pliny served as an imperial magistrate under Trajan

bbon, David S. Potter, George Mousourakis, Henry Chadwick, Bart Eherman, Hans A. Pohlsander, Donald Kyle, Philip Schaff, Jorge Rupke, Anthony R. Birley, etj, të cilët pohojnë se djemtë e shumë ushtarakëve dhe drejtuesve të vendeve të kolonizuara filluan të konvertohen në këtë fe të re, përfshirë këtu edhe Maksimilianin, një përfaqësues romak në Nikomedia, të cilët i kthyen shpinën perëndive pagane romake.

Për çrregullimin e përgjithshëm dhe rënien ekonomike të perandorisë romake, gjatë viteve të fundit të shekullit III u fajësuan të krishterët, të cilët i kishin zemëruar perënditë pagane romake. Diokleciani erdhi në fron pas vdekjes së Cezarit, i cili edhe e shpëtoi këtë perandori që ishte buzë humnerës, por ai u tregua tiran me besimtarët e krishterë.

Diokleciani (284 e.r. 305 e.r.) vendosi reforma të gjera për ta ripërtërirë madhështinë e perandorisë romake. Këtu përfshihen ndarja administrative e perandorisë në dy pjesë. Paganët, duke përfshirë edhe orakullin e Apollonit në Milet, këmbëngulnin që të krishterët po shkaktonin trazira, madje Diokleciani arriti të besonte se krishterëni po vriste Perandorinë.

Në vitin 303, Diokleciani urdhëroi që të gjithë peshkopët e krishterë dhe kleri të arrestohen, të gjitha biblat dhe librat liturgjik të konfiskohen dhe kishat të shkatërrohen. Në vitin 304, ai solli një dekret që të gjithë duhet të sakrifikojnë për perënditë ose në të kundërtën të vriten. Përndjekjet e tmerrshme, veçanërisht në Lindje, zgjatën thuajse një dekadë. Këto përndjekje çuan në përçarje. Vetëm pas dorëheqjes së Dioklecianit dhe ardhjes së Konstantinit të

(reigned 98–117),[1] and his letters to Trajan provide one of the few surviving records of the relationship between the imperial office and provincial governors.[2]

Pliny rose through a series of civil and military offices, the *cursus honorum*. He was a friend of the historian Tacitus and might have employed the biographer Suetonius on his staff. Pliny also came into contact with other well-known men of the period, including the philosophers Artemidorus and Euphrates the Stoic, during his time in Syria.[3]

Madh dhe konvertimit të tij në krishterizëm, u bënë ndryshime dhe investime të mëdha në kisha, duke i shndërruar ato në objekte të shenjta nga të cilat do të predikohesh jo vetëm fjala e shenjtë por do të vendosej edhe për të gjitha sferat tjera të jetës njerëzore...³⁷

Shën Gjergji (270–303 e. r) sipas historianëve të lartpërmendur është i biri i Anastasit nga Kapadokia, ushtarak i nderuar në armatën e Dioklecianit dhe e ëma Tiobasti, nga Lydda, (greq. Diospolis arab. Lod, provincë e Palestinës –Siri, sot në Izrael). Në moshë të re i vdes i ati, ndërsa e ëma e tij kthehet në vendlindjen e saj në Lydda, ku e merr edhe djalin e vetëm të saj. Duke qenë një djalë i guximshëm dhe i mbetur pa prind, Gjergji do të inkuadrohet në ushtrinë romake sikurse babai i tij dhe do të shërbejë në Lydda. Meqenëse në këtë kohë kishte një konvertim të madh në krishterizëm, Gjergji do ta pranojë këtë fe monoteiste, ku e kishin gjetur veten shumë të rinj dhe të vjetër.

Simbolika fetare, ngjashmëria me përrallat popullore shqiptare dhe ato botërore, simbolika e kuçedrës, zana– virgjëresha që duhet të sakrifikohet nga bisha dhe shpëtimtari shenjtori Gjergj, përfaqësojnë botën mitologjike të përbashkët në të gjithë popujt e botës.

Emri i Shën Gjergjit u bë në figurë mbrojtëse e shumë popujve të botës, si solidarizim për martirizimin e tij, këtë gjest fisnik dhe të shtrenjtë për një kauzë fisnike—atë të lirisë individuale dhe të përgjithshme. Kapërcimi transcendent i gjithë modeleve të ekzistencës, kalimi i njeriut në një stad të ri ashtu siç do të thoshte Arnold van Genepp ritet e kalimit (*The rites of passage*), mund ta shpjegojmë me shembullin e studentit të Jungut Jozef L. Henderson: ‘*Te të rriturit ndjenja e të kryerit, arrihet përmes bashkimit të vetëdijes me komponentin e nënvetëdijshëm të arsyes, nga ky bashkim del, po të shprehemi me termin e Jungut “funksioni transcendent i shpirtit”, me anën e të cilit njeriu mund ta arrijë qëllimin e tij të lartë: reali–*

³⁷ John W. Roberts, ed. (2007). "Pliny the Younger". The Oxford Dictionary of the Classical World. Oxford: Oxford University Press. ISBN 9780192801463. Retrieved 24 March 2014.

zimin e plotë të potencialit të Unit të vet individual.”³⁸ Flijimi nuk është thjesht personal dhe egoist, ai përfshin në vetvete sakrificën, altruizmin, dualizmin, natë–ditë, lumturi–vuajtje, drejtësi–padrejtësi, jetë–vdekje, etj, ai është apel universal, kundër së keqes së përgjithshme, ata që e marrin të parët këtë mesazh, ata edhe e realizojnë pa u zbrapsur, që refuzojnë tu therrin kurban shumësisë së zotave, por nuk hezitojnë të bëhen vet kurban të kauzës së përgjithshme.

Emri Georgos, (greq. bujk ose punonjës i tokës, ge–tokë dhe orgon –punë) dhe festa e 23 Prillit sipas Kalendarit Koptik shënon ardhjen e pranverës, stinës së përtëritjes së natyrës, ndërsa kalendar i Gregorian e shënon këtë festë më 6 Maj, e cila lidhet me të korrat e mbara që kur njerëzit festojnë përgjatë shekujve dhe i luten këtij shenjtori për begati.

Në Angli ai është shpallur shenjtor–mbrojtës i Britanisë së Madhe nga Edward–i I (1272–1307)³⁹ i cili në shenjë respekti të figurës së

³⁸ Carl Gustav Jung, (2010), Njeriu dhe simbolet e tij, Fan Noli Tiranë, f. 154.

³⁹ Another possible influence on the development of the cult of St George is thought to have been the Roman Emperor Constantine the Great who was born on 27 21. St George February 272 AD and died on 22 May 337 AD. Constantine is often referred to as the first Christian Emperor. As a young man Constantine served at the court of Diocletian in Nicomedia. His father, Constantius, later became emperor and, when Constantius was in Britain, campaigning against the Scots and Picts of Caledonia, he became ill and subsequently died. The day Constantius died, 25 July 306 AD, was the day Constantine was proclaimed ‘Augustus’, or Emperor, at York in Britain by his loyal troops. Constantine became Western Emperor, since the Empire was divided at this time into two halves, Eastern and Western. During his career Constantine re-founded Byzantium, which came to be known as ‘Constantinopolis’ (‘Constantine’s city’), on the site of modern day Istanbul. Constantine held the Council of Nicea in 325 AD, an event that legalized Christianity throughout the Empire for the first time in history. The Council of Nicea, together with the earlier Edict of Milan, issued in 313 AD, were instrumental in paving the way for the growth of Christianity. Constantine the Great is reported to have built a church at Lydda in honour of St George. Sir Ernest Wallis Budge, amongst others, have suggested that the church contained a bas-relief of Constantine which depicted him standing on top of a dragon or serpent and holding the banner of the Cross in his right hand. It is thought that early followers of St George’s cult, either intentionally or accidentally, may have identified this sculptural image with the saint and the

Shën Gjergjit pajisi trupat ushtarake të Anglisë me kryqin e e tij, gjatë luftës në Wells. Edward-i pos nderimeve të tjera, ngriti flamurin me figurën e Shën Gjergjit mbi Kështjellën Caerlaverock (Kelaverok) në Skoci në vitin 1300.

Më vonë, Edward III, për të ringjallur lavdinë e mbretërimit të gjyshit të tij, themeloi Urdhrin e Garter-it nën patronazhin e Shën Gjergjit. Ai gjithashtu është mbrojtës i shumë shteteve tjera si: Etiopia, Gjeorgjia, Portugalia, Katalonja, Portugalia, Aragoni dhe qyteteve si Frajburgu, Moska, Bejruti. Shën Gjergji u vlerësua si ndërmjetësues i fuqishëm (mes popullit dhe pushtetit të Dioklecianit) ndërsa historia e kuçedrës, u sajua në shek. VI dhe përmban apel universal.

Miti i heroit që shpëton virgjëreshën nga kthetrat e bishës, është shumë i vjetër. Ky duket të jetë i ngjashëm me mitin e Perseut i cili shpëtoi Andromedën nga bisha e detit, pranë Lydda-s. Versionet për historinë e Shën Gjergjit janë të shumta dhe të ndryshme. Ai u tregua shumë i shkathët e i zgjuar dhe fitoi respektin e të gjithëve shumë shpejtë. Por kjo harmoni dhe mirëqenie u prish, prej kur kuçedra kishte zaptuar mbretërinë, kishte marrë burimet e ujit dhe njerëzit i kishin sakrifikuar fëmijët e tyre për ta ushqyer bishën. Ky kalorës një ditë dëgjon rrëfimin e trishtuar të mbretit që detyrohet t'a flijojë vajzën e tij për kuçedrën. Derisa Gjergji e dëgjon këtë rrëfim, vajza gjendet afër e më afër bishës. Gjergji trim vrapon në drejtimin nga ishte nisur vajza dhe e gjen teksa bisha është gati ta përpijë. Ai i afrohet dhe me disa goditje e vret kuçedrën. Pas vrasjes së bishës përsëri në mbretëri kthehet harmonia dhe lumturia, e cila vazhdon deri me ardhjen e perandorit të njohur Dioklecianit. Rrë-

result was a merging of the imagery of the two figures. 22. St George It is also worth noting that a number of Roman coins depict human figures standing over the body of a serpent. Valentinian III is shown on a gold 'solidus' in just such a pose with his right foot on top of a serpent with a human head. In his right hand he is holding a cross and, in his left, he is holding an orb decorated with an angel of victory. A bronze coin struck during the reign of Constantine shows the Emperor transfixing a serpent with the 'labarum', an early Christian motif.

fimet për Shën Gjergjin kanë karakter religjioz, që na informojnë mbi këtë figurë të respektuar gjatë përhapjes së krishterimit në lindjen e mesme dhe Evropë.

Integrimi i figurës së Shën Gjergjit në krijimet popullore: Shumë përralla shqiptare fillojnë me elemente të ngjashme të Shën Gjergjit, siç janë Gjergj Elez Alia si remineshencë e vonshme e heroit shqipëtar me elemente të ngjashme me Shën Gjergjin, i cili lufton me Bajlozin e ardhur përtej detit që kërkon dhen, dhi, desh e cjepër dhe vasha të reja si formë sakrifice.

Nga ritet e kalimit, të ashtuquajtura *rites of passage*⁴⁰ kemi elementin e **ndarjes, tranzicionit dhe reintegrimit**.⁴¹

Momenti i duelit mes bishës, alternohet dhe lidhet në mënyrë madhështore. Përfytyrimi auditiv pothuajse merr plastikën e hovit të sulmit dhe zhurmën e shpatës tek pret kokat e kuçedrës një nga një. Jo rrallë parabola dhe metafora kthehet në një harmoni imitativë të vërtetë që na bën të ndjejmë herë fluiditetin e ujit afër të cilit Gjergji takon kuçedrën, e herë shtangien e njerëzve që e shohin nga kulla këtë duel mes jetës dhe vdekjes, që është, triumfi ose dështimi, jo vetëm individual por i përgjithshëm.

Që të mund të kapet filli i thelbit të veprës së tij, mund të vëmë paralelizma dhe krahasime, ashtu si astekët e vjetër me iniciacion të gnozës dhe dashurisë, dikotominë e jetës, mes urrejtjes dhe dashurisë, dritës dhe errësirës, jetës dhe vdekjes etj, hulumtimi i një invarianti të këtillë na udhëzon t'i perceptojmë pikturat e Shën Gjergjit si fasadë që shpreh në mënyrë simbolike realitetin e veprës së tij, ose

⁴⁰ Arnold van Gennep, (1968), Rites of Passage, London.

⁴¹ Arnold van Gennep, (1968), Rites of Passage, f. xx Shih më tepër : (kjo quhet periudha liminale nga lat. Liminal-prag) dhe e treta Ritet e kalimit (passage), janë stadi paraliminal, liminal dhe postliminal. Kalimi nga një gjendje/status, në një tjetër siç është moshë e pjekurisë, martesë, vdekja dhe ritet tjera kanë emocione dhe shqetësimet e veta, nga kjo fazë e dytë që ndryshe quhet edhe tranzitore kalon në fazën postliminale që d.m.th, stabilizimi dhe të përshtaturit me gjendjen e reintegruar. Gjatë kalimit të personit nga një stad tek një tjetër, ai nuk shkëputet nga përvoja, njohuritë, emocionet e fazës që e lë prapa, ai ruan dhe bart elemente të fazës paraprake, por i pranon në të njëjtën kohë edhe detyrat, ritualet dhe përgjegjësitë e fazës në të cilën ka hyrë.

e mbulon realitetin me këta elemente simbolike dhe, zhvendosja e këtyre figurave na jep metarrëfimin e vet të pikturave dhe muraleve në kisha anë kënd vendeve të botës.

Në mitin e Shën Gjergjit Trekëndëshi i dashurisë është shtjelluar në mënyrë parabolike Gjergji-shenjtori, Vajza e mbretit-kisha dhe kuçedra-armiku. Sipas burimeve historike Shën Gjergji u ekzekutua më 23 Prill 303, nga Diokleciani, bashkë me 14 besimtarë të krishterë në qytetin e Lydda-s.

Kuptimi i figurës së Shën Gjergjit është religjioz, politik, antropologjik, funksional. Figura e tij është transformuar në arketip të heroit të martirizuar religjioz dhe humanist. Fuqia e autoritetit shpirtëror këtu ngrihet mbi atë shoqëror, që ky i fundit gjithmonë ka ndikim më të madh në shoqëri se autoriteti intelektual dhe shpirtëror.

Me përhapjen e krishterimit si fe e re monoteiste, fillon një epokë e re në kuptimin e rendit dhe kaosit apo metahierarkisë së re. Kjo fe e re dhe ky rend i ri është më i theksuar në shek. III dhe IV të e. s., që si pasojë ndodhin ndjekje dhe ekzekutime të pasuesve të Krishtit. Ndër të cilët janë 14 martirët bashkë me Shën Gjergjin, figurën e tyre emblematike.

Nga realiteti në mit dhe anasjelltas: Krahas historive reale mbi martirizimin e Shën Gjergjit janë thurur përralla, legjenda, këngë e krijime popullore të ndryshme mbi jetën e tij. Miti për Shën Gjergjin fillon të krijohet në shek. VI. Jacob de Voragine botoi librin *Legenda aurea* (1265–66)⁴², Legjenda e artë, ku theks të veçantë këtu u vihet bëmave të Shën Gjergjit i cili përveç virtyteve fisnike e trimërisë së dëgjuar, e shpëton vajzën e mbretit të Libisë

⁴² Attwater, Donald (1995) [1965]. *Dictionary of Saints* (Third ed.). London: Penguin Reference. p. 152. His best-known story, popularized in the later middle ages by the *Golden Legend*, tells that he was a knight from Cappadocia, who rescued a maiden princess from a dragon at Silene in Libya, leading to the Christianity of much of the kingdom. The *Golden Legend* is a collection of hagiographies by Jacobus de Voragine that was widely read in late medieval Europe. More than a thousand manuscripts of the text have survived. It was likely compiled around the year 1260, although the text was added to over the centuries.

nga kuçedra, e cila kishte ndalur burimet e ujit, dhe bënte kërdi ndër njerëz. Në një version të përrallës siriane, mbi mitin e Shën Gjergjit thuhet se, për të qenë më të drejtë në viktimen e radhës, disa burra vendosën që t'i shkruajnë në letra të veçanta emrat e të gjithë vajzave të qyteti dhe çdo ditë të tërhiqet nga një letër me emrin e tyre. Një ditë fati që i vajzës së mbretit. Gjithë mbretëria u dëshpërua, por sakrifica duhej patjetër të bëhej ! Mbreti, mbretëresha dhe gjithë qyteti e përcollën me lot në sy vajzën e tyre në vendin që kishte caktuar bisha, e që ishte buzë liqenit/detit, ku kishte strofullën ajo. Ky element mitologjik është i pranishëm në të gjithë përrallat e popujve të botës, mund të ndryshojë emri i heroit, vendi, etnia, por figura e kuçedrës në të gjitha versionet ka një apel universal. Ajo është një kafshë nga familja e reptilëve dhe i ngjashëm me mitin grek të Medeas që e shndërron në gur secilin që e shikon, ashtu si gjarpri që është një figurë që të frikëson dhe shtang dhe shtangia na bën vigjilent e të vetëdijshëm. Në anën tjetër deti dhe bisha përfaqësojnë armikun dhe gjakderdhjen, ky simbol i fuqishëm është i pranishëm në mitologjitë e popujve të botës edhe pse dukuri të këtilla si krijime shpirtërore, kulturore e folklorike janë krijuar edhe në kohëra e vende të cilat nuk janë frekuentuar. Kjo histori është shndërruar në mitin e heroit, kuçedrës dhe zanës, e cila është prezent tek gjithë popujt. Rëndësia që merr kjo figurë ndër shqiptarë, rrëfëhet te historia e mëvonshme e Gjergj Elez Alisë dhe dyluftimi me bajlozin. Kjo histori shfaqet si reminishencë e kësaj figure të bartur ndër shekuj, e cila si në përmbajtje ashtu edhe në funksion ka përkime me historinë e Shën Gjergjit. Rrëfimet në të gjithë kulturat botërore janë të njëjta ndryshon pak a shumë përmbajtja, emri i vendit ku zhvillohet dueli me kuçedrën, Shqipëria, Anglia, Greqia, Siria, Libia, Lydda, Kapadokia, Nikaia, emri i mbretërisë, emri i bishës, Llamia, dragoi, kuçedra, me shtatë kokë, me tre, me pesë, që gjendet buzë detit, liqenit, ose në hyrje të shpellës, ku janë burimet e ujit, etj.

Ngjashëm me interpretuesit e letërsisë popullore Jakobson dhe Bogatyrev, edhe sociologu i letërsisë Arnold Hauser në veprën e tij

Filozofia e historisë së artit e thellon tezën mbi fundosjen e vlerave kulturore dhe tezën se populli nuk prodhon por riprodhon në përgjithësi konceptin kolektiv. Nga vepra e Huserlit del se: letërsia gojore ka zanafillën në qarqet intelektuale e cila me kohë është integruar në popull i cili e ka pranuar, riprodhuar, interpretuar, memorizuar dhe përçuar, ndërsa në rrjedhën historike—shoqërore të mëtejshme ajo përsëri ka prekur deri te letërsia autoriale e cila është përçuar në atë populllore dhe në këtë mënyrë ka qarkulluar gjithmonë.⁴³

Te libri *Gjeneza* në Bibël shkruan “është gjarpri ai që u jep njerëzve vizionin, e urtësinë dhe gjithashtu prodhon vetëdijesimin e druajtjen. Ndërsa në Kuran është kapitulli *Shokët e Shpellës* që flet për martirizimit e të krishterëve nga Diokleciani.

Kaosi dhe triumfi. Një version tjetër i rrëfimeve flet se Shën Gjergjin e vranë tre herë dhe ai u ringjall përsëri dhe herën e katërt dha shpirt, por pas kësaj tragjedie qytetin e kaploi zjarri si dënim i Perëndisë. Miti i heroit në këtë rast del si skelet i interpretimit, sukses i zhvillimit të vetëdijes njerëzore.

Figura e Shën Gjergjit gjithashtu simbolizon dhe përfaqëson një metarealitet mbi objektet që i kuptojmë dhe nuhasim. Truri i njeriut është i vjetër miliarda vite thonë psikiatrit, ai nuk është një automobil ose një aparat i thjeshtë, por një metastrukturë e sofistikuar në gjithësi. Këtu nuk është fjala për një martirizim dhe një ideal vetjak, por për një polisistem të madh dhe të ndërlikuar kulturor, me padrejtësi dhe shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor, të atyre që mendonin ndryshe nga perandori dhe ndjekësit e tij. Ky element dhe ky ideal i çoi në altarin e vdekjes dhjetëra e qindra besimtarë të krishterë që pranuan vdekjen duke mos ndërruar qëndrim.

Metarealiteti, metastruktura dhe epifenomeni, përfaqësojnë këtë qark nervor, këtë impuls të jetës, të shprehur me ndjenjën e fuqishme të drejtësisë, e barasvlershme me britmën e Akilit kur e

⁴³ Zdenko Skreb-Ante Stamac, (1986), Uvod u književnost, CGP, DELO, Ljubljana, f. 143.

thërret Hektorin në dyluftim, por Shën Gjergji është më i qetë, ai ka përthithur gjithë mësimin dhe urtësinë e fesë së Krishtit, që nuk e lejon të jetë arrogant, por jo edhe i nënshtuar para poshtërimit! Duke e vendosur të vërtetën mbi të panjohurën, njeriu e zhvillon sistemin e vetëdijesimit, sigurimit që e ndihmon atë në mëkëmbje, krijon stabilitet aktual, transformim dhe transcendencë të këtij stabiliteti.

Te figura e Shën Gjergjit janë bërë inkapsulime dhe rikapsulime ⁴⁴ të kuptimit të veprës së tij mitizime, që i shohim anë e kënd botës, në piktura, kisha, besime të ndryshme, në rituale, këngë popullore dhe festa të motmotit sidomos në Ballkan kënga rome *Ederlezi* e përkthyer edhe në gjuhët e popujve tjerë, këndon historinë e trishtë të këtij shenjtë që flijoi jetën dhe dashurinë e tij tokësore, me një gjest altruist e filantrop, për ta fituar dashurinë hyjnore.

Sa i përket metaforës se një shoqëri e caktuar është pjesëtare e një trupi të vetëm, ka bërë organizimin e të gjithë teorive që nga Platoni e deri sot. Siç do të shprehet Milton ‘*Bashkësia duhet të jetë vetëm si një person gjigant një rritje e fuqishme, shtatore e një njeriu të ndershëm*’⁴⁵

Literatura:

Abbot Giuseppe Ricciotti, (1960), *The Age of Martyrs, Christianity from Diocletian (284) to Constantine (337)*, January 1st 2009 by TAN Books (first published January 1st 1960), ISBN 0895556316 (ISBN13: 9780895556318).

Frye Northrop, (1987), *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë.

Skreb Zdenko – Stamac Ante, (1986), *Uvod u književnost*, CGP, DELO, Ljubljana.

Carl Gustav Jung, (2010), *Kujtimet ëndrrat përsiatjet*, Fan Noli, Tiranë.

⁴⁴ Mbështjellje dhe çmbështjellje.

⁴⁵ Northrop Frye, (1987), *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, f. 198.

Attwater, Donald (1995) [1965]. *Dictionary of Saints* (Third ed.). London: Penguin Reference.

Arnold van Gennep, (1968), *Rites of Passage*, London.

Tacitus. 'The Annals: The Reigns of Claudius, Tiberius and Nero's. (trans. J.C. Yardley). Oxford University Press (2008).

John W. Roberts, ed. (2007). "Pliny the Younger". *The Oxford Dictionary of the Classical World*. Oxford: Oxford University Press. ISBN 9780192801463. Retrieved 24 March 2014.

Jung Carl Gustav, (2010), *Njeriu dhe simbolet e tij*, Fan Noli Tiranë.
[https://en.wikipedia.org/wiki/Ederlezi_\(song\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Ederlezi_(song))

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 21 – 2018

DITA E SHËNGJERGJIT
NË TREVAT SHQIPTARE

Kryeredaktor:
Dr. Sefer Tahiri

Përgjegjës i botimit:
Dr. Sevdail Demiri

Redaktor teknik:
Naser Fera

Shtypi: Feniks Print – Koçani
Tirazhi: 500 copë

Ky material botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së
nr. 0201–345/7, të datës 08.11.2017, Shkup.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
398.332.1(=18)(062)

DITAE shëngjergjit në trevat Shqiptare : (konferencë shkencore -
07.05.2018, Tetovë) / [kryeredaktor Sefer Tahiri]. - Shkup : Instituti i
trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2018. - 122 стр. :
илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v 21)

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите
ISBN 978-608-4653-79-0

а) Албанци - Ѓурѓовден - Народни обичаи и верувања - Собири
COBISS.MK-ID 108933130